



Migrimi, Dërgesat dhe Zhvillimi Lokal që i Përgjigjet Nevojave Gjimore

Rasti i Shqipërisë



Instituti Ndërkombëtar i Kombeve të Bashkuara për Hulumtim dhe Trajnim për Zhvillimin e Grave (OKB-INSTRAW)

promovon kërkime të aplikuara mbi çështjet gjinore, lehtëson menaxhimin e njohurive, si edhe mbështet ndërtimin e kapaciteteve nëpërmjet rrjeteve bashkëpunuese dhe partneriteteve mes aktorëve të ndryshëm përfshi këtu agjencitë e OKB-së, qeveritë, akademikët dhe shoqërinë civile.

Programi për Zhvillim i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (PNUD) është rrjeti i OKB-së për zhvillimin global, një organizatë që përpiqet për ndryshim dhe që lidh vende të ndryshme të botës me rrjetet e njohurive, eksperiencave, dhe burimeve në mënyrë që njerëzit të bëjnë një jetë më të mirë. Ne ndodhemi në 166 vende, dhe punojmë së bashku me këto vende për të mbështetur zgjidhjet e tyre për të përballuar sfidat e zhvillimit në nivel lokal dhe ndërkombëtar. Në procesin e zhvillimit të kapaciteteve lokale, këto vende mbështeten tek burimet njerëzore të PNUD-it si edhe partnerëve të shumtë të tij.

Migrimi, dërgesat dhe zhvillimi lokal që i përgjigjet nevojave gjinore: rasti i Shqipërisë

Udhëheqës të Kërkimit: Dr. Juli Vullnetari dhe Prof. Russell King (Universiteti i Sussex)

Autorë të raportit: Dr. Juli Vullnetari dhe Prof. Russell King (Universiteti i Sussex). Ky version i shkurtuar është përpiluar nga Sandra Panopio (OKB-INSTRAW) bazuar mbi raportin e plotë të studimit.

Përkthyer nga anglishtja në shqip: Merlinda Hoço, në bashkëpunim me Juliana Bako, Blerina Uruçi, Ermir Bajraktari, Xhuljeta Çelaj dhe Petrit Doberdolari (vullnetarë të OKB-së).

Redaktore e përkthimit në shqip: Dr. Juli Vullnetari.

Dizenjimi: Sughey Abreu (UN-INSTRAW)

Mbështetje Teknike: PNUD/Shqipëri

E drejta e autorit ©2010, UN-INSTRAW dhe PNUD

Të gjitha të drejtat e rezervuara

UN-INSTRAW

César Nicolás Penson 102-A

Santo Domingo, Dominican Republic

Tel: +1-809-685-2111

Fax: +1-809-685-2117

Email: info@un-instraw.org

Website: www.un-instraw.org

UNDP

One United Nations Plaza

New York, NY 10017 USA

Tel: 212-906-5000

Fax: 212-906-5364

E-mail: publications.queries@undp.org

Website: www.undp.org

Programi për Zhvillim i Organizatës së

Kombeve të Bashkuara në Shqipëri

Rr. "Papa Gjon Pali II", Qendra e Biznesit

ABA, Kati 6

Tirana, Shqipëri

Tel.: +355 (4) 2400 721, 2400 722,

2400 723, 2400 724

Fax: +355 (4) 2400 725, 2400 726

www.undp.org.al

Shprehjet e aplikuara dhe prezantimi i materialit në këtë botim nuk i referohen në asnjë mënyrë opinionit të Sekretariatit të OKB-së, anëtarëve të tij, OKB-INSTRAW apo PNUD-it në lidhje me statusin ligjor të ndonjë vendi, territori, qyteti, ose zone, apo autoriteteve të tyre, apo në lidhje me përcaktimin e kufijve territorialë të këtyre.

Këndvështrimet e shprehura i përkasin autorëve dhe jo detyrimisht reflektojnë pikëpamjet e OKB-së, shteteve anëtare të saj, OKB-INSTRAW ose PNUD-it.

PËRMBAJTJA

Parathënie.....	i
Përmbledhje.....	1
1. Hyrje.....	5
1.1. Metodologjia.....	8
2. Një Vështrim mbi Shqipërinë.....	9
2.1. Marrëdhëniet gjinore në Shqipëri.....	9
2.2. Vendi i origjinës në Shqipëri: fshatrat e Korçës.....	10
2.3. Qyteti pritës në Greqi: Selanik.....	11
3. Emigrimi i Shqiptarëve në Greqi.....	13
3.1. Punësimi.....	14
3.2. Integrimi.....	15
3.3. Rrjetet transnacionale të emigrantëve.....	15
4. Familjet Emigrante Shqiptare.....	18
4.1. Tipologjia e familjeve që marrin dhe dërgojnë para.....	18
4.2. Ndryshime në tipologji si pasojë e migrimit.....	21
4.3. Familjet migrante prej shumë-brezash: gjyshet.....	21
4.4. Ruajtja e unitetit në familjet transnacionale.....	23
5. Dërgesat.....	24
5.1. Sasia dhe shpeshtësia e dërgesave (monetare).....	24
5.2. Kanalet e transmetimit.....	26
5.3. Profilët e dërguesve dhe të marrëseve të parave.....	31
5.4. Modelet e dërgimit dhe marrjes së parave.....	31
5.5. Gratë emigrante dërguese të parave.....	34
5.6. Investimet.....	38
5.7. Dërgesat materiale (sendet).....	40
5.8. Dërgesat sociale.....	40

6. Ndikimi i Dërgesave në Zhvillim.....	43
6.1 Efektet e marrjes së dërgesave në marrëdhëniet gjinore.....	43
6.2 Dërgesat dhe sipërmarrja.....	42
6.3 Lidhjet midis Migrimit dhe Zhvillimit.....	46
6.4 Lidhjet me diasporën dhe shoqatat e emigrantëve.....	46
7. Qartësimi i Aktorëve Kyç.....	48
8. Politikat Publike.....	49
8.1 Strategjitë Kombëtare.....	50
9. Rekomandime.....	52
9.1 Reformat në strukturë dhe infrastrukturë.....	52
9.2 Legalizimet dhe rregulloret mbi migracionin në Greqi.....	53
9.3 Zhvillimi.....	54
Referencat.....	56

Lista e Tabelave

Tabela 1 Shpeshtësia dhe Administratorët/et e Dërgesave.....	25
Tabela 2 Shpërndarja e Shpeshtësisë së Kategorive të Dërgesave Vjetore.....	25
Tabela 3 Shumat Vjetore të Dërgesave.....	26
Tabela 4 Përdorimet Kryesore të Dërgesave.....	37

Lista e Hartave

Harta 1. Harta e rretheve të Shqipërisë.....	12
--	----

PARATHËNIE

Feminizimi i migracionit është një karakteristikë e veçantë e migrimit, e cila thekson jo vetëm rritje të moderuar në numrin e grave që emigrojnë, por edhe mënyrën sesi ato përfshihen në procesin migrator. Në të kaluarën, shumica e femrave kanë emigruar nën varësinë e meshkujve ose familjeve të tyre, ndërsa sot femra të profileve të ndryshme largohen në mënyrë të pavarur për të punuar dhe jetuar jashtë vendi duke siguruar jetesën e tyre me të ardhurat e tyre. Interesi në rritje për studimin e feminizimit të migrimit ka krijuar një bazë njohurish dhe mjetesh pune, të cilat mundësojnë integrimin e koncepteve të barazisë gjinore në programet e lidhura me migracionin.

Ndërkohë, një tjetër tipar i rëndësishëm i migracionit i cili po fiton vëmendje të konsiderueshme ndërkombëtare, janë dërgesat. Paratë e dërguara prej emigrantëve nga vendet e destinacionit tek familjet dhe komunitetet e tyre në vendet e origjinës, përbëjnë një motivim të rëndësishëm për të punuar jashtë shtetit. Edhe pse emigrantët individualisht dërgojnë shuma relativisht të vogla parash, grumbullimi i të gjitha dërgesave monetare të dërguara nga miliona njerëz që jetojnë dhe punojnë jashtë vendeve të tyre të lindjes, përbën një qarkullim të shumave të konsiderueshme financiare.

Ndikimi i dërgesave dhe potenciali i tyre në zhvillim të ekonomive kombëtare si edhe botës globale financiare ka zgjuar interesin e qeverive dhe organizatave ndërkombëtare. Megjithatë, potenciali i tyre për të mbështetur dhe rritur zhvillimin individual dhe lokal ende nuk është kuptuar plotësisht. Përqasja gjinore mbi studimin e këtij fenomeni nxjerr në pah sesi gjinia ndikon në përvojat e ndryshme të migrantëve dhe sesi gratë emigrante në veçanti mund të japin kontributin e tyre në debatet, planifikimin dhe zbatimin e politikave për një zhvillim të qëndrueshëm.

Studimi i dërgesave është një aspekt i rëndësishëm i punës së Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara për zhvillimin njerëzor dhe reduktimin e varfërisë, si dhe në punën e tij për mbështetjen e qeverive për të gjetur mënyra të reja për shfrytëzimin e potencialit zhvillues të dërgesave me qëllim arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit. Dërgesat janë mjete i vetëm i mbijetesës për miliona familje të varfra në mbarë botën; dërgesat i mundësojnë atyre të përballojnë jo vetëm nevojat më elementare të mbijetesës të cilat përndryshe mungojnë ose janë të paarrtshme, por edhe një masë fuqizimi ekonomik. Duke ndërtuar mbi këtë premisë, PNUD ja dedikoi Raportin e Zhvillimit Njerëzor të vitit 2009, 'Tejkalimi i Pengesave: Lëvizshmëria Njerëzore dhe Zhvillimi' aplikimit të një përqasje të zhvillimit njerëzor në fushën e studimit të migracionit. Ndërsa migracioni nuk zëvendëson përpjekjet më të gjera për zhvillim, ai mund të konsiderohet një strategji jetike për njësitë ekonomike familjare dhe familjet që kërkojnë të zgjerojnë burimet e të ardhurave dhe përmirësojnë jetesën e tyre.

Qysh nga viti 2004 Instituti Ndërkombëtar i Kombeve të Bashkuara për Hulimtim dhe Trajnim për Zhvillimin e Grave (OKB-INSTRAW) ka qenë i interesuar për të kuptuar dimensionet gjinore të migrimit, dërgesave dhe potencialin e tyre për zhvillim. Instituti aplikon një perspektivë gjinore për të analizuar se si faktorë të tillë si pabarazitë gjinore në qasjen dhe ndarjen e punës përcaktojnë marrëdhënien midis migrimit dhe zhvillimit. Sipas kësaj llogjike pune, dërgesat shërbejnë si komponent kyç për të kuptuar dhe lehtësuar zgjidhje të qëndrueshme.

Kjo seri e studimeve “Migrimi, dërgesat dhe zhvillimi lokal që i përgjigjet nevojave gjinore”, përqëndron vëmendjen në dërgimin, transferimin, marrjen dhe përdorimin e dërgesave, dhe vërteton se gjinia ndikon dhe formëzon lëvizjen dhe përvojat e emigrantëve dhe komuniteteve të tyre në vendet e origjinës dhe të destinacionit. Harta e aktorëve kyçë dhe diskutimi i trajtave migratore të së shkuarës dhe aktuale, si edhe praktikave të dërgesave në çdo vend ofrojnë një sfond të dobishëm për të realizuar një analizë të dërgesave kolektive dhe sociale. Duke përdorur një përjasje gjinore dhe duke vendosur theksin në zhvillimin njerëzor, ky projekt ofron një shtresë tjetër investigimi të nevojshme e cila mbështetet mbi nyjen migracion-zhvillim.

Me këtë publikim, OKB-INSTRRAW dhe PNUD janë të angazhuar në prodhimin e hulumtimit të aplikuar e cila nxit lehtësimin e politikave dhe praktikave që u përgjigjen nevojave gjinore dhe që lidhen me migracionin dhe zhvillimin. Rekomandimet e dala nga hulumtimi shërbejnë si udhërrëfyes kryesor për të nxitur dialogun në nivel të politikave kombëtare të ndjekura nga aktorët kryesorë, përfshirë organizatat e emigrantëve, agjencitë qeveritare, ndërmjetësit financiarë dhe Organizatat Jo-Qeveritare (OJQ). Dialogë të tillë janë platforma të rëndësishme prej të cilave rezultatet e hulumtimit mund të përkthehen në plane veprimi që theksojnë bashkë-zhvillimin. Me kalimin e kohës përfshirja e një analize gjinore në formulimin më të efektshëm dhe të qëndrueshëm të strategjive të migrimit dhe zhvillimit do të kontribuojë në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit.

OKB-INSTRRAW dhe PNUD paraqesin këtë seri globale mbi gjininë, dërgesat dhe zhvillimin, në mënyrë që të lehtësojnë zhvillimin e politikave dhe praktikave të cilat përfshijnë nevojat dhe komuniteteve e grave emigrante, familjeve dhe komunitetet të tyre në planet e së ardhmes për zhvillim, që të sigurohet një zhvillim lokal që i përgjigjet nevojave gjinore dhe një jetesë dhe e ardhme e qëndrueshme.

Amaia Pérez
Drejtore për Çështjet Sociale
OKB-INSTRRAW

Winnie Byanyima
Drejtore e Grupit Gjinor
Seksioni Gjinor i PNUD-it

SHQIPËRIA

Lidhjet komplekse midis procesit të globalizimit dhe zhvillimit kanë bërë që migracioni bashkëkohor të konsiderohet një zonë kyçe hulumtimi. Popullsia e emigrantëve në mbarë botën vlerësohet të jetë mbi 200 milionë burra dhe gra të cilët kanë lënë vendet e tyre të origjinës për të jetuar dhe punuar jashtë. Në të njëjtën kohë lëvizjet që ndodhin brenda territorit të një vendi, kryesisht nga zonat rurale në zonat urbane, janë po aq intensive. Demografikisht, profilet e lëvizjeve nga vende të veçanta kanë ndryshuar, si në aspektin e numrit dhe përbërjen gjinore. Studime mbi *feminizimin e migracionit*¹ kanë nxjerr në pah rolin e rëndësishëm dhe ndikimin e grave si aktore në procesin e migracionit. Megjithë rritjen e shpejtë në volumin dhe shumëllojshmërinë e njohurive mbi nyjen migracion-zhvillim, hulumtimi dhe debatet mbi dimensionet gjinore të kësaj çështje, duke përfshirë në mënyrë të veçantë rolin e grave në lëvizjet migratore, vazhdon të jetë i mangët.

Në vitin 2007, Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD) dhe Instituti Ndërkombëtar i Kombeve të Bashkuara për Hulumtim dhe Trajnim për Zhvillimin e Grave (OKB-INSTRAW) filluan një projekt të përbashkët të quajtur 'Migrimi dhe dërgesat: zhvillimi lokal që i përgjigjet nevojave gjinore'. Projekti është përpjekur të nxitë zhvillimin lokal që i përgjigjet nevojave gjinore duke identifikuar dhe nxitur mundësitë e përdorimit të dërgesave për jetesë të qëndrueshme dhe ndërtim të kapitalit social në komunitetet e varfra rurale dhe pjesërisht-urbane. Pjesa kërkimore e projektit është kryer në gjashtë shtete: Shqipëri, Republika Domenikane, Lesoto, Marok, Filipinet dhe Senegal.

Qëllimet dhe prioritetet strategjike të projektit janë:

- Rritja e ndërgjegjësimit dhe përmirësimit të aksesit të burimeve produktive tek njësitë familjare marrëse të dërgesave që kryesohen nga gratë, duke rritur në të njëjtën kohë asetet dhe duke forcuar kapacitetet e tyre.
- Pajisjen me informacionin e duhur dhe mbështetjen përkatëse për qeverinë lokale dhe qëndrore me qëllim identifikimin dhe formulimin e politikave që do të rritnin efikasitetin e përdorimit të dërgesave për një jetesë të qëndrueshme dhe ndërtim të kapitalit social.
- Rritja e kapaciteteve të aktorëve kyç për integrimin gjinor në politikat, programet, projektet dhe iniciativat e tjera që lidhin dërgesat me zhvillimin e jetesës së qëndrueshme dhe ndërtimin e kapitalit social.

1. 'Përvec rritjes në përqindje të grave migruese, kryesisht në vendet e zhvilluara në Veriun global – termi feminizim tregon një përmirësim të ndjeshëm cilësor të lëvizjeve, që do të thotë rritje e pavarësisë në punësim të grave emigruese jashtë vendit të tyre, në vend të punësimit "të varur" nga burrat apo nga procedurat e bashkimit familjar. Me fjalë të tjera, gjatë dy dekadave të fundit, një numër i konsiderueshëm femrash – që emigrojnë të pavarura – janë pjesë e lëvizjeve migratore të cilat më parë dominoheshin nga meshkujt' (Perez et al. 2008).

Ky studim ka për qëllim të ngushtojë hendekun në njohuri mbi dimensionet gjinore të migracionit dhe dërgesave përmes një analize e cila ndërthur migracionin me zhvillimin. Ne i kushtojmë vëmendje të veçantë ndikimit të dërgesave² – financiare, materiale (sende) dhe sociale – në proceset gjinore të zhvillimit në vendet e origjinës dhe tek familjet transnacionale³ që përfshijnë vendet e origjinës dhe destinacionit.

Hulumtimi ynë shqyrton dimensionet gjinore të migracionit dhe dërgesave në kontekstin e Shqipërisë dhe vendit pritës, Greqisë. Ky raport pasqyron dy elementë të hulumtimit. Së pari, sfondi i raportit është ndërtuar mbi një vështrim kritik të literaturës përkatëse mbi migracionin shqiptar, dërgesat, zhvillimin, marrëdhëniet gjinore, si dhe diskutimin e politikave dhe praktikave kyçe të aktorëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë në fushën e zhvillimit. Së dyti, të dhënat empirike të mbledhura përmes një kombinimi të metodave sasore dhe cilësore përbëjnë thelbin e analizës. Aspekti transnacional i emigracionit është përfshirë në studim duke integruar të dhënat dhe analizat nga vendet e origjinës (një grup prej tre fshatrash në rajonin e Korçës, në jug-lindje të Shqipërisë), me ato të një zone të destinacionit (qyteti i Selanikut, në Greqinë fqinje). Rezultatet tona janë të bazuara mbi 350 pyetësorë sasiorë të realizuara në familje rurale marrëse të dërgesave në Shqipëri, 45 intervista të thëlluara dhe dy diskutime në grup me familjarë marrës të dërgesave në Shqipëri dhe familjarë dërgues të dërgesave në Greqi, si dhe 14 intervista të thëlluara dhe dy diskutime në fokus-grup me palët e interesuara në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar si në Shqipëri ashtu dhe në Greqi.

Shqipëria paraqet shembullin më dramatik të migracionit pas-komunist: rreth 1 milion shqiptarë – një e katërta e popullsisë totale të vendit – jetojnë jashtë vendit. Shumica e emigrantëve jetojnë në Greqinë dhe Italinë fqinje, ndërkohë që numri i tyre në Mbretërinë e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara ka ardhur duke u rritur që prej fundit të viteve 1990. Shumë shqiptarë gjithashtu janë zhvendosur brenda vendit gjatë kësaj kohe, kryesisht nga zonat e thella rurale veriore dhe jugore në zonat urbane bregdetare.

Dërgesat – sidomos nga jashtë vendit – kanë qenë një nga aspektet më të rëndësishme të këtij migracioni, jo vetëm për individët dhe familjet, por edhe për vendin në tërësi. Raportet e Bankës së Shqipërisë për shumatat totale vjetore tregojnë se midis viteve 1992 dhe 2003, shqiptarët kanë dërguar nga \$200 milion në \$800 milion në vit, duke kaluar \$1 miliard në 2004. Dërgesat kanë përbërë 10 deri në 22 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) të vendit, dhe kanë tejkaluar me disa herë shumën e Investimeve Direkte të Huaja (IDH-FDI) si edhe shumën e ndihmës së marrë nga institucionet ndërkombëtare. Në 2004, dërgesat ishin dy herë më të larta se të ardhurat nga eksportet (Gammeltoft 2002: 189; Ghosh 2006: 19; King 2005: 149; Piperno 2005; Uruçi dhe Gedeshi 2003). Në nivelin e familjes dërgesat kanë qenë vendimtare për mbijetesën ekonomike dhe zbutjen e varfërisë, ndërsa sigurojnë një furnizim të nevojshëm të bizneseve të vogla me kapital. Megjithatë, shumë pak vëmendje i është kushtuar deri tani aspektit gjinor të këtyre transfertave të konsiderueshme monetare në ambjentet brenda njësive familjare dhe vendit në tërësi.

Në kontekstin shqiptar, migracioni jashtë vendit në përgjithësi përfaqëson një tipologji të kryesuar nga meshkujt, dmth në fillim emigruan meshkujt dhe më pas femrat i ndoqën këta si familjarë 'në ngarkim' të tyre. Pjesa dërrmuese e emigrantëve të parë të pas-komunizmit të viteve 1990 ishin burra; gratë – sidomos nga zonat rurale – përgjithësisht qëndruan mbrapa. Madje edhe në rastet kur gratë emigruan, shumë pak vëmendje i është kushtuar tregimeve dhe përvojave të tyre për ato vite të para të emigrimit. Megjithatë, në vitin 2001 gratë shqiptare emigrante në Greqi – vendi i destinacionit të interesit në

2. Dërgesat – të njohura ndryshe nëpër mediat masive dhe shkrimet akademike me emrin 'remitanca' ose në anglisht 'remittances' – janë paratë (dërgesat monetare/financiare), sendet (dërgesat materiale) dhe dijet e idetë (dërgesat sociale) që emigrantët – qoftë ata që kanë emigruar jashtë apo brenda për brenda vendit – u dërgojnë familjeve dhe të afërmeve të tyre. Ne preferojmë të përdorim fjalën 'dërgesa' në këtë raport, përveç ndonjë rasti tek-tuk kur për arsye stilistike gjuhësore përdorim fjalën 'remitanca'.

3. Njësitë ekonomike familjare transnacionale (në anglisht 'transnational households') janë familjet pjesët e së cilës përfshijnë vendin e origjinës së migrantëve – në rastin tonë Shqipërinë, dhe një a më shumë vende të tjerë pritës – në rastin tonë vetëm Greqinë. Psh. bashkëshorti migrant jeton e punon në Greqi, ndërsa e shoqja dhe fëmijët jetojnë në Shqipëri. Për të folur për migrim transnacional (në anglisht 'transnational migration') apo njësi ekonomike familjare transnacionale, transfertat – monetare, materiale dhe sociale – si dhe aktivitetet e tjera si vizitat, etj., duhet të jenë të shpeshta të paktën në njërin kah, intensive, dhe të vazhdueshme.

hulumtimet tona – përbënin rreth 40 për qind të të gjithë emigrantëve shqiptarë atje. Maturimi i këtij migrimi – pas procesit të bashkimit familjar nëpërmjet të cilit shumica e grave emigrante shqiptare kanë shkuar në Greqi – reflektohet edhe në praninë e konsiderueshme të fëmijëve.

Duke pasur parasysh karakterin e fortë patriarkal të shoqërisë shqiptare, si kanë ndikuar migrimi dhe transfertat shoqëruese monetare dhe sociale në marrëdhëniet dhe rolet gjinore në zonat rurale, si edhe proceset e zhvillimit lokal? Rezultatet tona tregojnë se ndërlihdja midis migrimit, dërgesave dhe gjinisë ka ndikuar në zhvillimin lokal dhe është formëzuar prej tij në disa mënyra. Së pari, normat gjinore të shoqërisë së origjinës dhe llojet e mundësive për të emigruar që ishin në dispozicion për shqiptarët në vitet 1990 i kanë dhënë më tepër përparësi migrimit të burrave në Greqi, sesa grave. Migrimi i femrave në Greqi u rrit me shpejtësi kryesisht nëpërmjet bashkimit familjar, veçanërisht pas legalizimit të migrantëve meshkuj që nga viti 1998. Kjo rritje u ndikua edhe nga kriza në sektorin grek të përkujdesjes, pasi shumë gra greke u përfshinë në forcën e punës, ndërsa sektorët e shtetit grek që merren me mirëqenien nuk ofruan alternativa zëvendësuese për këto punë shtëpiake dhe përkujdesje. Këto punë u morrën përsipër nga gratë emigrante shqiptare, një situatë e cila reflektohet edhe nga të dhënat e studimit tonë, sipas të cilave shumica e grave që punojnë në Greqi janë punësuar në sektorët e punëve shtëpiake dhe përkujdesjes. Ndërsa shumica dërrmuese e burrave punojnë në ndërtim, bujqësi dhe industri. Ata gjithashtu kishin siguruar pjesëmarrje më të lartë në punët gjysëm-të kualifikuara.

Së dyti, burrat emigrantë shqiptarë (sidomos bashkëshortët dhe djemtë), vazhdojnë të jenë dërguesit kryesorë nga Greqia (pothuajse 99 për qind e kampionimit tonë). Kjo reflekton jo vetëm pozitën e tyre dominuese për nga numri në këtë komunitet migrantësh, por edhe normat patriarkale të shoqërisë shqiptare. Në Shqipëri, gratë e emigrantëve ishin marrësit/ administratorët kryesorë të dërgesave në familjet bërthamë; në familjet të cilat përfshinin prindërit e bijve emigrantë marrësit/administratorët e dërgesave ishin më shpesh baballarët e tyre (rreth 40 për qind e kampionimit tonë).

Duke marrë parasysh se marrëdhëniet gjinore në jug-lindje të Shqipërisë kanë qenë përgjithësisht më të barabarta sesa në pjesët e tjera të vendit (si psh. në veri dhe veri-lindje), dhe duke reflektuar deri diku ndryshimet si pasojë e migracionit, rezultatet e studimit tonë tregojnë një situatë më komplekse dhe të nuancuar. Për shembull, vendimarrja në lidhje me përdorimin e dërgesave përfshin në përgjithësi burrat dhe gratë, por në pjesën më të madhe ishin gratë ato që *de facto* (pra në jetën e përditshme) kishin nën kontroll financat. Sidomos në familjet që *de facto* kryesohen nga gratë, ato kanë fuqizuar deri diku pozitën e tyre nëpërmjet administrimit të përditshëm të shpenzimeve dhe dërgesave. Megjithatë, burri vazhdon të ushtrojë ndikim të madh në vendimarrjet strategjike brenda familjes.

Nga ana tjetër, shumë gra fitojnë para vetë, zakonisht duke punuar në fermat e vogla të familjes së tyre. Megjithë mundësitë e krijuara nga migracioni dhe dërgesat, shumë gra të zonave rurale ndjehen të mbingarkuara nga volumi dhe shumëllojshmëria e punëve dhe përgjegjësive që duhet të përballojnë vetë, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me nevojat emocionale dhe zhvillimin e fëmijëve të tyre. Për më tepër, nuk rezulton të kenë ndryshuar shumë ndarja dhe kryerja e punëve riprodhuese, si psh. përkujdesja për fëmijët dhe të moshuarit, të cilat kryhen pothuajse gjithmonë nga femrat. Paralelisht, rezultatet e hulumtimeve tona sugjerojnë se edhe pse gratë emigrante shqiptare e kanë forcuar rolin e tyre ekonomik në familje nëpërmjet të ardhurave që ato fitojnë, ato vazhdojnë të jenë të disfavorizuara nga politikat migratore greke të cilat rforcojnë modele patriarkale të varësisë dhe diskriminimit gjinor.

Megjithëse shumica e dërgesave përdoren përgjithësisht për të financuar konsumin bazë të familjeve, ato përdoren gjithashtu edhe për të paguar për kujdesin shëndetësor dhe arsimimin e anëtarëve të familjes si edhe për përmirësimin e kushteve të jetesës e sidomos banesave. Përveç kësaj, shumica e konsiderueshme janë investuar në bujqësi, sidomos në krijimin dhe zgjerimin e pemishteve me mollë, fermave blegtorale si edhe kultivimin e perimeve në shkallë të gjerë. Këto investime jo vetëm që prodhojnë të ardhura për

familjet-marrëse të dërgesave, por ato njëkohësisht ofrojnë edhe mundësi lokale punësimi për familjet e jo-emigrantëve si edhe të varfërve. Për më tepër, aftësitë dhe njohuritë e sjella nga jashtë janë gjithashtu pjesë e investimit dhe kontribuojnë në rritje të kapaciteteve në komunitet. Megjithatë, këto procese janë të prekura thellë nga gjinia: shumica e zanateve (punëve të kualifikuara) kryhen nga burrat, të cilët përgjithësisht janë edhe pronarë të tokave si edhe të ndërmarrjeve bujqësore. Shumica e bizneseve lokale gjithashtu janë të regjistruara në emrin e burrave, edhe pse gratë mund të merren me shumicën e detyrave administrative dhe operative.

Rezultatet tona sugjerojnë gjithashtu se edhe ata që po bëhen ura të aktiviteteve sipërmarrëse transnacionale janë gjithashtu në shumicën e rasteve meshkuj; pozita e gruas nuk është e spikatur në këto arena publike të negociimit të pushtetit dhe mundësive. Situata është e ngjashme në organizatat e emigrantëve, ku vendimarrja është përqëndruar përgjithësisht në duart e meshkujve, ndërsa gratë kryejnë role sekondare-mbështetëse. Në të njëjtën trajtë, shumica e shoqatave në zonat rurale të origjinës janë të përbëra dhe drejtuara nga burrat, një pozicion i cili konsiderohet si i dhënë, duke pasur parasysh rolin e tyre të fortë si kryefamiljarë. Çdo projekt i ardhshëm që ka synim të përfshijë gratë në zhvillimin lokal duhet të marrë në konsideratë këto dinamika gjinore fuqie, ashtu si ato shfaqen në hapësirat private dhe publike. Një qasje e tillë gjinore duhet që mbi të gjitha, t'i kushtojë kujdes pjesëmarrjes së kufizuar të grave në hapësirat publike të pushtetit politik dhe vendimarrjes. Së dyti, duhet shmangur 'instrumentalizimi' i mundshëm i grave, duke rritur peshën e tyre të detyrave ose pritshmërive, në rastet kur nuk janë siguruar hapësirat e duhura për pjesëmarrjen e tyre në politikë dhe që zëri i tyre të dëgjohet. Së treti, kjo përjasje gjinore do të shmangte rrezikun e përforcimit të stereotipeve gjinore.

Ne nuk gjetëm ndonjë shenjë domethënëse të politikave ose praktikave të bashkë-zhvillimit midis Greqisë dhe Shqipërisë të zbatuara në nivel lokal në zonat tona të hulumtimit. Ashtu siç ndodh me pjesën më të madhe të nismave në vend, iniciativat rajonale ekzistuese të zhvillimit të lidhura me migracionin reflektojnë kryesisht interesat e vendeve pritëse të emigrantëve shqiptarë, në këtë rast të Greqisë në lidhje me imigracionin shqiptar drejt saj, dhe shumë pak ose aspak interesat për zhvillim të Shqipërisë. Për më tepër, kërkimet tona tregojnë se organizatat e emigrantëve shqiptarë shpesh nuk përfshihen në programe të tilla, ose kanë patur një rol konsultativ sa për sy e faqe dhe tejet të kufizuar. Politika bashkë-zhvillimi që synojnë me të vërtetë raporte të barabarta, duhet ta konsiderojnë zhvillimin si qëllim në vetvete jo absolutish si një mjet që frenon emigrimin e 'parregull' të mëtejshëm, siç ka ndodhur përgjithësisht deri tani.

Zhvillimi i qëndrueshëm duhet t'i kushtojë kujdes të gjitha aspekteve të zhvillimit njerëzor, dmth të krijojë kushtet ku gratë dhe burrat kanë mundësi të ushtrojnë liritë e tyre, të kenë barazi dhe fuqizim social, nëpërmjet emigrimit por edhe nëpërmjet mundësive të tjera. Politikat dhe iniciativat bashkë-zhvilluese të cilat vlerësojnë burrat dhe gratë emigrantë si aktorë të zhvillimit duhet të bazohen mbi njohjen e rolit të tyre si partnerë të rëndësishëm në shoqëritë pritëse. Kjo reflektohet në treguesit sesa të arritshme janë për ta të drejtat që lidhen me shtetësinë në vendin pritës – në rastin tonë në Greqi – duke mundësuar legalizimin e tyre dhe përfshirjen e barabartë si qytetarë me dinjitet me të drejtat dhe detyrimet përkatëse.

Gjetjet tona, në ngjashmëri me hulumtimet e mëparshme, theksojnë rëndësinë e politikave dhe zbatimin e tyre me efikasitet për të siguruar infrastrukturën e nevojshme fizike, legjislativë dhe administrative në mënyrë që të promovohet një mjedis i qëndrueshëm dhe frytdhënës biznesi, si dhe një cilësi më e lartë zhvillimi njerëzor. Përgjegjësia për një dispozitë të tillë bie para së gjithash mbi qeverinë shqiptare qëndrore dhe lokale. Zhvillimi lokal që i përgjigjet nevojave gjinore, nëpërmjet përfshirjes së dërgesave të migrantëve nuk duhet të konsiderohet si ilaçi çudibërës që do të rregullojë të gjitha problematikat e shoqërisë rurale. Burrat dhe gratë emigrante kanë vite që po mbajnë mbi shpatulla të vetmuar barrën e rëndë të financimit të mbijetesës, shëndetit dhe edukimit të familjeve të tyre, duke zëvendësuar kështu shërbimet e mangëta të politikave të fragmentuara dhe të papërshtatshme sociale që ka vite që mbizotërojnë në zonat rurale. Është përgjegjësi e qeverive për të siguruar kuadrin e përshtatshëm strukturor ku investimet e mëtejshme mund të çojnë në rritjen dhe përmirësimin e lirive dhe të mundësive.

1 | HYRJE

Lidhja komplekse midis procesit të globalizimit dhe zhvillimit ka bërë që migracioni bashkëkohor të konsiderohet një zonë kyçe hulumtimi. Popullsia e emigrantëve në mbarë botën vlerësohet të jetë mbi 200 milionë burra dhe gra të cilët kanë lënë vendet e tyre të origjinës për të jetuar dhe punuar jashtë. Në të njëjtën kohë lëvizjet që ndodhin brenda territorit të një vendi, kryesisht nga zonat rurale në zonat urbane, janë po aq intensive. Gratë luajnë një rol të rëndësishëm në këto lëvizje. Demografikisht, profilet e lëvizjeve nga vende të veçanta kanë ndryshuar, si në aspektin e numrit dhe përbërjen gjinore. Studime mbi feminizimin e migracionit kanë nxjerrë në pah rolin e rëndësishëm dhe ndikimin e grave si aktore në procesin e migrimit. Megjithë rritjen e shpejtë të volumit dhe shumëllojshmërisë së njohurive mbi nyjen migracion-zhvillim, hulumtimi dhe debatet mbi dimensionet gjinore të kësaj çështje, duke përfshirë në mënyrë të veçantë rolin e grave në lëvizjet migratore, vazhdon të jetë i mangët.

Në vitin 2007, Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD) dhe Instituti Ndërkombëtar i Kombeve të Bashkuara për Hulumtim dhe Trajnim për Zhvillimin e Grave (OKB-INSTRAW) filluan një projekt të përbashkët të quajtur 'Migrimi dhe dërgesat: zhvillimi lokal që i përgjigjet nevojave gjinore'. Projekti synon të nxitë zhvillimin lokal që i përgjigjet nevojave gjinore duke identifikuar dhe promovuar mundësitë e përdorimit të dërgesave për jetesë të qëndrueshme dhe ndërtim të kapitalit social në komunitetet e varfra rurale dhe pjesërisht-urbane. Pjesa kërkimore e projektit është kryer në gjashtë shtete: Shqipëri, Republika Domenikane, Lesoto, Marok, Filipinet dhe Senegal.

Qëllimet dhe prioritetet strategjike të projektit janë:

- Rritja e ndërgjegjësimit dhe përmirësimit të aksesit të burimeve produktive tek njësitë familjare marrëse të dërgesave që kryesohen nga gratë, duke rritur në të njëjtën kohë asetet dhe duke forcuar kapacitetet e tyre.
- Pajisjen me informacionin e duhur dhe mbështetjen përkatëse për qeverinë lokale dhe qëndrore me qëllim identifikimin dhe formulimin e politikave që do të rritnin efikasitetin e përdorimit të dërgesave për një jetesë të qëndrueshme dhe ndërtim të kapitalit social.
- Rritja e kapaciteteve të aktorëve kyç për integrimin gjinor në politikat, programet, projektet dhe iniciativat e tjera që lidhin dërgesat me zhvillimin e jetesës së qëndrueshme dhe ndërtimin e kapitalit social.

Ky studim ka për qëllim të ngushtojë hendekun në njohuritë mbi dimensionet gjinore të migrimit dhe dërgesave përmes një analize të hollësishme e cila ndërthur migracionin dhe zhvillimin. Ne i kushtojmë vëmendje të veçantë ndikimit të dërgesave – financiare, materiale (sende) dhe sociale – në proceset gjinore të zhvillimit në vendet e origjinës dhe që transferohen brenda familjeve transnacionale të cilat përfshijnë vendet e orgjinës dhe ato pritëse. Hulumtimi ynë shqyrton këto dinamika në kontekstin pas-komunist të Shqipërisë, e cila është një nga vendet më të varfra të Evropës, dhe vendit pritës më të

rëndësishëm të emigrantëve shqiptarë, Greqisë fqinje, vend pjesëtar i Bashkimit Evropian (BE) si dhe partner i rëndësishëm tregtie me Shqipërinë.

Migracioni bashkëkohor në Shqipëri është një pasqyrim i ndryshimeve dhe ngjarjeve të rëndësishme politike dhe ekonomiko-shoqërore në vend pas viteve 1990-të. Ky emigracion është edhe më i mprehtë duke pasur parasysh izolimin pothuaj total të vendit nga bota e jashtme për gati 45 vjet (1945-1990) nën një prej regjimeve më të ashpra komuniste në botë. Gjatë kësaj kohe emigrimi ishte i ndaluar, pasi konsiderohej si një akt tradhtie ndaj atdheut, ndërsa lëvizjet brenda vendit ishin rreptësisht të kontrolluara nga shteti. Kjo ishte një shikëputje nga e kaluara migratore e shqiptarëve, të cilët ndër shekuj kishin lëvizur në kërkim të punës në vende nga më të ndryshme të botës. Një pjesë e shqiptarëve kanë qenë të detyruar të largohen si rezultat i luftërave të ndryshme, gjakmarrjeve, si dhe pushtimeve të huaja. Një nga eksodet më të përmendura ka qenë emigrimi i rreth 200,000 shqiptarëve kryesisht drejt Italisë së Jugut, pas pushtimit osman të territoreve të banuara nga shqiptarët në shekullin e 15-të. Duke ju rikthyer lëvizjeve migratore pas rënies së komunizmit, tre periudha mund të cilësohen si karakteristike për nga emigrim në masë i popullsisë. E para, që shënon daljen e vendit nga shtypja komuniste (1990-1993), filloi me 'pushtimin e ambasadave' në korrik 1990-të, kur rreth 5,000 njerëz kapërcyen muret rrethuese të ambasadave Perëndimore në Tiranë, duke ngritur kampe brenda tyre e duke kërkuar mbrojtje. Përfundimisht kjo kërkesë u mor parasysh dhe njerëzit u larguan për në vendet perëndimore nëpërmjet ajrit ose detit. Ndërkohë mijëra të tjerë duke rrezikuar jetën, hipën në anije që bënin transportin drejt Italisë ose morrën rrugën në këmbë nëpër shtigjet malore kufitare me shtetin fqinj grek. Episodi i dytë erdhi fill pas një periudhe shkatërrimi dhe gati luftë civile të cilat ndodhën si rezultat i rënies së skemave 'investuese' piramidale. Nga 1993-1996 ekonomia shqiptare u rrit shpejt kryesisht si rezultat i dërgesave të emigrantëve sidomos nga Greqia dhe Italia. Për shkak se sistemi financiar ishte shumë pak i zhvilluar, ndërkohë që kërkesa për kredi ishte e lartë dhe në rritje, skemat private të 'investimeve' lulëzuan. Normat e tyre të larta të interesit – të cilat në një moment të caktuar arritën deri në 50 për qind – nuk mund të ishin të qëndrueshme, dhe si rezultat dështimi mbi pagesat shkaktoi panik dhe vendi u përfshi nga trazirat. Momenti i tretë që shënon lëvizje migratore në masë lidhet me krizën

e Kosovës (1999-2000), e cila prodhoi një fluks prej gjysëm milion shqiptarësh etnik nga Kosova drejt Shqipërisë. Ky eksod i refugjatëve destabilizoi situatën delikate ekonomike dhe demografike, veçanërisht në veri të vendit. Kur shqiptarët e Kosovës në vazhdim u zhvendosën për të kërkuar azil në destinacione të tjera evropiane shumë shtetas shqiptarë u përzjenë në rradhët e tyre. Në vitet midis këtyre episodeve dhe sidomos që nga viti 2000, emigracioni ka vazhduar por me një ritëm konstant. Siç bëhet



Shtigje malore kufitare drejt Greqisë nga Shqipëria jug-lindore. Gjatë gjithë viteve të para dhe deri nga mesi i 1990-ës, grupe burrash dhe djemsh shqiptarë ecnin në këmbë me ditë të tëra, ndonjëherë e merrnin më këmbë gjithë Shqipërinë që nga veriu, para se të kalonin kufirin në mënyrë klandestine nga shtigje të thella malore si kjo në foto.

e qartë nga diskutimi më lart, në themel të emigracionit shqiptar pas-komunist qëndron një ndërthurje e arsyeve ekonomike, politike dhe sociale.

Në lidhje me emigracionin dhe gjininë, migrimi ndërkombëtar në kontekstin shqiptar në përgjithësi përfaqësohet nga një tipologji e kryesuar nga meshkujt, dmth në fillim emigruan meshkujt dhe më pas femrat i ndoqën këta si familjare 'në ngarkim' të tyre. Pjesa dërrmuese e emigrantëve të parë të pas-komunizmit të viteve 1990 ishin burra; gratë – sidomos ato nga zonat rurale – përgjithësisht qëndruan prapa. Madje edhe në rastet kur gratë emigruan, shumë pak vëmendje i është kushtuar tregimeve dhe përvojave të tyre për ato vite të para të emigrimit. Megjithatë, në vitin 2001 gratë shqiptare emigrante në Greqi – vendi pritës në hulumtimet tona – përbënin rreth 40 përqind të të gjithë emigrantëve shqiptarë atje. Pas legalizimit të parë në vitin 1998 shumë familje u bashkuan në Greqi, si rrjedhojë e së cilës numri i grave dhe fëmijëve emigrantë u rrit.

Gjatë dy dekadave të fundit, emigrantët shqiptarë mbërritën në një sërë vendesh të Evropës, si dhe në Amerikën e Veriut, por Greqia dhe Italia mbeten vendet me numrin më të madh të tyre. Afërsia gjeografike dhe kulturore me të dyja vendet dhe një histori e lëvizjes ndër-kufitare kanë mbajtur aktive këtë marrëdhënie të vazhdueshme. Për më tepër, të dyja vendet paraqesin karakteristika të ngjashme në mënyrën sesi ato përthithin emigrantët në ekonominë dhe shoqërinë e tyre, të identifikuar nga King (2000) si modeli Evropian-Jugor i Imigrimit.⁴ Ky model bazohet në karakteristikat specifike të ekonomive dhe shoqërive evropiano-jugore të cilat kërkojnë fuqi punëtore të lirë dhe fleksibël për të përmbushur nevojat e tregjeve informale të punës (veçanërisht në fusha të tilla si bujqësia dhe punët shtëpiake), pasi punëtorët vendas refuzojnë punë të tilla ndërsa nga ana tjetër ka nivele të ulta lindjesh. Emigracioni shqiptar në Itali dhe Greqi shfaq karakteristika të tilla. Kjo është më e theksuar në Greqi, ku shqiptarët emigrojnë kryesisht si punëtorë me kualifikim të ulët dhe janë punësuar kryesisht në ndërtim, punëra përkujdesje dhe sektorin e shërbimeve.

Ky studim është i strukturuar më tej në tetë seksione. Seksioni i dytë ofron një pasqyrë të realitetit shqiptar duke filluar me trajtimin e marrëdhënieve gjinore, i ndjekur nga nënseksione që i referohen vendeve të përzgjedhura për hulumtim: Korçës, Shqipëri dhe Selanikut, Greqi. Seksioni i tretë shqyrton karakteristikat e emigracionit shqiptar në Greqi, duke ofruar informacion mbi evoluimin e lëvizjes, punësimit jashtë vendit, integritet të shqiptarëve në shoqërinë greke dhe rrjetet transnacionale të emigrantëve të cilat fuqizojnë komunitetet e tyre. Seksioni i katërt ofron një vështrim të tipologjisë së familjeve para dhe pas migrimit. Familja transnacionale është një njësi e rëndësishme e analizës që lejon një kuptim më të plotë të procesit të migrimit dhe dërgesave. Seksioni në vijim i referohet thelbit kërkimor të studimit i cili analizon të gjitha aspektet e dërgesave dhe ndikimin e tyre në jetën e emigrantëve, familjeve dhe komuniteteve të tyre të origjinës. Seksioni i gjashtë analizon ndikimin që kanë dërgesat në zhvillimin lokal, një perspektivë kyçe kjo të cilën ky raport shpreson të shqyrtojë, duke qenë se debati mbi dërgesat dhe zhvillimin vazhdon të evoluojë. Në këtë raport gjithashtu përfshihet dhe një prezantim i aktorëve kyçë në mënyrë që të kuptohet roli i tyre i rëndësishëm në procesin e migrimit. Në seksionin në vazhdim rishikimi i politikave publike në Shqipëri dhe Greqi janë shqyrtuar për të ilustruar ligje të ndryshme që kanë të bëjnë me emigrantët si edhe për të identifikuar mënyrat nëpërmjet të cilave potenciali i dërgesave për zhvillim mund të shfrytëzohet më tej dhe të përfshihet në strategjitë kombëtare të zhvillimit. Së fundmi, rekomandimet e nxjerra nga rezultatet e studimit dhe literatura përkatëse janë propozuar për të nxitur më shumë reagime konkrete në mbrojtje të emigrantëve dhe përfshirjes së faktorit gjini në lidhje me dërgesat dhe zhvillimin lokal.

⁴ Karakteristikat kryesore të këtij modeli janë: i) heterogjeniteti i kombësisë së migrantëve, ii) lëvizje me specifike të lartë gjinore nga vende të ndryshme (p.sh shumica gra emigrante nga vende si Filipinet, ose shumica burra emigrantë nga vende si Bangladeshi), iii) migrantët e kanë origjinën nga zonat urbane dhe rurale dhe një përqindje e tyre është me arsim të lartë, dhe iv) ekzistojnë nivele të larta të klandestinëve dhe parregullsisë në dokumenta. Kërkesa e lartë për fuqi punëtore në sektorët e punëve shtëpiake dhe përkujdesjes plotësohet nga gratë emigrante (King 2000: 18; shiko gjithashtu King and Zontini 2000).

1.1 Metodologjia

Hulumtimi është organizuar rreth studimit të familjeve transnacionale, një përjasje kjo e cila bazohet mbi argumentin se vendimarrja për migrim është më tepër një çështje familjare sesa individuale. Megjithatë, marrëdhëniet gjinore brenda këtyre njësive familjare dhe komuniteteve lokale të origjinës dhe destinacionit më gjerësisht janë analizuar dhe diskutohen nga perspektiva individuale e burrave dhe grave. Metodologjia kombinon metodat sasimore dhe cilësore të aplikuara në këtë kërkim. Kjo përbëhet nga plotësimi i një pyetësoi sasior tek 350 familje rurale në jug-lindje të Shqipërisë të cilat kanë të paktën një anëtar/e emigrant/e që jeton në Greqi, dhe një sërë intervistash të thelluara të zhvilluara me një grup të përzgjedhur të këtyre të anketuarëve, me migrantë që janë kthyer nga Greqia, si edhe me familje migrante nga kjo zonë rurale që jetojnë dhe punojnë në qytetin grek të Selanikut. Fshatrat u zgjedhën për arsye të shkallës së lartë të emigrimit që ato kanë dhe shumëllojshmërisë së popullsisë së tyre (myslimanë, kristianë, shqiptarë, rrom, egjiptianë, shqiptarë me etni apo qytetari greke etj.). Përveç kësaj, palët e interesuara lokale, rajonale dhe kombëtare kanë qenë të përfshirë në procesin e hulumtimit përmes një numri intervistash të thelluara dhe diskutimesh në tryezë të rrumbullakët. Këto të fundit shërbyen si platformë për të mbledhur dhe shkëmbyer informacion në nivele të ndryshme të hartimit të politikave dhe ndërhyrjes, si edhe midis llojeve të ndryshme të palëve të interesuara si psh. përfaqësues të qeverisë, akademikë, udhëheqës të komuniteteve lokale, agjenci ndërkombëtare të zhvillimit, Organizata Jo-Qeveritare (OJQ) lokale, grupime emigrantësh dhe sektorin privat.

2 | NJË VËSHTRIM MBI SHQIPËRINË

Shqipëria është një vend i vogël në Evropën juglindore me një popullsi pak më shumë se 3 milion banorë. Historikisht ka qenë – dhe vazhdon të jetë – një nga vendet me ekonomi më të varfër në Evropë, me të ardhura prej \$3,254 të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) për frymë sipas statistikave të vitit 2007 (UNDP-Shqipëria 2008). Periudha e tranzicionit pas-komunist ka qenë një proces i vështirë sidomos në aspektin e zhvillimit ekonomik; megjithatë vendi po ecën përpara edhe pse ngadalë. Karakteristikë e vendit është ekonomia e theksuar informale. Edhe pse bujqësia vazhdon të jetë një nga sektorët më të rëndësishëm të punësimit, ajo kontribuon vetëm një përqindje shumë të vogël të PBB. Emigracioni ka rezultuar në një fluks të dërgesave në Shqipëri të cilat kanë kontribuar në 10 deri 22 përqind të PBB duke filluar prej vitit 1992 (Gammeltoft 2002: 189; Ghosh 2006: 19; King 2005: 149; Piperno 2005; Uruçi and Gëdeshi 2003; Uruçi 2008).

Zhvillimet social-ekonomike (sidomos në vitet pas-komuniste) kanë qenë jo të njëtrajtshme. Diferencat në zhvillimet rajonale, për shembull të zonave të varfra malore në veri dhe jug me jetesë të vështirë e të pasigurt në krahasim me zonat bregdetare me mundësi dhe zhvillim më të madh, reflektojnë sfida dhe arsye emigrimi. Në të njëjtën kohë, faktorë të tjerë, si psh. prejardhja etnike nxjerrin në pah pabarazi sociale dhe ekonomike. Për shembull komunitetet rrom dhe egjiptiane janë ndër më të margjinalizuarat në Shqipëri, si dhe në procesin e emigrimit.⁵ Faktorët ekonomikë dhe politikë influencojnë në mënyrë domethënëse praktikatat sociale dhe kulturore që qëndrojnë në themel të lëvizjeve dhe përvojave të emigrantëve.

2.1 Marrëdhëniet gjinore në Shqipëri: situata e grave

Marrëdhëniet midis gjinive ndryshojnë në varësi të zonës rurale apo urbane, si dhe ndarjes gjeografiko-kulturore. Me gjithë përmirësimin e ngadaltë të këtyre marrëdhënieve në vite, si rezultat i ndryshimeve të sistemeve dhe procesit të emigrimit, shoqëria shqiptare vazhdon të udhëhiqet nga norma tradicionale patriarkale. Në përgjithësi bijtë vazhdojnë të jenë më të preferuar se vajzat, ndërkohë që sipas traditës patrilokale gratë zhvendosen në shtëpinë e burrit pas martesës. Djali më i vogël dhe gruaja e tij kanë përgjegjësi për tu kujdesur për prindërit e tij, për ndikimin e së cilës do të diskutohet më vonë kur të flasim mbi dërgesat. Para luftës së dytë botërore më shumë se 90 përqind e femrave në të gjithë vendin ishin analfabete – sidomos në zonat rurale dhe verilindore të vendit – dhe vendi kishte vetëm 21 mësuese, ndërsa vetëm më pak se 3 përqind e nxënësve në shkollat e mesme ishin femra (Hall 1994: 83; Logoreci 1977: 157-8). Gjatë viteve të regjimit komunist kushtet e grave pësuan ndryshime dhe arritje domethënëse si rezultat i politikës së qeverisë për emancipimin e femrës. Nga arritjet mund të përmendim uljen e nivelit të analfabetizmit, përfshirjen e femrës në të gjitha nivelet e edukimit, rritjen e numrit të femrave pjesmarrëse në politikë si dhe përfshirja në tregun e punës.

5. Rromët dhe egjiptianët (të njohur ndryshe edhe me emrin Evgjit) janë dy komunitetet kryesore rrome në Shqipëri.

Rënia e regjimit komunist u shoqërua me efekte negative për jetesën e grave. 'Rregullat shoqërore zëvendësuese' të cilat u formëzuan në këtë proces, ishin të bazuara në një ri-zbulim të traditës dhe ri-prodhim të strukturës patriarkale (Mai dhe Schwandner-Sievers 2003: 224). Siç sygjeron Nixon (2006), ky transformim pas-komunist u shoqërua nga 'role gjinore krejt të kundërvëna', të cilat u reflektuan në zgjerimin e boshllëkut midis sferës publike dhe asaj private. Sfera publike u shndrrua shpejt në arenë ku burrat dominonin, ku burrëria 'u idealizua si e fuqishme, vendimarrëse dhe e orientuar drejt fitimit', ndërsa femërorja u bashkëshoqërua me 'vlerat e shtëpiakes, përkujdesjes, dhe rritjes së fëmijëve'. Pas rënies së komunizmit koncepti i emancipimit të femrës u lidh ngushtë më të kaluarën komuniste – e kaluar e cila konsiderohej nga shumë segmente të popullsisë si një sistem që ish përpjekur të shkatërronte familjen – dhe kështu emancipimi i gruas nuk gjeti përkrahje të gjerë në popull (Brunnbauer 2000; Nixon 2006). Të gjithë këta faktorë së bashku me kalimin nga një ekonomi e planifikuar në ekonominë e tregut, pra dhe me humbjen e sigurisë për vendin e punës - edhe pse kjo ish e paguar keq, rezultuan në erozionin dalëngadalë të arritjeve të mëparshme, sidomos në lidhje me pjesëmarrjen e grave në politikë dhe punësimin e tyre.

Përsa i përket nivelit të punësimit, gratë vazhdojnë të jenë shumë më prapa burrave, përsa i përket pagesës, llojeve të punës, dhe mundësitë për punësim, sidomos në zonat urbane dhe sidomos tek shtresat me arsim të ulët. Për shembull, nëse dy të tretat e grave në moshë pune (15-54 vjeç) ishin të punësuar në vitin 1991, në vitin 2002 më pak se gjysma e grave në këtë grupmoshë ishin formalisht të punësuar. Për burrat në moshë pune ky tregues ra nga 85 përqind në më pak se 75 përqind për të njëjtën periudhë kohore (Moreno-Fontes Chammartin and Cantú-Bazaldúa 2003). Gjithashtu gratë fitojnë shumë më pak se burrat – rreth 68 përqind të pagës që paguhen burrat për një muaj – për dy arsye, sepse ato punojnë më pak orë në ditë dhe sepse paguhen më pak për orë pune (Banka Botërore 2006). Për më tepër, burrat zotërojnë rreth 92 përqind të pronave në vend dhe marrin rreth 84 përqind të PBB (UNDP-Shqipëri 2008: 13).

2.2 Vendi i origjinës në Shqipëri: fshatrat e Korçës

Ky projekt kërkimi kishte si qëllim kryesor studimin e korridorit migrues që lidh fshatrat e Shqipërisë juglindore me qytetin e Selanikut në Greqi. Këto fshatra janë Pojan, Zvezdë dhe Kreshpanj në



Gratë shqiptare që qëndrojnë në fshatra kryejnë një sërë punësh prodhuese dhe riprodhuese. Në këtë foto, një grua nga Pojani po punon në vegël.

rrethin e Korçës. Korça është poli më i rëndësishëm i jugut dhe juglindjes së vendit, me vendodhje gjeografike buzë një prej akseve kryesore rrugore të transportit dhe tregtisë, që lidhin Shqipërinë me pjesën tjetër të Ballkanit dhe BE-në nëpërmjet Maqedonisë dhe sidomos Greqisë. Në fakt, më shumë se çereku i numrit të ndërmarrjeve të huaja në zonën e Korçës janë greke, gjë e bën këtë zonë një nga qendrat më të rëndësishme të investimeve greke në Shqipëri (Belba 2005: 88).

Zona e Korçës është e njohur për shkallën e lartë të emigracionit. Një numër i konsiderueshëm i këtyre lëvizjeve vijnë nga zonat e thella –

sidomos nga fshatrat e thellë malorë, të cilët kanë humbur më shumë se 30 përqind të popullsisë në këto 15 vitet e fundit – në drejtim të rrethinave urbane brenda zonës së Korçës (Korçë Municipality 2005: 15; Korça Regional Council 2005: 24). Shumë të tjerë janë larguar në drejtim të qendrave më të largëta si Tirana dhe Vlora, si dhe kanë emigruar jashtë vendit. Në fakt, rrethi i Korçës rezulton si një nga rrethet me numrin më të madh të popullsisë të larguar brenda dhe sidomos jashtë vendit (Carletto et al. 2004: 27). Rreth 60 përqind e popullsisë së migruar brenda vendit u vendosën në Tiranë. Ndërsa nga ata që emigruan jashtë vendit, numri më i madh u vendos në Greqinë fqinje.

Të tre fshatrat e përfshirë në këtë studim, kanë përjetuar pasojat e migracionit gjatë një dekade e gjysëm të transformimit pas-komunist. Përsa i përket përbërjes së popullsisë, fshatrat e zgjedhur janë interesante për tre arsye. Së pari, popullsia e tyre është mjaft e përzier sidomos në Pojan, ku komunitetet e ndryshme si për shembull myslymanë, ortodoksë, egjiptianë dhe rom jetojnë së bashku me njëri-tjetrin. E dyta, një numër i konsiderueshëm banorësh egjiptianë (60 familje) dhe rom (35 familje) jetojnë në këto fshatra. Duke patur parasysh që këto komunitete radhiten ndër më të marginalizuarit në Shqipëri, zona e zgjedhur konsiderohet e favorshme për të studiuar efektet e emigracionit mbi këto grupe të popullsisë. E treta, një pjesë e popullsisë ortodokse në këtë zonë deklarohet me prejardhje greke, proces i cili është intensifikuar duke marrë parasysh të mirat që rrjedhin nga ky deklaram, psh në shërbime më të shpejta për marrje vizash, lejeqëndrimi dhe punësim në Greqi (de Rapper 2005; Kretsi 2005). Së fundi, Pojani ka përjetuar një valë migrimi të brendshëm me popullsi të ardhur nga fshatrat e thella malore të zonës.

2.3 Vendi pritës në Greqi: Selanik

Në Selanik jetojnë një numër i konsiderueshëm emigrantësh nga fshatrat e përfshira në studim. Ai gjithashtu radhitet i dyti pas Athinës përsa i përket madhësisë së komunitetit të emigrantëve shqiptarëve në Greqi. Për më tepër, Selaniku është gjeografikisht shumë afër me këto fshatra, ndërkohë që është një metropol i madh, pozitë e cila e bën interesante studimin e dinamikave ndërkufitare të emigracionit si dhe praktikat transnacionale që rrjedhin prej tyre.

Karakteristikat e ekonomisë së Selanikut kanë ndikuar në punësimin e grave sidomos në industri. Kjo lidhet ngushtë me mbizotërimin e sektorit industrial, sidomos fabrikat, një sektor ky shumë i rëndësishëm për Selanikun, i cili karakterizohet nga biznese të vogla familjare me nevojë të lartë fuqie punëtore. Këto janë vende tipike të punësimin të grave shqiptare (Hatziprokopiou 2003: 1043-44). Këto biznese janë shpërndarë thuajse në mënyrë të njëtrajtshme në të gjithë qytetin, ashtu si dhe shumica e aktiviteteve tregtare, qendrave të argëtimit, dhe vendeve të punësimin të emigrantëve (Hatziprokopiou 2004: 330-31).

Së fundi, historia e gjatë shumëkulturore e Selanikut, që ka ardhur si rezultat i pritjes së popullive nga vende të ndryshme të Ballkanit dhe Mesdheut, është rikrijuar në sajë të migrimeve të reja dhe vendosjes në qytet të grupeve të ndryshme etnike, sociale, fetare dhe kulturore. Në disa raste këto lidhje historike janë ripërtërirë dhe riformëzuar në marrëdhënie dhe partneritete të ndërsjellta transnacionale të bazuara mbi lidhjet të forta historike dhe kulturore dhe të favorizuar nga afërsia gjeografike. Në zemër të këtyre fushave të lidhjeve qëndrojnë rrjetet sociale ndërkufitare të cilat kanalizojnë jo vetëm lëvizjet e emigrantëve por gjithashtu dhe të tregtisë, transportit, biznesit dhe investimeve (Hatziprokopiou 2006: 85, 106-08).

Harta 1. Harta e Shqipërisë në Ballkan



Shigjetat tregojnë vendet ku u krye studimi

<http://geology.com/world/albania-satellite-image.shtml>

3 | KARAKTERISTIKAT E MIGRACIONIT SHQIPTAR NË GREQI

Greqia është destinacioni më i rëndësishëm për emigracionin shqiptar jashtë vendit. Emigrimi i shqiptarëve në Greqi ka kaluar kryesisht nëpër tre rrugë kryesore: dy kalimet kryesore në Kakavijë (që të çon në drejtim të Janinës) dhe Kapshticë (që të çon në drejtim të Kosturit dhe Follorinës) si dhe nyjen e shkurtër detare nga Saranda në Korfuz. Një rrugë e katërt shkon përmes Maqedonisë jugore për në Selanik. Në fillim dhe deri nga mesi i viteve 1990, grupe të vogla burrash e djemsh ecnin për ditë me radhë, disa herë duke përshkruar edhe gjithë Shqipërinë nëse niseshin nga zonat veriore dhe veri-perëndimore, për të kaluar kufirin për në Greqi në mënyrë klandestine përmes shtigjeve malore në pjesë të thella kufitare (King et al. 1998). Shumë pak gra iu bashkangjitën këtyre udhëtimeve, megjithëse gratë dhe fëmijët ishin në numër më të madh tek grupet emigruese të komuniteteve rom dhe egjiptiane (De Soto et al. 2005). Me legalizimin e emigrantëve udhëtimi midis dy vendeve tashmë ndodh më shumë përgjatë pikave doganore të kalimit kufitar. Pjesa dërrmuese e migrimit në Greqi sidomos në vitet 90-të, ka qenë i natyrës vajtje-ardhje, gjë që ka vështirësuar një përcaktim më të saktë të numrit të emigrantëve shqiptarë në Greqi. Megjithatë është e rëndësishme të theksohet se ky emigrim është i përhapur në të gjithë Shqipërinë, ku shumica e familjeve shqiptare kanë një ose më shumë anëtarë të familjes emigrantë në Greqi.

Pjesa më e madhe e emigrantëve shqiptarë në Greqi janë burra, por numri i grave ka ardhur në rritje në krahasim me fillimet dhe mesin e viteve 1990. Edhe pse gratë emigrante shqiptare në këtë vend e kanë fuqizuar rolin e tyre ekonomik në familje përmes të ardhurave që ato vetë fitojnë nga puna e tyre, ato vazhdojnë të jenë të disfavorizuara nga legjislacioni dhe politikat migratore greke të cilat rforcojnë trajtat patriarkale të varësisë dhe diskriminimit gjinor. Shumica e grave shqiptare kanë emigruar në Greqi nëpërmjet bashkimit familjar me bashkëshortët e tyre. Për ta ilustruar me një shembull: nga numri total i lejeve të qëndrimit për qëllim bashkimi familjar të lëshuara nga autoritetet greke midis viteve 2003-2004, pak më shumë se 80 përqind iu dhanë emigrantëve shqiptarë (Baldwin-Edwards 2004: 12). Një rritje e pranishmë së grave në proporcion me atë të meshkujve shpesh konsiderohet si një shenjë stabiliteti i komunitetit migrant në shoqërinë e vendit pritës. Në rastin e shqiptarëve ky fakt përforcohet dhe më shumë nga prania e fëmijëve. Kështu rreth 50,000 fëmijë ishin të rregjistruar në shkollat greke në vitin 2001 sipas regjistrimit të popullsisë në Greqi në 2001 (Barjaba and King 2005). Sipas një burimi tjetër të dhënash – Ministria Greke e Arsimit – numri i fëmijëve shqiptarë të rregjistruar në shkollat shtetërore greke për vitin 2002-2003 kapte shifrën rreth 70,000 (Baldwin-Edwards 2004: 18-20). Duke përbërë më shumë se 72 përqind të fëmijëve të huaj me origjinë jo-greke në këto shkolla, përqindja e fëmijëve ishte më e lartë se dhe vetë pjesa e emigrantëve shqiptarë si përqindje e gjithë emigrantëve në Greqi. Të dhënat mbi lejen e qëndrimit në janar të vitit 2006, shënuan më shumë se 90,000 fëmijë shqiptarë nën moshën 16 vjeç, shifër kjo që përbënte rreth 25 përqind të emigrantëve shqiptarë në Greqi (Baldwin-Edwards and Kolios 2008: 4). Pjesë përbërëse e këtij mozaiku është dhe një numër i konsiderueshëm gjyshërisht, numër ky që ka qenë vështirë të përcaktohet tamam. Regjistrimi i popullsisë i vitit 2001 në Greqi shënoi rreth 10,500 shqiptarë të moshës 65 vjeç e sipër, ose thënë ndryshe 2.4 përqind të numrit total të shqiptarëve

në Greqi (Cavounidis 2004: 42). Kjo moshë merret zakonisht me përkujdesjen e fëmijëve dhe me punët e shtëpisë, por në disa raste mund të kryejnë shërbime të njëjta për qytetarët e moshuar grekë si pjesë e tregut jo formal të punës (King and Vullnetari 2006).

3.1 Punësimi

Ka një lidhje të dukshme midis shpërndarjes hapësinore të shqiptarëve në Greqi dhe llojeve të punëve që ofrohen nga tregu i punës. Zonat urbane si për shembull Athina, Selaniku, si dhe ishujt kryesorë ofrojnë mundësinë e punësimit gjatë gjithë vitit (edhe pse shpesh në formën e punësimit të përkohshëm); zonat bujqësore dhe turistike ofrojnë kryesisht punë sezonale (King and Vullnetari 2003). Në zonat rurale të Greqisë, shqiptarët punojnë në bujqësi dhe punëra të përgjithshme, sidomos në sezonin e verës kur kërkesa e tregut për mbledhjen e frutave dhe aktivitete të tjera pune krahu shënon rritje. Por shqiptarët bëjnë dhe punë 'të vogla' rreth e rrotull fermës për të cilat jo gjithmonë paguhen. Fuqia punëtore migrante (sidomos ajo shqiptare) ka zëvendësuar pothuaj gjithë fuqinë punëtore të paguar vendase në bujqësinë greke, dhe përqëndrohet kryesisht në zonat me bujqësi intensive si për shembull pllaja e Thesalisë ose plantacionet e ullinjve në Korfuz (Fakiolas 2003; Kasimis et al. 2003). Puna bujqësore ishte një nga aktivitetet kryesore për emigrantët shqiptarë në Greqi sidomos në vitet e para të 1990-tës, por ajo vazhdon të mbetet një nga mënyrat e kufizuara për të marrë leje pune të përkohshme në Greqi, gjë që reflekton nevojat e këtij sektori dhe rëndësinë e fuqisë punëtore emigrante në të. Me kalimin e kohës shqiptarët kanë gjetur lloje më të sigurta punësh në zona rurale, si për shembull nëpër ferma kafshësh, pulari, sera perimesh dhe rregullime kopshtesh e gjelbërimi.

Shumë shqiptarë janë të punësuar në industrinë sezonale turistike, përgjatë bregdetit dhe sidomos në ishuj. Burrat ashtu si dhe gratë janë punësuar në komplekse turistike, hotele dhe restorante. Ata bëjnë lloje të ndryshme punësh si për shembull: pastrues, punë guzhine, kamarier, roje, përkujdesen për gjelbërimin, punë mirëmbajtje, e të tjera. Në Athinë, Selanik dhe në qytete të tjera, shqiptarët janë të punësuar si fuqi punëtore e pakualifikuar ose gjysmë e kualifikuar në ndërtim, hoteleri, restorante, në fabrika të vogla ose në sektorin e shërbimeve që lidhen me aktivitete si rrobaqepsi, lyerje dhe zbukurime, transport, në sektorin e shërbimeve personale si pastruese, kopshtarë, përkujdesje fëmijësh, përkujdesje për të moshuarat e të tjera. Një numër vajzash dhe grash në moshë të re (dhe disa djem) janë përfshirë në industrinë e seksit (Psimmenos 2000).

Tregu i punës për shqiptarët në Greqi

Sipas të dhënave nga regjistrimi i popullsisë në Greqi në vitin 2001, burrat shqiptarë ishin të punësuar kryesisht në sektorin e ndërtimit (42 përqind i totalit) dhe bujqësisë (23 përqind), por edhe në industri (12 përqind), dhe turizëm (po 12 përqind). Nga ana tjetër, gratë shqiptare punonin në turizëm (19 përqind), bujqësi (15 përqind), dhe industri (9 përqind); më shumë se gjysma (52 përqind) ishin të punësuar në kategorinë 'të tjera' kategori e cila përfshin një pjesë të madhe të punësuarash në sektorin e shërbimeve shtëpiake si pastruese shtëpish, pastruese në hotele, përkujdesje ndaj të moshuarve dhe fëmijëve, e të tjera (Baldwin-Edwards 2004). Pjesa dërrmuese e punëve të kryera nga shqiptarët në Greqi janë punë të cilat nuk kërkojnë ndonjë kualifikim dhe janë punë jo të sigurta. Kjo situatë reflekton natyrën e dy-degëzuar të tregut të punës në Greqi, treg i cili përbëhet nga sektori 'kryesor' me punë të sigurta dhe 'legale', të zëna kryesisht nga shtetasit grekë, dhe sektori 'dytësor' ose 'periferik' i tregut me punë që kanë status të ulët, punë të cilët pranohen kryesisht nga emigrantët (Barjaba and King 2005).

Jo të gjithë migrantët që punojnë në këto punë krahu janë të pakualifikuar. Shumë shqiptarë kanë humbur përdorimin e aftësive dhe dijeve të shkollimit të tyre, pasi nuk kanë qenë në gjendje të gjejnë punë në nivelin e tyre profesional (Barjaba and King 2005; për Greqinë shiko dhe Hatziprokopiou 2006). Kjo situatë është krijuar nga statusi i tyre si emigrantë të parregullt, mosnjohja e diplomave shqiptare jashtë vendit (si në Greqi), si dhe natyra e tregut të punës në Greqi. Ky treg pune përbëhet nga sektori 'kryesor' me punë të sigurta dhe 'ligjore' që në shumicën e rasteve plotësohen nga vetë grekët, dhe sektori 'dytësor' ose 'periferik' i punëve me status shoqëror të ulët dhe të pasigurta, që shpesh plotësohen nga migrantët (Barjaba and King 2005).

3.2 Integrimi

Reagimi i grekëve ndaj emigrimit të më shumë se gjysëm milioni shqiptarësh që prej vitit 1990 është influencuar në mënyrë të dukshme nga imazhe dhe konstrukte të prezantuara në media, të cilat më pas përdoren nga politikanët për të arritur qëllimet e tyre politike.⁶ Këto fushata kanë qenë kryesisht negative. Në fillim të mirëpritur, shqiptarët shumë shpejt u denigruan duke ju ngjitur një seri stereotipash shumë negativë, shpesh të përshkruar si njëzëz 'mashtues, primitivë dhe të pabesë'... 'njerëz të rrezikshëm dhe kriminelë' (Lazaridis and Wickens 1999: 648). Stigmatizimi dhe përjashtimi social i ashpër i shqiptarëve ka qenë influencuar para së gjithash nga disa faktorë. Së pari 'dukshmëria' e komunitetit shqiptar për nga ana e numrit të tyre – shqiptarët përbëjnë midis 65 dhe 70 përqind të gjithë migrantëve në Greqi; grupi tjetër që renditet më pas janë bullgarët me vetëm 5 përqind të totalit. Më tej vijnë faktorë si perceptimi i grekëve të së kaluarës së tyre (kur ata vetë ishin të varfër dhe emigrantë në Amerikë apo Gjermani), ndryshimi i rolit të Greqisë në Evropën e sotme (njëkohësisht një prej vendeve me zhvillim të ulët ekonomik brenda BE, por vend i zhvilluar karshi fqinjëve të Ballkanit) dhe sidomos marrëdhëniet konfliktuale shqiptarogreke (qoftë si rrjedhim i periudhës osmane, apo luftës së ftohtë). Më gjithë vështirësitë që kanë hasur, shqiptarët kanë gjetur mënyra për të kaluar pengesat e shumta përjashtuese të vëna përballë tyre, duke arritur një integrim dinamik dhe të admirueshëm social-ekonomik. Shumica e shqiptarëve mësojnë greqisht shpejt dhe nëpërmjet punës dhe marrëdhënieve fqinjësore në nivel individual dhe lokal, kanë arritur të krijojnë marrëdhënie dinamike në shoqërinë greke (Hatziprokopiou 2003; 2006). Ata gjithashtu luajnë me identitetin e përzier ballkanik duke ndryshuar emrat dhe pagëzuar fëmijët e tyre në kishat greke. Megjithatë, gjatë përpjekjeve të tyre për të fshehur indentitetin me qëllim që të bëhen 'të padukshëm' nga grekët dhe në këtë mënyrë t'i shpëtojnë stigmatizimit, ata në të njëjtën kohë rrezikojnë të humbasin kulturën e tyre dhe 'vitalitetin e gjuhës' duke çuar në asimilimin e së paku brezit të dytë (Gogonas 2007).

Gjatë viteve 1990 emigrimi në Greqi ishte i përkohshëm dhe për kohë të shkurtër. Gjithashtu Greqia përdorej si urëkalimi për të krijuar rezerva financiare të përkohshme dhe përfituar nga eksperiencia për tu vendosur për më gjatë ose përfundimisht në një shtet tjetër të Evropës Perëndimore, në të shumtën e rasteve përmes udhëtimit për në Itali; kështu që Greqia njihej si 'çelësi' dhe Italia si 'dera' (King et al. 2003). Megjithatë, gjatë këtyre viteve të fundit, emigrimi i shqiptarëve në Greqi është në proces maturimi, dhe ngritja e nivelit social-ekonomik po shoqërohen nga procesi i vendosjes dhe stabilizimit në këtë vend (Gogonas 2007; Hatziprokopiou 2003; 2006; Labrianidis and Hatziprokopiou 2005; Labrianidis et al. 2004; Pratsinakis 2005).

3.3 Rrjetet transnacionale të migrantëve

Në përgjithësi migrimi ka forcuar rrjetet familjare ekzistuese pasi këto ishin mënyra kryesore për t'u informuar për mundësi migrimi dhe më pas vend i parë për mbështetje për emigrantët e erdhur rishtas në Greqi. Ky aspekt i dyti kish të bënte me sigurimin e një vendi për të fjetur dhe ushqim në ditët apo javët e para të mbërritjes në Greqi, ndihmë për të kërkuar për punë, njohje me njerëzit etj. Por këto rrjete nuk ishin

6. (Baldwin-Edwards dhe Apostolatos 2009; Barjaba dhe King 2005; dhe për proceset paralele në Itali shiko King dhe Mai 2004; 2008).

gjithmonë të dobishme, pasi disa familjarë ose nuk mundeshin t'i jepnin ose thjesht nuk i dhanë ndonjë ndihmë emigrantëve të porsaerdhur. Kjo bëri që disa lidhje që më parë ishin të afërta të prisheshin. Nga ana tjetër, në Shqipëri rrethi i gjerë familjar ose fqinjët dhanë mbështetje duke u kujdesur për të moshuarit apo fëmijët e vegjël të emigrantëve që ishin lënë pas, apo dhe duke u kujdesur për shtëpitë e emigrantëve të lëna bosh. Në shkëmbim kujdestarët merrnin dërgesa në para ose mall. Kur këto ndodhnin brenda të njëjtës familje, shërbimet dhe paraja ishin pjesë e detyrimeve reciproke midis anëtarëve të familjes. Kur përfshiheshin fqinjët (si në rastin e përkujdesjes për shtëpitë), dhurata të vogla si për shembull rroba u jepeshin në shkëmbim të kujdesit. Por kur theksojmë rëndësinë e këtyre lidhjeve dhe rrethit familjar, nuk duhet të harrojmë që në disa raste në këto familje zinte vend dhuna dhe shtypja, rebelimi dhe rezistenca, sidomos për gratë dhe djemtë e rinj. Për shembull, në shumicën e intervistave tona me djemtë e rinj emigrantë në Selanik, ose me prindërit e këtyre djemve të rinj në fshatrat përkatës, episodi i parë i emigrimit të këtyre të rinjve tregohet në mënyrë të njëjtë nga të gjithë. Ata ishin larguar nga Shqipëria si adoleshentë, pa lejen dhe dijeninë e prindërve, ose ne rastin më të mirë pa dijeninë e babait. Ata thjesht ikën nga shtëpia pasi të dyja palët e dinin mirë që prindërit (sidomos babai) nuk do t'i lejonin një emigrim të tillë në rrethana të pasigurta dhe me vështirësi fizike dhe psikologjike – siç ishin pjesa më e madhe e këtyre udhëtimeve – në një moshë aq të re (disa prej tyre ishin 12 apo 13 vjeç kur u larguan). Vendimi pra ishte një çështje personale dhe jo familjare. Këto përpjekje të para ishin një shenjë rezistence dhe revolte ndaj autoritetit patriarkal dhe fuqisë së pakundërshtueshme të burrit me të vjetër në familje.

Botimet mbi emigrantët shqiptarë kanë vlerësuar rolin e kufizuar që shoqatat kanë ka luajtur përgjatë viteve, si në lidhje me integrimin e tyre në shoqërinë vendase ashtu dhe në lidhje me zhvillimin e komuniteteve të prejardhjes. Padyshim, një faktor ndikues në formimin e grupimeve ka qenë sesa i freskët (pra jo historik) ka qenë migrimi i periudhës pas-komuniste. Ndërkohë që diasporat e ndryshme historike kryesisht në SHBA, Itali, Greqi, Australi, Stamboll, Bukuresht dhe Kairo u bënë qendra të aktivitetit dhe frymëzimit kombëtar, ato u pasuruan vetëm me një curril të hollë 'gjaku të ri' gjatë viteve të komunizmit – ata që arritën ti shpëtojnë 'kështjellës' shqiptare (Vullnetari 2007). Me përjashtim të diasporës në SHBA, e cila arriti të bëhet ekonomikisht dhe politikisht e fuqishme në atë vend, komunitetet shqiptare në vende të tjera u dobësuan dhe në disa vende si Greqia ato u asimiluan pothuajse krejtësisht. Migrimi bashkëkohor i shqipëtarëve në shtete të tjera si Mbretëria e Bashkuar, nuk pati baza të hershme dhe si rrjedhojë nuk mund të ndërtohej mbi eksperiencat dhe lidhjet e grumbulluara prej vitesh.

Për më tepër, faktorë të tjerë janë përmendur nga një numër kërkuesish shkencore në lidhje me 'dobësinë' e shoqatave shqiptare në destinacionet më të rëndësishme si Greqia dhe Italia. Tradita e kolektivizimit të detyruar ashtu si dhe metodat shtrënguese të spiunimit – të gjithë presupozoheshin të spiunonin mbi njëri-tjetrin – gjatë të kaluarës jo shumë të largët komuniste kanë luajtur një rol në nivelin e mosbesimit që shqipëtarët shfaqin ndaj njëri-tjetrit dhe kundrejt organizatave vullnetare të komunitetit. Kjo është e kundërta përse i përket besimit të madh që ata kanë tek pjesëtarët e familjes, besim i cili ka vazhduar përgjatë viteve – sidomos gjatë 'grushtit të hekurt' komunist dhe gjatë trazirave dhe pasigurisë të periudhës së transformimit pas-komunist (Lubonja 2001, Murzaku dhe Dervishi 2003). Sidomos në Greqi, emigrantëve i është dashur të përballen me një shkallë të lartë shfrytëzimi, diskriminimi dhe marginalizimi e cila u ka lënë shumë pak hapësira për të zhvilluar kapitalin e tyre social më gjerë (Gropas dhe Triandafyllidou 2005). Fakti që pothuaj të gjitha organizatat shqiptare në Greqi datojnë prej vitit 1998 – vit kur emigrantët u legalizuan për herë të parë – flet shumë për këtë faktor. Dhe sigurisht, çështje të një natyre më praktike janë gjithashtu shumë të rëndësishme si për shembull se si orët e zgjatura të punës së emigrantëve i kushtëzojnë mundësitë për t'u takuar me njëri-tjetrin.

Megjithatë kjo po ndryshon dhe ekzistojnë shenja inkurajuese të bashkëpunimit. Në 2008 kishte të paktën 100 organizata të emigrantëve shqiptarë në Greqi (përveç atyre të emigrantëve etnikë grekë), 80 përqind

7. Nga intervista e thelluar me Znj. Dhimitra Malo, presidente e Lidhjes Pan-Helenike të Grave Emigrante. Data e intervistës: 22 Dhjetor 2007.

e të cilave janë me bazë në Athinë. Kjo reflekton në një farë mase përqëndrimin gjeografik të komunitetit shqiptar, por gjithashtu edhe mundësitë dhe hapësirat për këto lloj aktivitetesh. Pjesa më e madhe e këtyre organizatave janë të vogla dhe ka një farë shtyrje në dy vitet e fundit për ri-grupimin e tyre nën organizime 'çadër'.⁷ Kështu, në 2008 kishte dy njësi të tilla: a) Liga e Emigrantëve Shqiptarë; dhe b) Federata e Shoqatave Shqiptare, secila prej të cilave përbëhet nga 25 shoqata emigrantësh. Megjithatë ka edhe shoqata të tjera që nuk janë anëtare të këtyre grupimeve 'çadër'. Shumë organizata vuajnë nga mosmarrëveshje brenda tyre, siç u vu re nga intervistat tona dhe biseda informale me një numër të lidërve dhe nëpërmjet diskutimeve në grup në Selanik. Këto lidhje antagonistike vinin ose nga mosmarrëveshje personale ose nga faktorë më të thellë ideologjikë (lexo: bindje politike). Këto janë shembuj klasikë të aktiviteteve transnacionale, ose dërgesa sociale me kah të kundërt, domethënë politikat e vendit mëmë transmetohen nga Shqipëria tek emigrantët në Greqi. Dhe vërtet, degë të tre partive kryesore politike – Partia Socialiste (PS), Partia Demokratike (PD) dhe Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) – janë krijuar në Greqi, dhe shpesh janë përdorur si mjete për të grumbulluar mbështetjen e emigrantëve gjatë fushatave elektorale në Shqipëri.

Në pesë vitet e fundit ka pasur një rritje të numrit të organizatave që e bazojnë anëtarësinë në qytetin, fshatin apo krahinën e origjinës së emigrantëve (megjithëse ato mbeten ende larg shoqatave tipike Latino-Amerikane të Qytetit të Vendlindjes).⁸

Megjithëse anëtarësimi i tyre aktual mund të jetë i ulët, përllogaritet që mesatarisht rreth 200 emigrantë ndjekin secilin nga aktivitetet e tyre kulturore në Greqi. Pjesa më e madhe e këtyre organizatave kanë një grup thelbësor anëtarësh që kanë lidhje familjare apo shoqërore, dhe sidomos në organizatat më të mëdha menaxhimi është i dominuar nga burra në të pesëdhjetat. Përveç organizatave të tipit krahinore, ka edhe grupime të tjera që organizohen në bazë të interesave profesionale, sidomos nëpërmjet shkrimtarëve apo artistëve.

Në ndryshim nga organizata të tjera emigrantësh, ato shqiptare pothuajse gjithmonë përqendrohen në çështje kulturore dhe të ruajtjes së identitetit shqiptar. Duke ju druajtur humbjes së traditës kulturore këto organizata fokusohen sidomos në njohjen dhe shoqërimin e brezit të dytë, sidomos nëpërmjet mësimit të gjuhës shqipe.

Ka pak organizata emigrantësh shqiptarë që promovojnë të drejtat civile, ligjore dhe humane të këtij komuniteti në Greqi, dhe ka akoma edhe më pak që përqendrohen në çështjet e grave ose që kanë një shumicë grash në bordin e tyre këshillues apo drejtues. Përgjithësisht, ekzistojnë katër tipe organizatash:

- Ato që përqendrohen në politikat kulturore, zakonisht me anëtarë me prejardhje nga një zonë/krahinë e përbashkët;
- Ato që përballen me nevoja praktike të emigrantëve siç janë dokumentacionet, racizmi etj;
- Ato të emigrantëve me etni greke;
- Degë të partive kryesore politike shqiptare.

Gjatë punës sonë në Selanik, arritëm në përfundimin se pjesa më e madhe e organizatave emigrante atje ishin mbledhje elitare të shqiptarëve me nivel edukimi të lartë, ndërkohë që pjesmarrja në masë e emigrantëve të tjerë shqiptarë është shumë e vogël. Këta të fundit mblidhen kryesisht për koncerte të organizuara nga grupe të ndryshme artistësh shqiptarë të cilët udhëtojnë për të argëtuar bashkëatdhetarët e tyre në Greqi; ose në mbledhje festive me rastin e ditës kombëtare shqiptare dhe ngjarje të tilla të ngjashme. Megjithatë, hapësira socio-politike transnacionale janë duke u krijuar, ndërkohë që përshkrime të 'atdheut' tregohen dhe riprodhohen, në të njëjtën kohë që dërgesat sociale rrjedhin në kahun e kundërt (Gropas dhe Triandafyllidou 2005; Maroukis 2005a).

8. Shoqatat e Vendlindjes janë organizata emigrantësh në vendet ku ata emigrojnë që mundësojnë mbajtjen e lidhjeve me krahinat apo fshatrat/qytetet e prejardhjes dhe japin mbështetje ekonomike për to.

4 FAMILJET MIGRANTE SHQIPTARE

Duke qenë se emigrimi ishte pothuajse zero gjatë dekadave të regjimit komunist, Shqipëria është një nga vendet e pakta ku ne mund të analizojmë sa më qartë, pasojat e lëna nga emigrimi në popullatën vendase si dhe zhvillimet e tyre social-ekonomik. Duke pasur parasysh faktin se Shqipëria ishte një shoqëri patriarkale dhe konservatore deri në vitet 1990, llojet e njësive familjare në zonat rurale nuk shfaqën shumë ndryshime. Lloji më i përhapur i njësive familjare ishte familja me shumë breza, ku prindërit e moshuar jetonin së bashku me të paktën njërin nga djemtë e martuar, gruan dhe fëmijët e tij, si dhe me vajzat apo djemtë e pamartuar, nëse kishin akoma të tillë. Vështirësitë ekonomike, kufizimet mbi lëvizjet brenda vendit si dhe vështirësitë në dhënien e lejes për ndërtime gjatë periudhës komuniste, sillnin si rezultat pamundësinë për djemtë e martuar të largoheshin nga shtëpia e prindërve, duke krijuar një familje akoma edhe më të madhe. Një lloj tjetër shumë i zakonshëm i cili promovohet nga partia-pushtet, ishte familja bërthamë, e përbërë nga prindërit dhe fëmijët e tyre. Familjet e kryesuara nga gratë ishin zakonisht ato kur burri vdiste. Nëse çifti ishte në moshë të re, gruaja zakonisht do martohet përsëri dhe do shkonte tek familja e burrit, ndërsa fëmijët do rriteshin nga gjyshi dhe gjyshja nga babai. Divorcet nuk shiheshin me sy të mirë dhe numri i tyre ishte i ulët. Nëse ndodhte një gjë e tillë, gjithmonë bëheshin përpjekje nga familja për të organizuar një martesë tjetër.

4.1 Tipologjia e familjeve marrëse dhe dërguese të remitancave

Tipologjia e përbërjes së njësive familjare emigrante në vendin e origjinës ndryshon nga familja në familje, në varësi të mundësisë për punësim jashtë vendit dhe marrjes së lejes së punësimit. Shpesh ato reflektojnë përbërjen tradicionale të strukturave familjare të zgjeruara, si dhe përgjegjësitë kulturore të emigrantëve sipas gjinisë dhe moshës së tyre. Në familjet shqiptare burri është në të shumtën e rasteve kryefamiljari. Nëse ai vdes, këtë rol e merr e veja. Megjithatë, në disa familje, sidomos kur prindërit janë në moshë të thyer dhe gjendje jo të mirë shëndetsore, titulli i kryefamiljarit mund të jetë thjesht një formalitet për të treguar respekt. Por në fakt në praktikë, një pjesëtar tjetër i familjes i merr përsipër detyrat dhe përgjegjësitë e kryefamiljarit. Ky mund të jetë djali më i madh ose në mungesë të tij gruaja e tij.

Format e mëposhtme të strukturës familjare u identifikuan në kampionin tonë të njësive familjare marrëse të dërgesave në zonat rurale të Shqipërisë jug-lindore:

Njësi ekonomike familjare të kryesuara nga gratë

Tipi 1. Këto janë faktikisht familje të drejtuara nga gratë, sepse brenda familjes që përfshin edhe burrin, ky i fundit vazhdon të jetë kryefamiljari. Këto gra jetojnë me fëmijët e tyre në fshatra, ndërsa burrat e tyre punojnë dhe jetojnë në Greqi, duke u kthyer në shtëpi për vizitë disa herë në vit. Në këto rrethana, familja synon për tu ribashkuar në Greqi ose në Shqipëri. Në rastet kur burri ka një punë të

qendrueshme në Greqi dhe ka leje qëndrimi dhe punësimi të rregullt dhe paguhet mirë, mundësia më këto tipe strukturash ishin më dominueset tek njësitë familjare marrëse të kryesuara nga gratë.

Tipi 2. Në ngjashmëri me llojin e mësipërm, ky lloj përshkruan një situatë ku gruaja merr rolin e kryefamiljares vetëm përkohësisht. Këto janë rastet kur burri punon në Greqi punë sezonale, deri në gjashtë muaj në vit, dhe pjesën tjetër të vitit jeton me familjen e tij në fshat.

Tipi 3. Këto janë rastet kur gruaja është e ve. Ajo mund të jetojë:

- vetëm;
- me nipat dhe mbesat, dmth fëmijët e djalit, dhe ndonjëherë të vajzës të cilët jetojnë dhe punojnë jashtë shtetit (në përgjithësi në Greqi);
- me nipat dhe mbesat, dmth fëmijët e djalit, dhe ndonjëherë të vajzës, në rastet kur nëna ose babai i tyre ka vdekur dhe prindi tjetër është martuar përsëri dhe jeton me familjen e tij të re – zakonisht këta fëmijë nuk pranohen lehtë kur e veja/i veu martohet me një beqar/beqare;
- me gruan dhe fëmijët e djalit/djemve kur këta të fundit punojnë në Greqi.

Përbërja familiare mund të përfshijë edhe vajza dhe djem të pamartuar ose vajza të divorcuara. Këto të veja nëna emigrantësh mund të kenë edhe djem dhe vajza të tjerë të martuar të cilët jetojnë në të njëjtin fshat, apo dhe në fshatra e qytete të tjera në Shqipëri, të cilët vijnë për vizitë ose e ndihmojnë kur është e nevojshme, por jetojnë në njësi familjare më vete.

Njësi ekonomike familjare të kryesuara nga burrat

Tipi 1. Njësitë ekonomike familjare më tipike janë të përbëra nga shumë breza ku prindër (të moshuar) jetojnë me fëmijët dhe nipërit/mbesat e tyre dhe ku ka të paktën një djalë emigrant që jeton në Greqi dhe dërgon remitanca.

Tipi 2. Të ve të moshuar ose çifte pensionistësh që jetojnë vetëm. Të gjithë fëmijët e tyre kanë emigruar në Greqi (ose shtete të tjera) dhe jetojnë atje së bashku me bashkëshortët dhe fëmijët e tyre, shpesh në njësi ekonomike familjare të ndara. Këta prindër mund të jetojnë 'zyrtarisht' vetëm, dhe në praktikë janë 'përgjegjësia' e djalit më të vogël dhe gruas së tij për t'u përkujdesur për ta. Megjithatë, në disa raste ata marrin dërgesa nga të gjithë djemtë (dhe ndonjëherë vajzat) në formë 'dhuratash' apo 'vetëm për kafe', ndërkohë që djali i vogël mund të jetë dërguesi kryesor i remitancave.

Në varësi të moshës dhe shëndetit, shqiptarët më të moshuar që mbeten në vendlindje vazhdojnë të merren me bujqësi 'sa për veten e tyre'. Ndonjëherë ata mund t'ia japin tokën e tyre bujqësore me qera familjeve të tjera në fshat. Pra të ardhurat e tyre përbëhen nga një përzierje e pensioneve të pleqërisë (të pakta), disa prodhime bujqësore që i prodhojnë vetë ose të ardhura nga qeraja e tokës, si dhe dërgesa nga fëmijët e tyre. Disa prej tyre mund të kenë jetuar në Greqi me familjen e (zakonisht) djalit të tyre, dhe në disa raste bashkëshorti mund të ketë qenë vetë emigrantë në fillim të viteve 1990, duke punuar me javë apo muaj pa dokumenta në Greqi vajtje-ardhje. Të moshuarit mund dhe të jenë kujdesur për fëmijët e vegjël (nipërit e mbesat) të fëmijëve të tyre emigrantë në mënyrë që të mbështesin projektin e emigrimit me qëllim që burri dhe gruaja emigrante të mund të punonin që të dy dhe të kursenin disa nga të ardhurat.

Tipi 3. Në raste shumë të rralla është gruaja ajo që ka emigruar ndërsa burri jeton në Shqipëri, ndonjëherë së bashku me fëmijët. Ne hasëm të paktën dy raste të tilla, një prej të cilave ishte një familje e përzier egjiptiane dhe myslimane shqiptare. Në këtë familje gruaja punonte në Greqi dhe bashkëshorti bashkë me dy fëmijët adoleshentë jetonin në fshat. Në rastin tjetër gruaja ishte punëtoreshë sezonale në bujqësi në Greqi, ndërsa bashkëshorti menaxhonte fermën e blegtorisë në Shqipëri.

Njësi familjare të kryesuara nga fëmijët

Tipologji e njësisë ekonomike familjare: çift pensionistësh në fshat, djemtë në Athinë

Ja një shembull tipik i një njësie ekonomike familjare ku vetëm prindërit e moshuar mbetën në fshat. Nexhi (63) dhe Bedriu (68) jetojnë vetëm në Pojan. Ata kanë tre djem që janë të martuar dhe jetojnë me familjet e tyre në shtëpi të ndara në kryeqytetin grek, Athinë. Të ardhurat e tyre përbëhen nga pensioni mujor i pleqërisë – 15,000 lek/muaj, qeraja që marrin nga toka bujqësore dhe disa dërgesa që ua sjellin fëmijët – rreth 100 euro dy herë në vit kur ata vijnë për vizitë. Djemtë, të cilët janë në të 30-at dhe 40-at, jetojnë në Greqi për rreth 15 vjet. Ata janë të martuar dhe fëmijët e tyre janë të gjithë në shkolla në Greqi – nipërit dhe mbesat janë midis moshës 2 dhe 12 vjeç. Dy djemtë më të mëdhenj kanë blerë shtëpitë e tyre në Athinë. Kjo është një shenjë stabilizimi dhe vendosje të përhershme në vendin pritës. Nga ana tjetër, ata gjithashtu kanë blerë edhe apartamente apo truall-tokë në Tiranë. Kjo konfirmon që edhe pse janë vendosur në Greqi, ata nuk i kanë ndërprerë lidhjet me vendin e prejardhjes. Ky investim i dërgesave në prona është një masë për sigurim shoqëror për veten e tyre kur të jenë të moshuar, por edhe si rezultat i statusit të tyre të pasigurt (si shumica e emigrantëve) në Greqi. Pra, djemtë dhe familjet e tyre kanë në plan të jetojnë në Greqi në të ardhmen, sidomos sepse fëmijët e tyre janë në shkollë atje. Ata vijnë për vizitë tek prindërit e moshuar në fshat një apo dy herë në vit, kohë gjatë të cilës ata sjellin disa para dhe dërgesa të tjera materiale si rroba, ilaçe etj. Prindërit e moshuar jetuan në Greqi për dy vjet, por u kthyen në fshatin e tyre sepse jeta në kryeqytetin grek iu duk e vështirë për moshën e tyre. Gjuhën nuk e flisnin, edhe pse arritën që të mësonin si të udhëtonin me transportin publik dhe të lëviznin brenda qytetit. Më shumë u mërzit bashkëshorti pasi nuk kishte punë aty. Gjyshja, nga ana tjetër, ishte e lumtur sepse kujdesej për të vegjëlit si dhe për punët e shtëpisë.

Këto tipe familjesh janë shumë të rralla dhe hasen më shpesh në komunitetin egjiptian dhe rrom, dhe janë të përkohshme. Në raste të tilla të dy prindërit e një familje bërthamë emigrojnë për të punuar në Greqi për disa javë ose deri në tre muaj dhe fëmijët lihen vetëm. Zakonisht, djali apo vajza adoleshente lë shkollën për tu kujdesur për motrat dhe vëllezërit më të vegjël si dhe për ekonomike familjare. Ata marrin dërgesa gjatë kohës që prindërit janë larg dhe ndonjëherë gjyshërit i japin këshilla për mënyrën se si t'i shpenzojnë paratë. N.q.s. nuk kanë gjyshër atëherë i këshillojnë të afërm të tjerë, por të cilët jetojnë veças.

Në **Selanik, Greqi**, tipet e shtëpive ishin si më poshtë:

Njësi ekonomike familjare të kryesuara nga burrat

Tipi 1. Kjo ishte familja tipike bërthamë dhe ndonjëherë e zgjeruar e përbërë nga prindërit emigrantë, fëmijët dhe në disa raste gjyshërit. Mashkulli më i vjetër në familje ishte kryefamiljari formal dhe në shumicën e rasteve edhe në praktikë, megjithëse ai mund të mos kontribuonte shumicën e të ardhurave në familje.

Tipi 2. Familja bërthamë me prindërit dhe fëmijët e vegjël, së cilës i bashkangjitet një i afërm emigrant, zakonisht vëllai i bashkëshortit.

Tipi 3. Djem të rinj beqarë që jetojnë vetëm, ose burra të martuar por që janë Greqi pa familjet e tyre, dhe jetojnë në një shtëpi me djem të tjerë beqarë që i kanë shokë apo të afërm. Të dhënat statistikore nga regjistrimi i popullsisë në Greqi në vitin 2001 konfirmojnë këto tipologji. Sipas këtij regjistrimi 65 përqind e njësive ekonomike familjare të migrantëve shqiptarë kishin formën e një familje 'të zakonshme', dmth. çifte me fëmijë apo çifte pa fëmijë; vetëm 14 përqind jetonin në shtëpi me shumë anëtarë që nuk kishin lidhje farefisnore me njëri-tjetrin (Baldwin-Edwards dhe Kolios 2008: 12-13).

Të dhënat statistikore tipet e njësive familjare të hasura në vendin pritës reflektojnë tipologjinë e migrimit shqiptar në Greqi, që siç e theksuam më herët ka qenë kryesuar nga meshkujt. Për këtë studim nuk intervistua asnjë familje migrante me gratë si kryefamiljare, pavarësisht se shumë prej të intervistuarëve tanë theksuar natyrën egalitare gjinore të vendimarrjes në familjet e tyre. Një përjashtim ishte një njësi familjare me kryefamiljare grua e përbërë nga dy motra – të dyja me arsim të lartë – dhe një vëlla më i vogël që jetonin në Selanik. Në një mënyrë të pazakontë, motra më e madhe kishte qenë e para që kishte emigruar dhe më pas kishte shërbyer si pikë mbështetje për të tërhequr motrën dhe vëllain të cilët shkuan në Greqi sipas kësaj renditje.

4.2 Ndryshimet në tipologji si pasojë e migrimit

Pjesa më e madhe e ndryshimeve të tipologjive të prezantuara më lart shfaqen në Greqi. Ky është një ndryshim kohor si dhe socio-ekonomik. Në fillimin e viteve 1990, migrimi i shqiptarëve ishte i dominuar nga meshkujt të cilët jetonin së bashku në Greqi. Kushtet e jetesës ishin shpesh të pasigurta dhe ata jetonin të gjithë të dyndur në dhoma të ndërtesave gati të pabanueshme, në lagje të vafra me infrastrukturë të varfër (shiko për shembull tek Iosifides and King 1998). Në zonat rurale të Greqisë ata jetonin nëpër stalla, ose nëpër kasolle në fusha. Pas legalizimit, kohë kur dhe pjestarët e tjerë të familjes (zakonisht gratë dhe fëmijët) erdhën në Greqi, ata mundën të vendosen në banesa me kushte më të mira jetese. Kjo u shoqërua me – dhe u mundësua nga – vazhdimësi në statusin e rregullt, punë më të sigurt dhe që paguheshin më mirë, gradualisht njohja më e mirë e gjuhës, por gjithashtu edhe ndryshimit të qëndrimit të shoqërisë greke ndaj emigrantëve. Shpesh, familja bërthamë strehonte njëherësh disa të afërm të tjerë – meshkuj – të familjes (vëllezër, kushërinj) si dhe miq. E vetmja grua në familje do të gatuante dhe pastronte ndërkohë që burrat shkonin të bënin punë të rënda fizike. Deri në një farë mase kjo ndodh edhe sot, por mund të ketë vetëm një ose dy të afërm që jetojnë me çiftin dhe fëmijët e tyre. Herë-herë, dy ose më shumë vellezër (ose motra në raste më të rralla) jetonin së bashku me bashkëshortet dhe fëmijët e tyre në një shtëpi në mënyrë që të ulnin shpenzimet dhe të kursenin para, me të cilat më vonë të merrnin banesën e tyre më vete.

4.3 Familje migrantësh prej shumë brezash: gjyshet

Në rastin e migrimit shqiptar në Greqi, gjyshërit dhe sidomos gjyshet, luajnë një rol të rëndësishëm në projektin e migrimit. Përgjatë viteve të migrimit, dhe pas legalizimit dhe bashkimit familjar, familja më tipike në Greqi përbëhet nga burri, gruaja, dhe fëmijët e tyre të vegjël ose adoleshentë. Ndonjëherë, prindërit e moshuar i bashkohen për disa muaj ose një apo dy vjet, në varësi të mundësisë për të marrë viza ose leje qëndrimi. Në këto raste gjyshja kujdeset për fëmijët e vegjël dhe shtëpinë ndërsa gjyshi mund të gjejë një punë si roje në një objekt ndërtimi. Kjo i mundëson çiftit që të bëjnë punë të paguar dhe gjithashtu ndihmon në ruajtjen e unitetit midis brezave brenda në familje. Përkujdesja për fëmijët e familjeve migrante i vendos këto 'gjyshe migrante' (cf. King dhe Vullnetari 2006) në qendër të së ashtuquajturit 'zinxhir i përkujdesjes globale/rajonale' (për më shumë në lidhje me zinxhirin e përkujdesjes globale referohuni tek Ehrenreich dhe Hoschschild, 2003; dhe Hochschild 2001; dhe mbi situatën shqiptare Vullnetari dhe King, 2008). Pjesa më e madhe e grave migrante në Greqi (dhe Itali)

përkujdesen për familje vendase greke, ndërkohë që ato vetë kanë nevojë për përkujdesje për fëmijët e tyre gjatë orarit të punës. Kjo mundësohet nga gra të tjera migrante shqiptare – shpesh gjyshe në të pesëdhjetat ose të gjashtëdhjetat – të cilat përkujdesen edhe për punët e shtëpisë. Për më tepër, gjyshërit janë shpesh e vetmja lidhje që fëmijët e emigrantëve mund të kenë me kulturën e vendit dhe popullit nga vijnë (shiko Gogonas 2007). Ky proces zhvillohet nën normat tradicionale shqiptare, pasi janë zakonisht prindërit e djalit emigrant që shkojnë të jetojnë me çiftin migrues. Pas martesës vajzat bëhen pjesë e njësisë familjare të burrit dhe përgjegjësitë e saj (përkujdesja) janë tanimë kundrejt vjehrrit dhe vjehrrës. Sidoqoftë, zinxhiri i përkujdesjes mund të thyhet dhe përkujdesja vjen duke shtuar për disa prindër të vjetër rreth të shtatëdhjetave apo më lart, që zakonisht mbeten në Shqipëri, dhe që mund të kenë nevojë për përkujdesje vetë. Në Shqipëri kujdesi për të moshuarit nga shteti ose nga institucione të tjera private është shumë i kufizuar dhe i pamjaftueshëm, sidomos në zonat rurale. Familjet tradicionalisht janë përkujdesur vetë për të moshuarit, fëmijët apo shëndetligët e tyre. Por duke qenë se djemtë e nuset kanë emigruar – sidomos jashtë – shumë prindër të moshuar po e gjejnë veten të 'braktisur' (King dhe Vullnetari 2006).

Dy faktorë kryesorë duhen theksur në lidhje me organizimin social të përkujdesjes. Së pari, ekonomia e migrimit për punë: përkujdesja për të moshuar apo fëmijë jashtë vendit sjell më shumë të ardhura financiare sesa përkujdesja për vjehrrin dhe vjehrrën – ky i fundit është një detyrim moral që shpesh nuk prodhon të ardhura (Vullnetari dhe King, 2008). Për më tepër, disa familje llogaritin që kostoja e jetesës për të gjithë familjen në Greqi mund të jetë më e lartë sesa të ardhurat, sidomos nëse gruaja emigrante nuk mund të gjejë një punë që paguhet mirë. Kështuqë mund të jetë ekonomikisht më e leverdisshme për prindërit e moshuar të qëndrojnë në Shqipëri, ku kostoja e jetesës është shumë më e ulët dhe ku 100 apo 200 euro mund të mbulojnë shumë më tepër shpenzime. Së dyti, aspekti social është thelbësor: familjet nuk janë gjithmonë në harmoni dhe të lumtura. Konfliktet midis vjehrrave dhe nuseve kanë ekzistuar gjithmonë në familjet shqiptare. Një pjesë e leverdisë nga emigracioni për gratë e reja shqiptare konsiderohet edhe 'çlirim' nga zënkat e vazhdueshme dhe banale me vjehrrat (referohu tek King dhe Vullnetari 2009). Strategjitë e ndryshme që adoptohen – përkujdesje nga larg, 'gjyshe migrante' ose kryerja e rolit gjyshëror në mënyrë transnacionale (pra duke u përkujdesur për të vegjëlit sa në vendin e prejardhjes dhe në atë të pritjes) – janë përgjigje origjinale ndaj transformimeve komplekse socio-ekonomike që ndodhin në Shqipëri dhe në komunitetin e emigrantëve jashtë vendit.

Gjyshe Kadria

Kadrija është në të 70-at dhe jeton vetëm në fshat. Të dy djemtë e saj jetojnë me familjet e tyre në Greqi. E ardhura e saj kryesore është një pension i ulët pleqërie prej 5,000 lek/muaj, që plotësohet nga dërgesat që djemtë e saj sjellin me vete kur vijnë për vizitë. Kjo është rreth 100 euro tre herë në vit. Disa të afërm që jetojnë në Australi i dërgojnë ilaçe herë pas here dhe nja dy herë i kanë dërguar para 'sa për një kafe'. Të dy djemtë kanë blerë një truall ndërtimi në Tiranë dhe kanë në plan të ndërtojnë një pallat, një pjesë për të shitur dhe pjesën tjetër për të siguruar një bazë për vete aty. Para disa vitesh Kadrija shkoi të jetonte me djalin e madh dhe familjen e tij në Greqi, por u kthye në fshat pas dy vitesh kryesisht si pasojë e zënkave të vazhdueshme me nusen.

4.4 Ruajtja e unitetit në familjet transnacionale

Familjet si në Shqipëri dhe Greqi i ruajnë lidhjet transnacionale me njëra-tjetrën në mënyra të ndryshme. Së pari, bëjnë telefonata të shpeshta të paktën një herë në javë. Për shembull, pjesa më e madhe e familjeve që morrën pjesë në studim në fshatrat në Shqipëri – më shumë se 90 përqind në anketimin tonë – kanë telefona celularë, dhe një e treta kanë linjë telefonike fikse. Së dyti, janë vizitat e emigrantëve tek familjet e tyre në Shqipëri. Për arsye të vështirësive në marrjen e vizave, vizitat në kahun e kundërt janë më të rralla. Emigrantët vizitojnë familjet e tyre në përgjithësi tre herë në vit: gjatë Pashkëve Ortodokse greke (mars ose prill), gjatë pushimeve verore greke (gusht-shtator), dhe për Krishtlindje dhe Vitin e Ri (dhjetor-janar). Ata që jetojnë më larg si për shembull në Athinë apo në ishujt e largët grekë mund të vijnë për vizitë edhe më rrallë. Nga ana tjetër ata që jetojnë më afër, sidomos rreth zonave kufitare dhe deri në Selanik mund të vizitojnë me shpesh. Disa emigrantë që jetojnë në Selanik bëjnë vizita mujore dhe efektivisht jetojnë midis dy shteteve. Vizita të tjera ndodhin për raste të veçanta feste si për shembull dasma, varrime, lindje, ose në raste sëmundje apo vdekje të një pjestari/e të familjes. Pjesa më e madhe e dërgesave qoftë para apo sende sillen në Shqipëri gjatë këtyre vizitave, sepse dërgesat e sjella dorazi janë një mënyrë më ekonomike dhe e besueshme transportimi.

Rregullat e migracionit grek kushtëzojnë vizitat e bëra nga emigrantët dhe familjet e tyre midis Greqisë dhe Shqipërisë. Problemi më i madh zakonisht është pajisja me leje të vlefshme qëndrimi, pasi rinovimi i lejeve të emigrantëve nga pala greke mund të zgjasi deri në dy vjet. Kjo pengesë burokratike i ndan emigrantët nga familjet e tyre. Pra është e zakonshme për emigrantët që të mungojnë në raste të veçanta në Shqipëri siç janë për shembull varrimet e të afërmeve të tyre.

Mënyra e tretë për të mbajtur marrëdhënie transnacionale janë vizitat e të afërmeve emigrantë dhe miqve, të cilët vizitojnë prindërit e të tjerëve të cilët nuk munden apo thjesht nuk vizitojnë. Këta të fundit transportojnë para, sende dhe emocione e ndjenja midis dy anëve të familjes. Ka një rritje të përdorimit të internetit dhe e-mailit midis familjarëve/miqve në Shqipëri dhe emigrantëve në Greqi dhe brenda komunitetit transnacional (ose diasporës në vende të ndryshme). Këto kanale komunikimi përdoren më pak për të kontaktuar të afërm në zonat rurale të prejardhjes. Kjo ndodh pjesërisht sepse lidhjet e internetit në zonat rurale të Shqipërisë janë të pakta – asnjë nga të intervistuarit tanë nuk kishte linjë interneti në shtëpi, disa edhe nuk e dinin çfarë ishte kjo – dhe nga nivelet e ulëta të aftësive të përdorimit të kompjuterit nga familjet rurale.

5 | DËRGESAT

Dërgesat kanë qenë shumë të rëndësishme për familjet shqiptare në 18 vitet e fundit. Ndërkohë që proceset socio-ekonomike dhe politike nxitën lëvizjen e shtetasve në vendet e tjera, dërgesat luajtën rol kryesor në përmirësimin e jetesës së shumë familjeve, dhe kontribuan gjithashtu në ekonominë e vendit. Emigrimi bashkëkohor nuk është shumë i hershëm, e megjithatë ndryshime po vihen re në mënyrën se si po dërgohen, përdoren dhe menaxhohen dërgesat në Shqipëri. Në rastin e Greqisë, legalizimi mundësoi bashkimin familjar dhe ndërkohë emigrantët të tjerë u martuan dhe krijuan familjet në Greqi. Në raste të tilla dërgesat drejt Shqipërisë u zvogëluan, pasi tashmë vetëm prindërit e moshuar kanë mbetur në fshat. Nga ana tjetër dërgesa të llojeve të tjera janë rritur. Zgjatja e kohëqëndrimit në Greqi ka lejuar grumbullimin e një niveli më të lartë kapitali financiar, gjë që lejon më shumë para mënjanë për investime, një pjesë e konsiderueshme e të cilit dërgohet në Shqipëri. Ndryshime të tjera kanë të bëjnë me kanalet e dërgesave që është e dukshme në rritjen e përdorimit të kanaleve formale siç janë bankat. Megjithatë kjo nuk ka sjellë ulje të përdorimit të kanaleve informale si për shembull duke i sjellë vetë gjatë vizitave apo nëpërmjet shoqërisë e miqve.

5.1 Sasia dhe shpeshtësia e dërgesave

Anketimi ynë tregoi se shumatat e dërgesave që vijnë çdo vit nga Greqia në familjet rurale të Shqipërisë vazhdon të jetë e konsiderueshme. Sipas përlloraritjeve tona shumata totale e remitançave që dërgohet çdo vit në Shqipëri tek personat që ne anketuam arrin gati 1 milion euro, me një mesatare prej më shumë se 2,600 euro për njësi familjare marrëse.

Pak më shumë se gjysma e të anketuarve merrnin dërgesa çdo tre apo gjashtë muaj. Ky është një trend i qartë i dërgesave po ta krahasojmë edhe me kohët kur emigrantët vizitojnë anëtarët e familjeve të tyre në Shqipëri – zakonisht tre herë në vit. Këtu përfshihet dhe nëngrupi i emigrantëve sezonalë të cilët punojnë në Greqi deri në gjashtë muaj në vit; shumica e tyre i sjellin dërgesat kur kthehen në shtëpi në fund të sezonit të punës. Grupi tjetër më i rëndësishëm është ai i emigrantëve që nisin dërgesat një herë në vit. Ky trend mund të reflektojë maturimin e emigracionit shqiptar në Greqi, ku emigrantët dhe familjet e tyre janë vendosur në Greqi dhe vetëm prindërit e tyre të moshuar mbeten në fshat – si rrjedhojë vizitat janë më të rralla dhe dërgesat më të pakta. Përveç kësaj shpeshtësie, 10 përqind e familjarëve raportuan se marrin dërgesa si dhe kur të nevojiten nga familja në Shqipëri.

Megjithëse të anketuarit janë kategorizuar në këtë mënyrë, trendi i dërgesave në fakt është më kompleks se kaq dhe frekuenca e tyre varion nga muaji në muaj dhe nga viti në vit. Rregullsia e nisjes së dërgesave varet gjithashtu edhe nga të ardhurat e emigrantëve dhe kostoja e tyre e jetesës, si dhe ndonjë shpenzim i paparashikuar. Për shembull, gjatë muajve kur emigrantëve i duhet të paguajnë faturat tre mujore ata mund të mos dërgojnë asgjë. Dërgesat mund të ndikohen edhe kur emigrantëve i duhet të paguajnë tarifën e larta për marrjen e lejeve të qëndrimit apo punës, të cilat prekin ndjeshëm ekonominë e tyre.

Statistikat e raportuara sipas kategorisë së njësive familjare ku dërgesat administrohen nga bashkëshortja e migrantit dhe ato ku një anëtar tjetër i familjes e kryen këtë rol, tregojnë se të parat marrin dërgesa më shpesh se tipet e tjera të njësive familjare. Megjithatë bashkëshortet marrin shumicën e parave çdo tre apo gjashtë muaj në mënyrë të ngjashme me tipet e tjera të njësive familjare, në ndryshim prej këtyre të fundit pjesa e dërgesave që nisen tek gratë çdo muaj apo dy herë në muaj është dy herë më e lartë se për grupet e tjera.

Tabela 1. Shpeshtësia dhe administratorët/et e dërgesave

Tabulum i kryqëzuar i shpeshtësisë së dërgesave dhe nëse bashkëshortja është administratorja e dërgesave apo jo, me testin Chi2 për pavarësinë midis rreshtave dhe kolumnave.

Pearson $\chi^2(6)=26.05$ $Pr=0.000$.

Shpeshtësia e dërgesa	Bashkëshorte	Tjetër anëtar familje	Total
Dy herë në muaj	2 (2.0%)	1 (0.4%)	3 (0.8%)
Një herë në muaj	13 (13.0%)	14 (5.6%)	27 (7.7%)
Çdo dy muaj	12 (12.0%)	19 (7.6%)	31 (8.8%)
Çdo 3 deri në 6 muaj	61 (61.0%)	133 (53.2%)	194 (55.4%)
Një herë në vit	3 (3.0%)	55 (22.0%)	58 (16.5%)
Më rrallë se një herë në vit	0 (0.0%)	2 (0.8%)	2 (0.5%)
Sipas nevojës së familjes	9 (9.0%)	26 (10.4%)	35 (10.0%)
Total	100 (100.0%)	250 (100.0%)	350 (100.0%)

Burim: anketa me pyetësorë n=350

Ashtu si edhe shpeshtësia, shumat e dërguara nuk janë gjithmonë të njëjta dhe ndryshojnë për njësi familjare dhe sigurisht edhe me kalimin e kohës. Ato varen nga shumë faktorë duke përfshirë statusin civil, dmth. nëse emigrant/ja është beqar/e apo i/e martuar e me fëmijë; nëse e ka familjen me vete në Greqi; nga statusi i tyre me dokumenta të rregullta apo jo në shtetin pritës, gjë që i jep më shumë siguri pune dhe jetese; nga lloji i punës që bën emigrant/ja dhe të ardhurat që ka familja migrante; dhe po ashtu nga orientimi i familjes për të ardhmen e tyre drejt Shqipërisë apo Greqisë.

Tabela 2. Shpërndarja e shpeshtësisë së kategorive të dërgesave vjetore

Shuma vjetore të dërgesave (në Euro)	Numri	Përqindja	Akumuluese
less than 1,000	66	18.9	18.9
1,000- 2,000	139	39.7	58.6
2,001-4,000	76	21.7	80.3
4,001-6,000	44	12.6	92.9
6,001-8,000	19	5.4	98.3
8,001 or more	6	1.7	100.00

Burim: anketa me pyetësorë n=350

Tabela 3. Shumat vjetore të dërgesave

Statistika përshkruese për sasinë vjetore të dërgesave (mesatarja, devijimi standart, minimumi and maksimumi) – i tërë grupi dhe sipas administratorit/es së dërgesave. Shumat janë në Euro.

Grupi	Numri	Mesatarja	Std. Dev	Min	Max
I gjithë grupi	350	2,595.8	2,144.2	50	12,000
Administratore e dërgesave është gruaja	100	3,151.5	1,973.6	250	9,000
Administrator i dërgesave është babai	143	2,518.4	2,115.9	150	10,000
Administratore e dërgesave është nëna	98	2,226.0	2,325.1	50	12,000
Administrator/e i/e dërgesave është 'pjestar/e tjetër i/e njësisë familjare'	9	1,677.8	868.2	800	3,500

Burim: anketa me pyetësorë n=350

'Vetëm për kafe'

Gjatë procesit të intervistimit, koncepti i 'parave për kafe' u prezantua nga të intervistuarit/at si nëpër fshatrat shqiptare ashtu dhe në Selanik, Greqi. Kjo frazë përshkruan një nga dy format më të përhapura për nisjen e dërgesave tek pjestarët e familjeve në Shqipëri (të tjerat njihen si 'rroga' apo 'pensione'). 'Paratë për kafe' janë shuma të vogla – shpesh 20 ose 50 euro – të cilat dërgohen si dhurata dhe jo në intervale të rregullta. Paratë rrallë përdoren për të blerë vetëm 'kafe', por mund të mbulojnë një numër nevojash të marrësit/ses. Shpesh kjo është mënyra më e përdorur e dërgesave nga bijat tek prindërit e tyre, sepse bijat nuk konsiderohen të kenë përgjegjësi për përkujdesjen dhe gjëndjen financiare të prindërve – zakonisht këto janë detyrat e djalit më të vogël dhe nuses së tij. 'Paratë për kafe' mund të dërgohen edhe nga të tjerë si djemtë më të mëdhenj dhe gratë e tyre te cilët duan t'i japin prindërve një dhuratë të vogël herë pas here. Më rrallë, disa 'para për kafe' mund ti dërgohen edhe motrave dhe vëllezërve ose të afërmve të tjerë si shenjë dashurie dhe përkujdesje. Aspektet sociale dhe kulturore të këtyre dërgesave reflektojnë rëndësinë e familjes në kontekstin shqiptar, pavarësisht distancës që është krijuar nëpërmjet migrimit. Mesazhi që jepet ndërmjet këtyre dhuratave është që anëtarët e familjeve por edhe miqtë vazhdojnë të vlerësohen dhe të jenë në mendjen e të afërmve që punojnë jashtë.

5.2 Kanalet e transmetimit

Rrugët kryesore nëpërmjet të cilave emigrantët shqiptarë siguronin ardhjen e dërgesave në shtëpi në vitet e para të 1990 ishin: personalisht (duke i sjellë vetë), përmes të afërmve dhe shoqërisë, ose duke paguar një shofer taksie. Të paktën katër ishin arsyet për këtë: e para, shumica e migrantëve në atë kohë nuk kishin dokumenta të rregullta dhe përdorimi i kanaleve formale si bankat ishte jo vetëm i pamundur, por edhe mjaft i rrezikshëm. Së dyti, kanalet formale të dërgimit ishin të kufizuara, burokratike dhe jo shumë të hapura për emigrantët. Së treti, afërsia gjeografike e dy vendeve bënte që sjellja e parave dorazi gjatë vizitave ishte e mundshme, dhe madje e dëshirueshme. Së katërti, emigrantët shpesh punonin me sezone në Greqi vetëm për pak muaj, dhe preferonin të sillnin paratë me vete kur ktheheshin. Megjithatë, këto metoda, veçanërisht dy të parat, kishin rreziqe të përfshira në to.

Gjatë viteve të para të 1990, dhe përsëri në 1997-1999 Shqipëria u përfshi nga pasiguria, trazirat politike dhe autoriteti i reduktuar i ligjit. Sidomos pas vjedhjes së depove të armëve në 1997 kur me mijëra

armatime qarkullonin lirishet në duart e popullit, grupe të ndryshme banditësh kapën rrugët kryesore, sidomos ato afër kufirit dhe pikave të kalimit me Greqinë. Emigrantët që ktheheshin ishin në shënjestër, meqenëse dihej që ata sillnin para me vete – të fituara me shumë vështirësi. Kjo ishte koha kur Operatorët e Transferimit të Parave (OTP)⁹ si psh. Western Union (WU) dhe Money Gram (MG), panë mundësi fitimprurëse për biznes dhe filluan të drejtojnë vëmendjen drejt tregut shqiptar të dërgimit të parave duke nxjerrë një sërë produktesh dhe shërbimesh financiare. Më vonë, bankat greke kuptuan fuqinë e këtij tregu dhe hynë në konkurrencë. Kjo konkurrencë nga viti në vit ka ulur koston e veprimeve financiare dhe kohën e transferimit të parave. Pjesa në vazhdim prezanton informacion të mbledhur gjatë kohës së studimit tonë në dimër dhe pranverë të vitit 2008.

Dërgesat e sjella dorazi

Më shumë se 90 përqind e atyre që ju përgjigjën pyetësorit tonë thanë se sjellja e dërgesave dorazi është metoda më e zakonshme e dërgimit të parave në Shqipëri. Intervistat më të thelluara me migrantët në Selanik po ashtu konfirmuan se çuarja dorazi ishte metoda më e preferuar. Kjo zakonisht ndodh kur dërguesi/ja vjen për të vizituar familjen në Shqipëri, ose kthehet në fund të sezonit të punës (për ata që janë emigrantë sezonalë).

Kjo është veçanërisht praktikë midis dy vendeve të studimit për shkak të rritjes së pjesës së emigrantëve shqiptarë që tani kanë dokumenta të rregullta, sidomos për ata që vijnë nga zona e studimit tonë. Kjo ka mundësuar që emigrantët të udhëtojnë midis Greqisë dhe Shqipërisë të paktën tre herë në vit, siç u përmend më parë. Afërsia gjeografike midis dy vendeve po ashtu lejon këtë metodë. Përveç kësaj, me maturimin e migracionit në Greqi dhe stabilizimin e migrantëve aty, gruaja dhe fëmijët i bashkohen burrit emigrant në Greqi nëpërmjet bashkimit familjar, duke lënë kështu në fshat përgjithësisht vetëm prindërit e moshuar. Si pasojë, sasi të dërguara kanë rënë paralelisht dhe emigrantët mendojnë se nuk ia vlen të çojnë shumat e vogla që ata dërgojnë, si psh 100 euro ose 200, përmes sistemit bankar.

Miqtë ose shoqëria

Kjo është rruga e dytë më e rëndësishme e transmetimit të parave në Shqipëri – 27 përqind e atyre që u përgjigjën në studimin tonë thanë se anëtarët emigrantë të familjes dërgojnë para përmes të afërmeve ose shoqërisë së tyre. Me stabilizimin e mëtejshëm të migracionit në vendin pritës, pjesa më e madhe e emigrantëve jetojnë në komunitete ku janë të rrethuar nga të afërm dhe shokë/shoqe, ose të njohur nga i njëjti fshat ose fshati fqinjë. Nëse një emigrant/e nuk është në gjendje të udhëtojë në Shqipëri për arsye të punës ose të dokumentave, gjithmonë do të gjendet një njeri tjetër i besuar në komunitetin e tyre në Greqi që udhëton drejt Shqipërisë dhe të cilit/ës mund t'ia besojnë paratë për t'i sjellë në shtëpi. Sidomos që Selaniku është kaq pranë Shqipërisë, ka emigrantë nga këto fshatra të cilët udhëtojnë midis dy vendeve vazhdimisht. Në raste të tjera emigrantët shkojnë në stacionin e autobusave për në Shqipëri, ku rastësisht mund të gjejnë dikë që ata njohin i cili/e cila jeton në të njëjtin qytet dhe është duke udhëtuar në fshat. Emigrantët dhe familjet e tyre të cilët morën pjesë në kërkimin tonë theksuan se transmetuesit nuk paguhen për këtë veprim, por dërguesi mund t'i blejë atyre një birrë (kur është burrë), për t'i thënë 'faleminderit', por më shpesh 'borxhi' shpërblehet në të njëjtën mënyrë – duke çuar para ose sende tek familjarët e transmetuesit/eses një herë tjetër.

Korrieri me pagesë

Kjo është një mundësi më pak e shtrenjtë nëse krahasohet me OTP-të, veçanërisht meqenëse ajo nuk kërkon ndonjë dokumentacion. Ka një sërë korrierësh të tillë të paguar që transportojnë para për

9. Të njohura ndryshe dhe si Kompani të Transferimit të Parave, këto janë rrjete private që transferojnë para në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Transfertat realizohen nga operatorë të vegjël nëpërmjet transferimit elektronik të kapitalit me telefon, faks ose email.

një pagesë të caktuar. Për shembull shoferët e taksive ose shoferët e autobusave të cilët zakonisht transportojnë njerëz midis dy vendeve, si dhe individë të biznesit të cilët mund të kenë një firmë të vogël transporti që bën të njëjtën rrugë. Situata tipike është që një emigrant shkon në stacionin e autobusit që nis për në Shqipëri dhe i jep shoferit një pako me emrin e dikujt i cili/e cila do të shkojë ta marrë këtë në anën tjetër, për shembull kur autobusi arrin në destinacionin e tij në Korçë. Në vitet e para të 1990 shoferët e taksive greke ishin mjaft të privilegjuar meqenëse ata kishin dokumentacionin të punonin në të dyja anët e kufirit. Kjo konsiderohej mënyra më e sigurt për të transportuar para në atë kohë, në mungesë të mundësive të tjera dhe përballë kërcënimeve që grupet e armatosura parashtronin rrugës. Me kalimin e kohës shoferët shqiptarë të taksive morrën shumicën e këtij biznesi duke qenë se u lehtësua marrja e dokumentave. Megjithatë, besimi është në themel të këtyre transaksioneve informale, dhe shpesh shoferët janë ose nga fshati ose zona, ose janë rekomanduar nga një shok ose i afërm. Grupi i tretë përbëhet nga pronarë të vegjël biznesesh si psh. ata që kanë dyqane të vogla, të cilët shkojnë në Greqi të furnizohen me mallra, dhe ndërsa janë aty transportojnë para ose pajisje e mobilje për familjet migrante kundrejt një pagesë të vogël. Paratë arrijnë në destinacion në të njëjtën ditë ose ditën tjetër, në varësi të distancës midis fillimit dhe fundit të udhëtimit. Shërbimet kryhen zakonisht për një pagesë prej 10 eurosh për çdo shumë që dërgohet.

Bankat

Gjatë periudhës socialiste ato pak banka ekzistuese në Shqipëri ishin banka shtetërore. Në 1991 u vendos një sistem dy-nivelesh në këtë fushë, me Bankën e Shqipërisë (BoA) të caktuar si banka qendrore detyra e së cilës ishte vëzhgimi dhe mbikqyrja e aktiviteteve të të gjitha bankave tregtare të nivelit të dytë, si dhe Institucioneve të Mikro-Financës (IMF) dhe OTP-ve (Bitzenis and Nito 2006: 96). Gradualisht bankat shtetërore u privatizuan, ndërsa bankat të tjera private hynë në treg, shumica nga jashtë. Dy faktorë kryesorë na ndihmojnë për të shpjeguar përdorimin e ulët të bankave në Shqipëri. Ekonomia e parave të thata (pra jo bankare) e trashëguar nga vitet komuniste, dhe rënia e skemave piramidale 'të kursimit' në 1997. Gjatë komunizmit shumë pak shqiptarë kishin llogari bankare dhe shumica e këtyre ishin llogari kursimi. Kjo ekonomi u trashëguar në vitet e tranzicionit dhe pagesat me para në dorë akoma përbënin 95 përqind të transfertave tregtare në vitin 2005 (Hernández-Cross et al. 2006: 11). Dështimi i skemave piramidale 'të kursimit' shkatërroi eksperiencën financiare që sapo kish filluar të zhvillohej si dhe besimin në sistemin bankar që kish filluar të rritej që nga vitet e para të 1990. Pasojat ndjehen akoma pas dhjetë vjetësh, veçanërisht nga banorët fshatarë dhe ata që humbën shumën të mëdha.

Përveç këtyre faktorëve, deri më së fundi bankat konsideroheshin nga emigrantët dhe familjet e tyre si shumë burokratike, të ndërlikuara dhe të kufizuara. Ndërsa bankat kanë degë vetëm në zonat qytetare, pjesa më e madhe e popullsisë jeton në fshat (ndonëse kjo e fundit po ndryshon si rezultat i migrimit të brendshëm pas-komunist në shkallë të gjerë). Disavantazheve të bankave u shtohen orët e kufizuara të hapjes qoftë në Greqi apo në Shqipëri. Veçanërisht për emigrantët në Greqi kjo është mjaft e pavolitshme duke qenë se ata punojnë me orare të zgjatur çdo ditë jave dhe madje shpesh edhe të shtunave. Në Greqi pajisja me llogari bankare për emigrantët pa dokumente të rregullta mbetet problematike. Emigrantët që kanë llogari bankare preferojnë të transferojnë vetëm shumën të mëdha përmes bankave, ndërsa sasitë më të vogla prej 50-200 euro i dërgojnë më shpesh me mënyra të tjera. Në anketën tonë vetëm gjashtë nga ata që u përgjigjën ose rreth 2 përqind e kampionit thanë se përdornin bankat për të marrë dërgesat nga emigracioni, dhe vetëm njëri prej tyre përdorte kartë debiti.

Nisma bankare

Disa banka janë përpjekur të krijojnë disa shërbime me qëllim që të përfshijnë klientë edhe në zonat rurale që vuajnë nga shërbime të dobëta financiare, ose të mbulojnë zonat ku degët e tyre nuk janë prezente. Psh. Banka Amerikane e Shqipërisë (BASH)¹⁰ ka për qëllim të arrijë këtë objektiv të dyfishtë duke punuar në partneritet me Postën Shqiptare, e cila ka 541 zyra postare në zonat urbane dhe rurale të Shqipërisë. Shumat deri në 500 euro mund të dërgohen çdo ditë me një kosto prej 6 euro.

Një produkt tjetër që është krijuar veçanërisht për shqiptarët në Greqi është mundësia (për ata që jetojnë larg prej degëve të BASH-it në Greqi) të depozitojnë ose të dërgojnë para në Shqipëri, duke përdorur rrjetin e Bankës Agrare të Greqisë (BAG). Kur paratë janë depozituar në degën më të afërt të BAG, ato më tej ose kreditohen në llogarinë e emigrantit me BASH-in në Greqi ose dërgohen në një llogari të degëve të BASH-it në Shqipëri, sipas udhëzimeve të dërguesit/es.



Reklamë e Bankës Amerikane të Shqipërisë në Korçë

10. Që prej tetorit 2008 kjo njihet me emrin Intesa Sanpaolo.

Prania e Operatorëve të Transferimit të Parave (OTP)

Dy kompanitë më të mëdha të transferimit të parave në botë janë të pranishme edhe në Shqipëri: Western Union (WU) që në vitin 1998 dhe MoneyGram (MG) që në 2004. Ato zhvillojnë aktivitetin e tyre përmes degëve të tyre ose përmes partnerëve lokalë, duke zotëruar një total prej 300 pikash tregtimi midis tyre dhe 78 përqind të tregut formal të dërgimit të parave në Shqipëri në vitin 2005 (Kring 2007: 15). Tarifat për transfertat nëpërmjet këtyre OTP-ve vazhdojnë të jenë relativisht të larta. Megjithatë, shërbimi i tyre në çast është shumë tërheqës dhe i dobishëm për shumë emigrantë dhe familjet e tyre të cilat kanë nevojë të transferojnë para shpejt. Në vitin 2005 një transfertë prej 150 eurosh midis Greqisë dhe Shqipërisë kushtonte 14.50 euro me MG dhe 15.25 euro me WU, të dyja për mbrritje të parave brenda 10 minutash. Këto tarifa kanë qëndruar pothuaj të njëjta në vitin 2008, dmth. rreth 10 përqind me WU dhe 7.5 përqind me MG për çdo shumë të transferuar.¹¹ Pjesëmarrësit në pyetësor u shprehën se përdorimi i shërbimeve të këtyre kompanive është shumë i shtrenjtë, por nga ana tjetër shërbimi është efikas dhe i shpejtë, veçanërisht kur familja ka nevojë për para në mënyrë urgjente, ose siç theksoi një nga personat që u përgjigj, kur transmetuesi do të jetë i sigurt se paratë do të arrijnë 'absolutisht' brenda ditës në vend. Shpejtësia dhe garancia e shërbimit ishin dy elementët më të vlerësuar prej atyre që kishin përdorur kanale të ndryshme për dërgimin e parave.

Rreth 10 përqind të atyre që u përgjigjen në studimin tonë thanë se i merrnin dërgesat nëpërmjet një OTP-je. Një varg arsyesh u dhanë për këtë mënyrë, më e rëndësishmja e të cilave lidhej me urgjencën me të cilën paratë nevojiteshin nga familja në Shqipëri, ose për shkak se ata ishin tepër të varfër ose të një nevojë të veçantë urgjente si sëmundje apo kur ka ndodhur vdekje. Veçanërisht për familjet që jetojnë në varfëri të skajshme si egjiptianët dhe romët, kjo metodë siguron një furnizim të rregullt me para për familjarët që jetojnë në fshat, të cilët nuk kanë burime të tjera të ardhurash ku të mbështeten. Për shembull, shumica e familjeve të intervistuar shpjeguan se nuk ishte nevoja të paguanin kaq shumë për dërgimin e parave nëpërmjet OTP-ve kur familja në fshat kishte mjaftueshëm për të mbuluar nevojat derisa emigranti të kthehej në shtëpi me paratë. Pra duket se më të varfrit paguajnë çmimet më të larta. Të tjerët i përdornin OTP-të kur transfertat nevojiteshin rregullisht, për shembull kur emigrantët prindër kishin lënë fëmijët e tyre të vegjël në përkujdesjen e gjyshërve në fshat, dhe dërgonin shuma të vogla çdo javë, me qëllim që të siguronin mbulimin e nevojave të tyre gjatë gjithë kohës.

Një OTP vjen në Pojan

Duke parë dobinë e shërbimeve të OTP-ve, si dhe potencialin e tyre ekonomik, një firmë e vogël lokale në fshatrat e studimit tonë hyri në bashkëpunim me përfaqësuesin shqiptar të WU-UnionNet, për të ofruar shërbime të transferimit të parave në fshatin e Pojanit. Kjo pikë u hap në verë të vitit 2008 dhe ndodhet në një pikë të vogël shërbimesh biznesi në qendër të fshatit, e cila gjithashtu siguron shërbime telefonike fikse dhe television kabllor. Përveç që është i shpejtë, ky shërbim është tani edhe më afër shtëpive të familjarëve të emigrantëve (më parë vendi më i afërt ishte qyteti i Korçës).

11. Nga materialet reklamuese të këtyre OTP në Greqi.



Shërbimet e Western Union në Pojan

5.3 Profilet e dërguesve dhe të marrëseve

Së pari, gratë përbëjnë shumicën e të intervistuarëve – dhe janë pra në shumicë si administratore të parave të dërguara – në grup-moshat midis 16 dhe 55 vjeç. Pësia e këtij grupi rritet nga prania e grave të emigrantëve burra në familjet bërthamë (çift me fëmijë). Kjo është sidomos e dukshme për grup-moshat midis 16 dhe 45, por veçanërisht për grup-moshën 36-45 ku nga 53 të intervistuarat vetëm një është burrë. Së dyti, në qoftë se përdorim administrimin e parave të dërguara si tregues për vendimarrjen sipas gjinisë në familje, vërejmë se modeli më patriarkal i vendimarrjes është më i fuqishëm në moshat më të mëdha – rreth 60 përqind e vendimarrëseve në grup-moshën 46-55 janë gra, por kjo pjesë bie në 30 përqind për grup-moshën tjetër më lart 56-65 vjeç. Ky informacion mund të sugjerojë se emigrimi i burrave është emancipues për gratë që qëndrojnë në fshat pasi ato tani administrojnë financat e shtëpisë. Megjithatë, materiali jonë i thelluar sugjeron se nuk është gjithmonë kështu. Jo vetëm që burrat vazhdojnë të kenë një shkallë të lartë fuqie në vendimarrje edhe kur ata jetojnë jashtë, por gratë shpesh ndihen të mbingarkuara me të gjitha përgjegjësitë e mbajtjes së shtëpisë dhe përkujdesjen për fëmijët dhe edukimin e tyre.

5.4 Modelet e dërgimit dhe marrjes së parave

Në vazhdim janë llojet e modeleve të dërgimit të parave të vëzhguara tek pjesëmarrësit në studim:

- Nga burri emigrant tek gruaja dhe fëmijët në fshat. Dërguesi është burri dhe marrësja është gruaja. Emigranti është në Greqi afatgjatë.

Familja është zakonisht ajo bërthamë: çifti i ri dhe fëmijët e vegjël, por ka raste kur prindërit e burrit mund të jetojnë me familjen. Megjithatë, ata mund të jenë shumë të moshuar apo të sëmurë. Si rrjedhim, detyrat dhe përgjegjësitë janë marrë përsipër nga gruaja e çiftit të ri. Dërgimi i parave tek këto lloje njësisish familjare janë midis shumëve më të larta të dërguara midis atyre që u përgjigjen.

Transfertat nga burri tek gruaja

Donika jeton me katër fëmijët e saj në fshat, ndërsa burri i saj punon në Greqi. Ajo nuk ka të ardhura të tjera përveç dërgesave të parave, meqë fëmijët janë akoma të vegjël dhe dikush duhet të kujdeset për ta. Punësimi në fshat është shumë i kufizuar dhe familja ka fare pak tokë që nuk prodhon thuj fare. Pyetjes për dërgesat nga i shoqi, ajo ju përgjigj:

... të të them se sa dergon ajo varet prej muajit që zë. Psh ja unë po të them konkretisht tashi kemi patur që 3-4 muaj ishte pa punë. S'ka dërguar, kemi mbetur më atë ... Po me atë të beharit mund të them 500- 600-1000 euro i vete dmth që mund të dërgojë në një muaj, në dy muaj. Plus që ka dhe shpenzime të tjera se dhe ai është shtëpi më vete andej ka qeranë, ka njërën ka tjetrën, me të ngrënë me të pirë, jemi dy familje, në dysh. I vete kaq, dmth kur vete muaji tetor, nëntor e ndjejmë atë vështirësinë shumë se... puna humbet, ai ka vështirësitë e veta dhe neve fillojmë njëçik si më të mbledhur i thon një llaft, se sa muajt e beharit...!

[Donika, 37 vjeçare, Shqipëri]

- Nga burri emigrant te gruaja dhe fëmijët e tij në fshat. Dërguesi është burri dhe marrësja gruaja. Emigranti punon sezonal në Greqi.

Ky grup emigrantësh përbën një pjesë domethënëse të popullsisë në fshat. Këtu hyjnë pjesërisht ata që nuk janë në gjendje të marrin leje afatgjata, dhe ata që për arsye të ndryshme nuk dëshirojnë t'i futen procesit të lodhshëm dhe nerva-shkatërrues për të marrë dokumentat afatgjata në Greqi. Pjesa më e madhe e këtyre emigrantëve kanë punuar më parë në Greqi që në vitet 90-ë, vajtje-ardhje. Mbas legalizimit të 1998-ës, dhe sidomos pas vitit 2000, vendosën të qëndrojnë në fshat dhe të vazhdojnë të punojnë atje në bujqësi, ose të hapin ndonjë biznes të vogël. Megjithatë, paratë nga Greqia vazhduan të jenë të rëndësishme për të mbijetuar dhe madje për të zhvilluar më tej blegtorinë, bujqësinë apo ndonjë biznes të vogël. Zakonisht njësitë familjare që kanë emigrantë sezonale janë shumë më të varfra se ato me emigrantë afatgjatë, pasi dërgesat e parave janë po ashtu shumë më të ulta.

Emigrantët sezonalë, në kontrast nga ata afatgjatë të cilët kanë zakonisht qëndrim dy-vjeçar dhe leje pune, shkojnë të punojnë në Greqi nën një program tjetër. Ata aplikojnë çdo vit në konsullatën greke në Korçë për vizë me një hyrje dhe e vlefshme për 30 ditë, të sponsorizuar nga punëdhënësi grek, zakonisht një fermer i vogël. Kur arrijnë në Greqi këtë vizë e zgjatin në leje qëndrimi dhe pune gjashtë mujore (që është dhe maksimumi), dhe me shumë hyrje. Lejet janë të lidhura me vendin e punës dhe punëdhënësin që i bën garancinë. Kur një proces i caktuar pune përfundon në këtë fermë, ata mund të shkojnë për të kërkuar punë në një vend tjetër të Greqisë (nëse punëdhësi bie dakord), gjithmonë duke qenë të detyruar të kthehen përsëri në fermën e parë kur të jetë nevoja. Në këtë proces lidhjet me shokët dhe të afërmit që jetojnë sidomos nëpër qytetet dhe që vetë shpesh kanë leje qëndrimi dhe pune greke afatgjata, janë shumë të rëndësishme. Këta mund të ndihmojnë për të gjetur një punë më të mirë, dhe që paguhet më mirë si psh në ndërtim, mund të ndihmojnë me strehimin etj. Ata që nuk i kanë këto lidhje të nevojshme kthehen në shtëpi pasi puna kryesore ka mbaruar në bujqësi, madje edhe kur mund t'u ketë mbetur edhe një apo dy muaj nga viza. Pjesa më e madhe e atyre që ju përgjigjën pyetësorit dhe që punonin në Greqi në këtë mënyrë, punonin në bujqësi dhe rrallë kishin shkuar diku tjetër (psh në qytete) për më shumë punë dhe të ardhura shtesë. Shumica e atyre që punojnë në bujqësinë greke punojnë në fshatrat afër kufirit si psh Grazhdan, ku u shërbejnë fasuleve (sidomos fasulet e mëdha për eksport) në procese si lidhje, prashtije, mbledhje; ose në fshatrat afër Veries, në Greqinë veri-perëndimore ku janë të punësuar në baçat me fruta (mollë dhe pjeshkë) dhe kryejnë procese si krastitje, vjelje frutash etj.

Punëtor sezonal që punon në baçat me fruta të Greqisë

Ai [burri i saj] vete në pjeshkët ... këtu afër Veries ... Kur mbaron atje, shkon me saldime, ka ikur andej-këtej kur i është apur puna, lloj-lloj punësh... Nuk e ka të garantuar një punë apo ashtu, çar t'i dalë përpara do punojë... Ja tashi në fund të majit i japin vizat dhe nga mezi i qershorit ikën... Kthehet në shpi në fund të dhjetorit kur i mbush gjashtë muaj...

[Monda, 45 vjeçare, Shqipëri]

Fitimet e emigrantëve sezonalë janë nga më të ulëtat dhe puna është me hope dhe e pasigurt – nuk punojnë çdo ditë dhe shpesh punojnë vetëm tre deri në katër muaj në vit. Pra është shumë e vështirë për një emigrant sezonal që të mundet të sjellë para të mirë (megjithëse disa ia arrijnë). Zakonisht paga ditore është rreth 18-25 euro për një ditë pune 10 orëshe ose rreth 350 euro në muaj, dhe mund të sjellin rreth 1,500 euro, ose një maksimum prej 3,000 euro për gjithë sezonin e punës. Shpeshherë punëdhënësi u jep ushqim ('ndonjë supë me patate' siç treguan të intervistuarit) dhe strehim nëpër hangarë apo kuzhina të vjetra jashtë shtëpisë. Shpesh, paratë që dërgojnë ose që sjellin me vete janë të mjaftueshme vetëm për të mbuluar shpenzimet e familjes gjatë kohës së dimrit kur nuk ka punë. Ka shumë raste kur familjeve u duhet të marrin borxh që të mbijetojnë derisa të vijë koha kur emigranti të shkojë përsëri në Greqi në pranverë, të fitojë ca para dhe të dërgojë një dorë në shtëpi në rastin më të parë. Zakonisht, emigranti i dërgon paratë në shtëpi me miqtë apo shokët e vet, shpesh rreth 150-200 euro një herë në muaj, dhe pjesën tjetër të parave e sjell me vete kur kthehet në fund të sezonit të punës. Vetëm kur të dy burrë e grua punojnë në Greqi (në këtë rast sezonale), duke i lënë fëmijët me prindërit ose vjehërrit, arrijnë t'ia dalin mbanë të vendosin kapital të mjaftueshëm financiar që të jenë në gjendje të investojnë në ndërtimin e një shtëpie, dhe më pas ta rregullojnë e mobilojnë atë. Pasi ky projekt ka përfunduar, ose të paktën është në rrugë të mbarë, vetëm burri emigron. Pjesa dërrmuese e emigrantëve sezonalë janë burra, me përjashtim të egjiptianëve dhe romëve që shkojnë bashkë si çift.

Në njësitë familjare të emigrantëve sezonalë paratë e dërguara ose të sjella nga Greqia kombinohen me të ardhura të tjera nga aktivitetet në bujqësi në fshatin e tyre, ose me raste nga baçat me mollë. Në familje të tilla që të dy burrë e grua shpesh edhe punojnë me pagë në bujqësi për familje të tjera në fshat apo në fshatrat fqinjë, në qoftë se dhe kur ka punë.

- Nga biri emigrant tek prindërit e tij, kur djali është i pamartuar. Zakonisht, është babai i cili i merr dërgesat, dhe kur ky ka vdekur, i merr nëna.

Në këto njësi familjare mund të ketë edhe motra dhe vëllezër të pamartuar. Dërgesat nga djemtë e rinj të pamartuar mund të jenë të konsiderueshme. Ndërsa njësi familjare zakonisht ka burime të tjera të ardhurash, shpesh nga bujqësia, baça me mollë apo blegtoia.

- Nga biri emigrant tek gruaja, fëmijët dhe prindërit e tij të moshuar. Marrësi është zakonisht babai i emigrantit, përveç rastit kur ky i fundit është shumë i moshuar ose ka vdekur; në këtë rast marrësja është nëna.

Jo të gjithë emigrantët e martuar kanë qenë në gjendje të bëjnë bashkim familjar me gruan dhe fëmijët e tyre. Shpeshherë problemi qëndron tek vështirësitë e shumta që hasen nga kërkesat e qeverisë greke për këtë proces. Në raste të tjera, gruaja qëndron në fshat që të përkujdeset për vjehërrit e saj – prindërit e burrit. Në raste të tilla është babai i emigrantit ai që merr paratë, por nqs ai është i sëmurë ose ka vdekur, ato i merr nëna e cila – siç na treguan – vendos në bashkëpunim me gruan e emigrantit sesi do të përdoren këto.

Një bashkëshort i sjell paratë dorazi

Kur vjen vetë burri se nuk dërgon ai. Kur vjen vetë sjell vetë. Kur vjen në prill, kur vjen në gusht, dhe për Vit të Ri... Tre herë në vit... Mund të sjellë 2,800, 3,000 euro, si të punojë, 2,500 ose 3,500... Nuk e ka fikse, si të punojë.. Unë edhe vjerra, neve jemi, të dyja gratë vendosim [si do përdoren].

[Elda , 35 vjeçare, Shqipëri]

- Nga biri emigrant dhe gruaja e tij tek prindërit e tij të moshuar. Dërguesi është zakonisht biri dhe marrësi është zakonisht babai, përveç kur ky i fundit ka vdekur; në këtë rast marrësja është nëna.

Kur biri emigrant dhe gruaja e tij jetojnë në Greqi bashkë me fëmijët e tyre, shumat që dërgojnë tek prindërit e tij reduktohen në mënyrë drastike, dhe bëhen më të rralla. Nga njëra anë shpenzimet në Greqi rriten meqë vëmendja i kushtohet më shumë jetesës dhe punës atje. Ndërkohë, shpenzimet që prindërit e moshuar kanë në Shqipëri janë minimale – përveç shpenzimeve për ushqim dhe pagesën e faturave (ujin, elektricitetin, etj.) pjesën më të madhe e përdorin për të ndjekur ‘sebepe’ (traditat) tek të afërmit dhe miqtë për raste dasmash, vdekjesh, lindjesh, etj. Dërgesat përdoren kështu sidomos kur prindërit janë shumë të moshuar dhe nuk e punojnë dot tokën. Kur kanë një lopë qumështi ose mbjellin diçka në fushë, mund të përdorin një pjesë të dërgesave për të paguar lërimin e kultivimit e tokës me traktor, për blerjen e farërave, etj. Këto para sillen kur emigrantët vizitojnë prindërit e tyre por ata gjithashtu mund të dërgojnë me motrat dhe vëllezërit e tjerë, të afërmit ose shokët, veçanërisht ata që jetojnë në të njëjtin qytet. Nga ana tjetër emigrantët i kryejnë vetë shumicën e investimeve në ri-ndërtimin apo riparimin e shtëpisë, si dhe investime të tjera më të mëdha, kur vijnë për vizitë dhe me paratë që sjellin me vete. Kur çifti emigrant jeton në Greqi vetëm dhe kanë lënë një ose më shumë fëmijë nën kujdesin e gjyshërve në fshat, dërgesat janë më të shpeshta dhe të rregullta – çdo muaj, por me raste edhe dy herë në muaj, në shumën të vogla prej rreth 20-50 euro çdo radhë, dhe shpesh me anë të OTP-ve.

- Nga vëllai emigrant tek një vëlla ose motër tjetër

Këto raste ishin shumë të rralla në anketë, por më shumë informacion morrëm nga intervistat e thelluara, veçanërisht me emigrantët në Selanik.

- Nga prindërit emigrantë tek fëmijët e tyre

Kjo ndodhte sidomos në rastin e disa familjeve egjiptiane dhe rrome kur të dy prindërit emigronin për punë për dy ose tre muaj në fshatrat fqinjë të Greqisë, ndërsa fëmija adoleshent më i rritur e linte shkollën që të përkujdesej për vëllezërit dhe motrat më të vogla, dhe për të mbajtur shtëpinë. I riu ose e reja merrte paratë e dërguara nga prindërit, por shpeshherë i harxhonte ato sipas këshillave të një të afërme më të rritur si psh hallës ose gjyshes.

5.5 Gratë migrante dërguese

Deri tani, profilet e dërguesëve dhe marrësëve të parave kanë reflektuar tipologjinë e emigrimit shqiptar në Greqi – kryesisht burra, ose burrat në fillim. Por që burrat u dërgojnë para grave të tyre, prindërve, dhe anëtarëve të tjerë të familjes mund të interpretohet edhe si produkt i modeleve tipike me kryefamiljar mashkull që siguron anën ekonomike të njësisë familjare. Siç theksuam më lart, shoqëria shqiptare vazhdon të jetë patriarkale dhe modelet e organizimit social mbeten përgjithësisht patrikale (dmth gruaja kur

martohet zhvendoset në shtëpinë e burrit, dhe i kushton vëmendje familjarëve të burrit); përgjegjësi të tilla tradicionale kundrejt familjes së burrit praktikohen dhe respektohen edhe gjatë procesit të migrimit. Megjithatë, marrëveshje të tilla po zhvillohen më tej dhe shembujt në vazhdim reflektojnë jo vetëm ndryshimet në modelet e dërgimit të parave por edhe ndryshime në praktikat gjinore.

Familjet e grave emigrante dhe 'sa për një kafe'

Siç u theksua më lart 'sa për një kafe' është një thënie e zakonshme e përdorur nga emigrantët që përshkruan dërgesat e parave si dhurata në vend të të qenit një nevojë mbijetese. Për dërgueset e parave që janë femra shprehja 'sa për një kafe' shpesh përfaqëson një transformim në format kulturore të mbështetjes. Sipas traditës shqiptare kur gruaja martohet, përgjegjësitë e saj të përkujdesjes transferohen nga prindërit, vëllezërit dhe motrat e saj tek ata të bashkëshortit të saj. Në shumë raste çiftet emigrante shqiptare mbështesin (me para) vetëm prindërit e burrit, ndërkohë që disa grave nuk u lejohet të dërgojnë para tek prindërit e saj edhe kur ajo punon vetë dhe merr të ardhura. Si pasojë, paratë e dërguara 'sa për një kafe' janë një mënyrë nëpërmjet të cilës disa gra e justifikojnë ndihmën që i dërgojnë familjeve të tyre, pasi dërgesa të tilla konsiderohen tipike; kjo nuk do të thotë hapur që ato po mbështesin familjet e tyre. Megjithatë, idetë për sa i përket mbështetjes nga dërgesat e parave, si të ardhura vetëm nga djemtë tek prindërit e tyre, po ndryshojnë; këtë e diskutojmë më tej në këtë pjesë të raportit.

Disa vajza të martuara mund të dërgojnë më shpesh dërgesa materiale sesa para. Artikuj të tillë si psh ilaçe, televizion, frigorifer apo makinë larëse ishin më të përmendurat gjatë intervistave. Motrat e martuara gjithashtu u çojnë dërgesa të tilla motrave të tyre të martuara që jetojnë në fshat, sidomos veshje dhe mobilje.

- Nga vajza emigrante dhe burri i saj tek prindërit e saj.

Shpesh vajzat sjellin shuma të vogla gjatë vizitave tek prindërit, ose i dërgojnë këto me të afërmit, si dhuratë/peshqesh, 'sa për një kafe'. Duke qenë se prindërit nuk presin të mbahen nga vajzat, dërgesat e tyre konsiderohen si dhurata dhe me raste. Raste kur vajzat mbanin prindërit ishin të rralla në pyetësor, gjë që kushtëzohet dhe nga mënyra se si ishin ndërtuar pyetjet, ku informacioni i detajuar kërkohej vetëm për dërguesin kryesor dhe më pak për dërguesit/et e tjerë/a. Megjithatë, materiali i intervistave të thelluara na njohu me disa raste interesante të kësaj natyre, veçanërisht nga emigrantët në Selanik.

Burra me mustaqe dhe gratë e sotme

Në familjen e gruas, gruaja kur vemë neve dmth vjerrit dhe vjerrës i bën dhoro [në greqisht, do të thotë dhuratë]. Nuk diskutohet, është e padiskutueshme ajo që i bën dhoro. Sepse si mund të bësh kur je burrë e grua në familje, do t'i çojmë babait tënd dhe këtej nga babai im nuk do çojmë, kur je familje e rregullt. Po të jesh burrë me mustaqe, burrë shqiptar ashtu, atëherë nuk e di unë. Po sot, sot gruaja luan një rol shumë të madh në familje, shumë rol të madh lozin gratë në familje... Sot gruaja është... edhe të them atë që kanë më shumë të drejta sesa burrat...

[në greqisht, do të thotë dhuratë]

Një emigrant tjetër i cili ka jetuar me gruan e tij dhe djemtë në Selanik për më shumë se dhjetë vjet, shprehu mendime të ngjashme rreth dërgesave të çuara tek nëna e tij 74 vjeçare dhe vjehrra e tij:

Edhe njësoj, dmth siç i dërgoj un lek nënës time dhe ajo [gruaja] i dërgon nënës së saj... Dmth neve siç i dërgojmë prindërve të mi i dërgojmë dhe prindërve të saj. Dmth nuk ka ndonjë ndryshim të... se ajo punon dhe unë punoj. Nuk ka pse të ketë ndonjë ndryshim që t'i dërgosh vetëm prindërve të burrit... Po si punë pensioni i dërgojmë, një herë në 2-3 muaj kur i gjejmë njerzit [të besuar, të njohur] që t'i dërgojmë, i dërgojme nga 1 mijë evro ti kenë të jetojnë... Sa merr njëra merr edhe tjetra njësoj... Afërsisht kështu... se po të ketë për të bërë ndonjë gjë [për të blerë ndonjë pajisje] do i dërgojmë më shumë...

[Sulo, 47 vjeçar, Greqi]

Rrjeti i përgjegjësive të një familje transnacionale

Gruaja e Sulos vjen nga një familje vetëm me vajza, dhe më e vogla është e pamartuar dhe kujdeset për të ëmën. Kështu, përgjegjësia e përkujdesjes ka kaluar deri diku tek dhëndri i vetëm. Vëllai i Sulos, Xhimi (51), i cili gjithashtu jeton me familjen e tij në Selanik, e qartëson më shumë situatën kur tregon historinë e familjes së tij. Gruaja e tij gjithashtu dërgon para tek e ëma e saj, por jo kaq shumë sa dërgojnë tek nëna e tij. Fund i fundit, kunetrit e tij jetojnë në Shqipëri dhe jetojnë mirë, sidomos sepse kanë fëmijët në Greqi. Përse dërgojnë më pak para tek nëna e saj sesa tek nëna e tij? 'Epo – thotë ai – ka mbetur ajo që djali vetë ndihmon më shumë familjen e tij. Edhe ajo [vjeçra] ka djemtë e saj, dhe mund t'i mbetet hatri atyre [n.q.s. dërgon ai] (me të qeshur)' Por kur flet për nënën e tij thotë se ajo merr para nga të gjithë fëmijët: dy djem në Greqi, një në Shqipëri dhe një vajzë në Kanada.

'Ne [ai dhe gruaja e tij] i japim nënës rreth 100-150 euro, ka raste 200 euro në 3-4 muaj... Zakonisht kur shkojmë atje, por edhe i dërgojmë me një nga ne [vëllezërit] ose njerëz të tjerë [që udhëtojnë për aty]... Kjo varet nga letrat kur i thonë llaftit, ta kemi kartën. Ja ne që nga janari e deri tashi në mars kemi vajtur 4 herë... Ne dërgojmë sipas mundësive, të tjerët [vëllezërit dhe motra] hesap më vete... Edhe motra dërgon njëçikë më shumë, se i takon se ka më shumë [para] andej

[Xhimi, 47 vjeçar, Greqi]

Dërgesat e një gruaje si dhoro ose peshqesh

Epo unë nuk i dërgonja dmth kështu si pension, po kur kështu, kur vinte ndonjë njeri se nuk mund të shkonim përherë, kur dërgonim 100-200 si dhoro... Një herë në muaj, një herë në dy muaj kur gjenim. Po të gjenim njerëz që dërgonim më afër, i dërgonim njëçikë më pak, po t'i dërgonim njëçikë më larg, më shumë leka. E dërgoja, se kemi kaq kohë që s'i kemi dërguar, dhe i dërgonim një 200-çe [euro] ose kaq. Pastaj kur fillova edhe unë punë pastaj prap, përveç lekëve edhe rroba ju blinim, dhe dhoro, dhe leka ju shpinim, ushqime prap i vinim...

[Irena, 37 vjeçare, Selanik]

Në këtë kategori të modeleve të dërgimit, shuma disi më të mëdha dërgohen kur prindërit e moshuar përkujdesen për fëmijët e vajzës së tyre. Përdorimi kryesor i këtyre dërgesave ishte për të mbuluar nevojat e fëmijës, por edhe për të ndihmuar nënën dhe anëtarët e tjerë të familjes që jetojnë bashkë.

- Nga vajzat emigrante (të pamartuara) tek prindërit e tyre

Në studim hasëm dy raste të tilla, që të dyja ishin vajza të reja rreth mesit të njëzetave. Njëra kishte mbaruar tetëvjeçaren dhe punonte në një supermarket në Greqi. Ajo i dërgonte familjes rreth 200 euro në muaj me korrierë të paguar ose kur vinte vetë. Këto ja jepte së ëmës. Tjetra jetonte në Greqi me një motër e dy vëllezër më të rinj në moshë. Ajo kish emigruar e para dhe kish tërhequr të tjerët me rradhë, ndërsa prindërit dhe një vëlla më i madh jetonin në fshat. Edhe pse me zanat, në Greqi punonte në rrobaqepsi, kurse vëllezërit në ndërtim. Motra tjetër ishte pa punë. Të gjithë së bashku sjellin tek prindërit rreth 2,000 euro në vit, kur vijnë për vizitë tre ose katër herë në vit. Motra më e madhe ia jep këto para babait.

- Nga një motër emigrante tek motra ose vëllai

Kishte të paktën një rast të tillë në pyetësor dhe tre raste të tjera gjatë intervistave të thelluara, në të cilat motra dhe i shoqi i saj kishin ndihmuar vëllain ose motrën e saj në Shqipëri.

Tabela 4. Përdorimet kryesore të dërgesave

Përqindje	Përdorimi/Shpenzimet
95% 96.6 burra 93.6 gra	Shpenzime shtëpiake të përditshme si ushqim, veshmbathje, pagim qeraje, faturat e ujit, energjisë elektrike dhe telefonit.
82% 74.3 burra 87.6 gra	Ruajtja e traditave kulturore si martesë, lindje, vdekje, festa fetare dhe ditëlindje, të cilat sigurojnë statusin social dhe respektueshmërinë e familjes.
55.4% 42.6 burra 64.8 gra	Blerje, ndërtime, riparime dhe përmirësime të strukturës së banesës.
54.3% 51.4 burra 56.5 gra	Blerje të mobiljeve dhe/ose të pajisjeve elektro-shtëpiake, përfshi dhe gjeneratorë të vegjël për të zëvendësuar mungesën e energjisë elektrike. Shumë prej të intervistuarëve u përgjigjën se shumë mallra të kësaj natyre sillleshin edhe nga Greqia nga të afërmit e tyre.
55.4% 61.5 burra 51 gra	Mbulim i shpenzimeve mjekësore, më shpesh të përmendura nga prindërit e emigrantëve sesa bashkëshortet e tyre.
33.7% 36.5 burra 31.6 gra	Investime në bujqësi
30.9% 37.8 men 25.7 gra	Kontribute për sigurimet shoqërore – edhe për familjet e emigrantëve edhe për emigrantët që kanë ndërmend të kthehen në Shqipëri dhe që nuk kanë grumbulluar mjaftueshëm sigurime shoqërore në Greqi.
23.7% 26.3 burra 21.8 gra	Kursime për nevoja shtëpiake si për shembull për urgjenca në lidhje me shëndetin.

22.9% 14.9 burra 28.7 gra	Financim i arsimimit të pjesëtarëve më të rinj të familjes.
15.1% 7.4 burra 20.8 gra	Pagim i borxheve që nuk kanë lidhje me emigracionin. Dy grupe përfshihen në këtë: 1) më të varfërit të cilët marrin hua nga miqtë ose të afërmit për të mbuluar nevojat e konsumit të përditshëm. Zakonisht ata po ashtu blejnë ushqime me lista dhe i paguajnë këto pasi emigrantët u dërgojnë këstin e parë të parave nga jashtë. Familjet me origjinë egjiptiane dhe rrom ish-in më të shumtët në këtë kategori; 2) ata që kanë marrë kredi nga insitucione formale si për shembull, nga bankat ose nga IMF për të financuar bizneset e tyre (në shumicën e rasteve bujqësore) dhe i përdorin dërgesat për të paguar interesin e kredisë.
12.3% 8.1 burra 15.4 gra	Njësitë ekonomike familjare të varfëra i përdorin dërgesat për të paguar borxhet e lidhura me migrimin, si për shembull për të paguar shpenzimet për viza, transport dhe kontrabandistët (kur migrantët nuk marrin dot viza dhe hyjnë në Greqi nga mali psh.). Ky grup përbëhet sidomos nga emigrantët me origjinë rrome dhe egjiptiane.
6.9% 5.4 burra 7.9 gra	Për argëtim. Ndryshimet si pasojë e evoluimit të migrimit dhe dërgesave kanë sjellë dhe rritje të shpenzimeve për argëtim, si psh. dalja e çiftit të ri apo dhe me fëmijët për një drekë a darkë kur burri vjen për vizitë nga Greqia. Disa familje në gjendje më të mirë mund të shkojnë gjatë verës me pushime në bregdet.
3.1% 4.8 burra 2 gra	Blerje trualli në qytet për të ndërtuar shtëpi ose për investim. Studimi ynë nuk i regjistroi me anë të pyetësorit shumat e dërguara për këtë qëllim sepse emigrantët i administrojnë vetë ato dhe nuk kalojnë nëpër duart e familjarëve në fshat. Nga intervistat e thelluara doli se këto shuma janë mjaft të rëndësishme dhe zakonisht dërgohen nga llogaria bankare e burrit emigrant në Greqi tek llogaria e tij bankare në Shqipëri.
2.6% 3.4 burra 2 gra	Investime në biznese jo bujqësore, gjë që reflekton në njëfarë mase mundësitë e investimeve në zonat rurale, klimën e investimeve dhe bizneseve në Shqipëri më gjerë, dhe mundësitë e kufizuara për aktivitete fitim-prurëse në fshatrat.
0%	Asnjë nga të intervistuarit tanë nuk paguhej për përkujdesjen e fëmijëve të pjesëtarëve të tjerë të familjes që ndodhen në emigracion – bij apo bija. Natyrisht dërgesat nga këta emigrantë përdoren për të mbuluar nevojat e këtyre fëmijëve, dhe nuk do të dërgoheshin (të paktën në atë sasi) nëse fëmijët nuk do të jetonin në fshat. Mbi të gjitha është e rëndësishme të theksohet karakteri informal i këtij organizimi, i cili bazohet në reciprocitet dhe altruizëm.

5.6 Investimet

Në studimin tonë, pjesa më e madhe e investimeve të ndërmarra nga emigrantët janë në fushën e ndërtimit, riparimit dhe të përmirësimit të banesës ku jeton familja. Kjo ndodh më shpesh në fshatin e prejardhjes. Emigrantët gjithashtu përdorin dërgesat për të blerë apo ndërtuar banesa në zonat urbane, sidomos në kryeqytet. Shuma të rëndësishme të hollash kursehen për këtë qëllim dhe dërgohen nga llogaria bankare e emigrantit në Greqi, tek llogaria e tij bankare në Shqipëri. Këto shuma nuk janë kapur nga pyetësi ynë nëpër fshatra, sepse paratë nuk kalojnë nëpërmjet prindërve që ndodhen në fshat. Banesat e ndërtuara ose të blera shërbejnë si një investim kapitali dhe social. Nga njëra anë ato ofrojnë një burim të ardhurash nëpërmjet qiradhënies ose nëpërmjet një shitjeje të mundshme në të ardhmen. Nga ana tjetër, ato mund të shërbejnë si shtëpi për kohën e daljes në pension për emigrantët vetë, apo si shtëpi për fëmijet e tyre nëse dhe kur këta kthehen në Shqipëri. Në këtë mënyrë këto prona shërbejnë si një rrjet sigurie për të ardhmen.



Banesat para emigrimit në jug-lindje të Shqipërisë



Ndërtimi i shtëpive është shpesh një produkt i të ardhurave nga dërgesat (si edhe kjo shtëpi e ilustruar më lart) në jug-lindje të Shqipërisë

Dërgesa të tjera investohen në biznes. Nëpërmjet intervistave të thelluara me migrantë të kthyer dhe me aktorët kyçë lokalë, si edhe nëpërmjet vëzhgimeve, mësuam se shumica dërrmuese e bizneseve të zonës janë ndërtuar falë shumave të dërguara nga emigrantët, zakonisht nga Greqia. Disa dërgesa janë përdorur për të emigruar më tej në Itali, nga ku shuma të tjera parash janë dërguar për të investuar në fshat.

Një pjesë e rëndësishme e popullsisë ka investuar në sektorin bujqësor në fshatrat e tyre. Këto përfshinin fshatarin e thjeshtë që shet qumështin e prodhuar nga lopa e tij e vetme për të zgjeruar burimet e të ardhurave për familjen e tij, deri tek fermerët më të mëdhenj të cilët kultivojnë hektarë me mollë, qepë dhe patate, apo fermerët që merren me blegtori (në përgjithësi 50-100 krerë dele, derra, apo duzina demash për mbarështim), dhe deri tek ata që kanë furra buke. Zakonisht vetëm pjesëtarët e familjes punojnë këtu, por disa nga fermerët që kultivojnë sipërfaqe të konsiderueshme toke punësojnë punëtorë krahu gjatë periudhave kur puna është më intesive, si për shembull gjatë mbjelljeve, prashitjeve apo korrjeve. Në dy biznese bujqësore numri i punëtorëve të krahut ishte 25 dhe 50 persona në të njëjtën kohë, ndërsa zakonisht fermat punësonin më pak se 10 punëtorë. Pjesa më e madhe e këtyre ishin gra, të cilat preferoheshin nga punëdhënësit për arsye të cilësisë së lartë të punës që ato bënin në krahasim me burrat. Shumë prej tyre ishin me origjinë rome dhe egjiptiane, si edhe disa nga familjet më të varfra që

banonin aty pranë. Në këtë mënyrë aktivitetet bujqësore lokale të financuara nga dërgesat kanë ndikuar në hapjen e disa vendeve të punës, sado sezonale, sidomos për gratë e fshatit. Nga ana tjetër preferenca për punëtorë me karakteristika të caktuara tregon prekshmërinë e një pjese të popullsisë e cila nuk ka të njëjtat mundësi për të emigruar dhe gjithashtu nuk ka të njëjtat mundësi për të gjetur punë për arsyë të seksit, klasës sociale apo etnisë të cilës i përket.

Sektori jo-bujqësor ku investohen një pjesë e dërgesave, përbëhet në përgjithësi nga dyqane ushqimore të vogla, disa bar-restorante, bilardo, një a dy magazina, një pikë furnizimi me karburant, automjete transporti si furgonë, kamionë të tonazhit të rëndë dhe ndonjë parukeri. Përveç këtyre, disa ndërmarrje me përmasa më të mëdha po zhvillohen si për shembull një fabrikë për gdhendje mermeri në të cilën ishin punësuar edhe individë të tjerë përveç pjesëtarëve të familjes. Duket qartë që rëndësia e dërgesave në zhvillimin e ekonomisë lokale është domethënëse në këto komunitete.

Nga ana tjetër investime janë bërë gjithashtu edhe në kapitalin njerëzor nëpërmjet financimit të arsimimit të pjesëtarëve më të rinj të familjes, të shëndetit dhe pagesave për sigurimet shoqërore dhe pensionet e pleqërisë.

Përveç parave emigrantët dërgojnë edhe lloje të tjera të ardhurash si ato materiale, sociale dhe kolektive.

5.7 Dërgesa materiale (sendet)

Pothuajse gjysma e të intervistuarëve tanë u përgjigjën se kanë marrë dërgesa materiale të ndryshme. Statistikisht më të rëndësishme ishin veshmbathjet, ushqimet, ilaçet dhe aparatet elektro-shtëpiake sipas kësaj renditje. Emigrantët sillnin zakonisht ushqime me vete kur vinin në fshat për vizitë, jo vetëm për familjarët aty por edhe për ata vetë për t'i përdorur gjatë kohës që ata janë në fshat. Shpjegimet e dhëna për këtë ishin se disa produkte greke ishin me cilësi më të lartë (në periudha të caktuara të vitit), duke pasur parasysh edhe faktin që Shqipëria shpesh shërben si 'kosh' për mallra të skaduar. Disa herë ndodh që emigrantët të jenë mësuar me një element gatimi të veçantë të cilin nuk e gjejnë dot në Shqipëri.

Çfarë të sjellim? Veshje, ilaçe, limona dhe pompa uji

Përveç lekëve, dërgojmë edhe rroba se janë dhe më lirë këtu [Greqi].... Unë nënës i marr ca ilaçe se ka tensionin ajo dhe ja marr këtu ilaçet ... Edhe ushqime. Se vemë rrim 2-3 ditë dhe ushqime marrim. Po edhe marrim ato që i përdorim për vete. Jo se s'ka të mira, atje [Shqipëri] janë më të shijshme nuk diskutohet. Po marrim edhe këtej se tashi psh. domatet atje mund të jenë më shtrenjt në këtë periudhë [mars], limonat këto janë më të lira këtej, edhe vaji i ullirit psh. është më i lirë këtej Unë kam shpënë, pompa uji kam shpënë, ngrohës që ngrohesh, se këtu janë më të lira... Po porositi donjë nga këto të sojt se jo për tërë fshatin.

(Xhimi, 50 vjeç, Selanik)

5.8 Dërgesat sociale

Ndërkohë që pjesa më e madhe e literaturës është përqendruar më shumë tek dërgesat e parave, përmasat sociale të ndikimit të emigracionit në vendet e prejardhjes janë lënë pas dore dhe rrallë herë janë studiuar në mënyrë sistematike (Hugo 2005; Piper 2005). Këto ndikimeve jo-financiare njihen me emrin 'dërgesa sociale'. Këto 'ide, sjellje, identitete, dhe kapitale sociale që rrjedhin nga komunitetet në vendet pritëse tek

ato në vendet e prejardhjes' (Levitt 1995: 927) janë thelbësore për të kuptuar emigrantët si aktorë kyçë të ndryshimit social dhe politik, si dhe mënyrat nëpërmjet të cilave emigracioni ndikon për të ndryshuar jetën e atyre që qëndrojnë mbrapa (Nyberg Sorensen 2005). Në fakt, në prizmin afatgjatë këto dërgesa sociale mund të jenë edhe më të rëndësishme sesa transfertat e parave (Kapur 2004). Për më tepër ka një lidhje midis dërgesave sociale dhe mënyrave të përdorimit të dërgesave në para; për shembull mund të ndodhë një ndryshim nga përdorimi i parave të dërguara që mbulojnë shpenzimet e konsumit të përditshëm në përdorimin e tyre për investime në biznes, pasi një kulturë sipërmarrëse vjen e zhvillohet në rrjetet e gjera të migrantëve dhe familjarëve të tyre.

Në kontekstin shqiptar emigrantët janë të lidhur me vendin e prejardhjes dhe sillen si përcjellës të njohurive, ideve dhe praktikave duke përdorur mënyra të ndryshme. Me fjalë të tjera, praktikat transnacionale janë në rritje dhe është duke u formuar një hapësirë sociale transnacionale, sidomos ajo që përfshin Greqinë dhe Italinë (Chiodi dhe Devole 2005; Maroukis 2005a;2005b). Së pari, emigrantët ndjekin ngjarjet më të rëndësishme në Shqipëri nëpërmjet mediave etnike si psh. në televizionin satelitor, gazetave, internetit etj. Së dyti, ata shkëmbejnë njohuritë dhe idetë e tyre me pjesëtarët e familjes dhe shoqërinë në Shqipëri duke përdorur video, telefonat, letrat dhe në më të rritje edhe internetin. Së treti, kthehen në Shqipëri me pushime, ose për të marrë pjesë në ngjarje të rëndësishme familjare. Ata që jetojnë më afër kufirit mund ta bëjnë këtë më shpesh. Për më tepër, praktika biznesi dhe tregtie janë duke u zhvilluar, të cilat favorizohen nga lidhjet që kanë migrantët me partnerë biznesi ku punojnë. Këto ide dhe praktika që emigrantët sjellin me vete ose që përcjellin nëpërmjet kanaleve të ndryshme të komunikimit ndikojnë në ndryshime në lidhje me rolet gjinore në familje e shoqëri, marrëdhëniet e rolet midis brezave brenda familjes, në identitetin etnik, në klasën ose statusin social, si dhe në demografi, pjesëmarrjen sociale dhe politike dhe në të drejtat e njeriut në Shqipëri. Si rezultat i të jetuarit jashtë shtetit, emigrantët kanë zhvilluar pritje të caktuara se çfarë është e pranueshme dhe çfarë nuk është, sidomos në lidhje me rolin që duhet të kenë qeveritë lokale dhe qendrore, cilësinë e shërbimeve etj.

Gjatë studimit tonë vëzhguam një sërë ndryshimesh që kish sjellë emigracioni. Së pari, janë aftësitë dhe idetë që sjellin apo përcjellin emigrantët, sidomos ata që udhëtojnë shpesh midis vendit pritës dhe Shqipërisë. Disa prej këtyre aftësive janë aplikuar me sukses në feramat bujqësore apo në krijimin dhe mirëmbajtjen e baçave me mollë, që janë disa nga investimet më të rëndësishme në zonë.

Molla bie nën mollë: dërgesat në baçë me mollë

Kur shkoj në shpi marr me vete ilaçe [pesticide], tubacion për ujë, pompë e gjëra, investoj. Dhe bile kam bërë një rrjet vaditës me ato metodat time të hidraulikut që punoj këtu. I kam marrë dhe i kam shpënë atje dhe kam bërë një rrjet vaditës që të vaditet vetë. Me të ardhurat e mia që punoj... Po shpie dhe ilaçe e çdo gjë. Psh. më merr babai në telefonon më thotë më duhet kjo, kjo. Jam lidhur me një, si i thuhet, me një dyqan, magazinë. Vet i shpje, dua këtë, këtë, dhe ata m'i japin e i shpje në Shqipëri... Si transport paguaj taksinë ose një njeri që shkon dhe rreth 20-30 euro për ilaçet... Në fshat deshëm të mundësonim ndonjë aktivitet grumbullimi mollësh. Jam interesuar dhe këtu [Greqi] për shitjen që të eksportoje këtu, se punonja dhe në një firmë supermarketi këtu.... kam folur me ta dhe ... të shohim.

(Besmir, 24 vjeç, Selanik)

Besmiri jo vetëm që po investon në produkte bujqësore – familja e tij ka filluar të mbjellë 1.2 hektarë baça me mollë – por po përdor njohuritë e fituara në Greqi për të zhvilluar biznesin e tij bujqësor. Për më tepër ai ka transformuar lidhjet e punës në mundësi njohje dhe krijimi rrjetesh, sidomos meqënëse synon të eksportoje produktet e tij në tregun grek. Ajo çfarë i nevojitet është mbështetje dhe këshillim sesi të shumëfishojë potencialin e biznesit të tij.

Ndërsa disa ide dhe praktika, si për shembull të rejat në bujqësi, janë të mirëpritura në Shqipëri, ndryshimet përta i përket marrëdhënieve gjinore, në veçanti se si duhet të sillen gratë, duhet akoma shumë kohë që të ndodhin. Gratë emigrante që kthehen në fshat ndjehen të pakënaqura me kufizimet që vendosen tek ato nga normat tradicionale të roleve gjinore, sidomos ato që kufizojnë lëvizjen e tyre dhe ndikojnë në mënyrën sesi trajtohen në shoqëri.

Rezistencë kundrejt dërgesave sociale

E di si na thonë neve? Na thonë kështu. I thotë babai djalit: "Dëgjo bir i babait, unë të kam rritur dhe të njoh shumë mirë, po që kur ke ikur në Greqi nuk e di unë, thotë, sikur anon njëçikë më shumë, sikur ja dëgjon gruas llafin njëçikë më shumë"... Flasim mosha 50-60 e ashtu, kupton që janë mësuar me atë [mënyrë tjetër jetese]. Tashi që t'i mbushësh mëndjen atij kështu! Ata rrinë të dëgjojnë nga malli që nuk të kanë parë më shumë, të shikojnë kështu, sesa të dëgjojnë, se nuk ju hyn në mend atyre me këto kushte që jetojmë ne këtej [Greqi], nuk i mbushet mendja atyre. Që t'i thuash, ore baba ti mirë e ke po emigracioni, Greqia ose Italia tërë ata që kanë ikur jashtë shtetit, që kanë ikur shqiptarët, nuk është sic thua ti. Sepse gruaja ime vajti në punë dhe kthehet në orën 6. Atëherë kush do më gatuajë mua, kush do më lajë mua? Nëse ke fëmijë të vogël kush do ta mbajë fëmijën? Apo këta i dëgjojnë veresie, kështu i dëgjojnë xhaba [greqisht për kot fare] këto muhabete. Ka ndryshuar nuk është ajo e para më...

(Sulo, 42 vjeç, Selanik)

Nuk ndryshojnë, është e vështirë të ndryshojnë ... Vinja në behar këtë rradhë që erdha, shkonja në Korçë. Burri më la dhe iku [më parë në Greqi]. Une vajta dhe vinja në Korçë të shikonja shtëpinë. Dhe kur më shikonte ndonjë komshi atje: do shkosh në Korçë? Ja, po marr një furgon. A vetëm do të shkosh në Korçë? Mund të them që Selaniku, ti e di sesa i madh është, është sa ta bashkosh Korçën me Pojanin. Dhe i bie 16 herë vërdallë në ditë, mund të vete ku të dua. Edhe kur shkonja në punë. Ato [komshitë në fshat] e kishin problem se unë shkoja në Korçë vetë. Motrën që kam këtu [Selanik] e kam larg si Pojani me Korçën. Unë i marr fëmijët e shkoj çdo të shtunë, çdo të dielë. Burri shkon në punë dhe unë e marr në telefon dhe i them që drekën ta bëra dhe do shkoj nga motra. Ik thotë, nuk është ndonjë problem që të më thotë si do shkosh ti vetëm deri atje... Kurse aty [fshat] është njëçikë, se më vriste njëçikë ajo që më thoshte: vetë do shkosh në Korçë ti? Ishe e detyruar të ishe me një shoqëris që të shkonje në Korçë.

(Irena, 37 vjeç, Selanik)

Kombinimi i dërgesave financiare dhe sociale ka ndryshuar aspiratat për standartet e jetesës dhe sesi bëhet një jetë e mirë dhe 'normale'. Ky kombinim ka qenë i rëndësishëm në prodhimin e migrimin të mëtejshëm tek të rinjtë. Ky cikël varësie nga emigrimi mund të vazhdojë për aq gjatë sa do të vazhdojë të ekzistojë në Shqipëri papunësia lokale, mundësi të kufizuara punësimi, liri të mohuara dhe infrastrukturë e varfër, ndërkohë që punësimi jashtë vendit dhe vartësia ndaj dërgesave financiare do të vazhdojnë të jenë bazat për mbijetesën e komuniteteve lokale.

6

NDIKIMI I DËRGESAVE NË ZHVILLIMIN LOKAL

Dërgesat janë një element i rëndësishëm jo vetëm për jetën dhe ekonominë e individëve dhe të familjeve, por gjithashtu edhe të komuniteteve lokale në tërësi. Së pari, ka zhvillim ekonomik falë shumave të parave që hyjnë në ekonominë lokale nëpërmjet investimeve në ndërtim, konsum ushqimor, shëndetësi dhe shkollim, si dhe në biznese bujqësore dhe jo bujqësore. Së dyti, ka përmirësim të standarteve të jetesës së familjeve të emigrantëve, por gjithashtu edhe të familjeve që nuk kanë emigruar. Ky efekt rrjedhës ndihet nga ata që punësohen si punëtorë krahu nga familjet e emigrantëve, ose nga bizneset lokale dhe tregtarët ambulantë kur dërgesat shpenzohen në dyqanet dhe baret e tyre. Së treti, cilësia e produkteve dhe e shërbimeve të ofruara në fshatra është përmirësuar duke qenë se emigrantët përdorin teknikat e përfituara jashtë vendit kur riparojnë shtëpitë e tyre ose ndërtojnë shtëpi të reja, kur punojnë në ndërtim në fshat, ose pajisin feramat e tyre me sisteme hidrike moderne dhe mjete të mekanizuara. Në fakt, shumë njësi ekonomike familjare që kultivojnë sipërfaqe të mëdha toke, kanë blerë traktorët e tyre, gjë që ka vënë në lëvizje një proces mekanizimi modern. Por përvoja e migracionit ka ndryshuar gjithashtu edhe mendimet, pasi me rritjen e dërgesave është rritur gjithashtu edhe mentaliteti për të investuar në ekonominë lokale.

Megjithatë, mund të shihen gjithashtu edhe disa aspekte negative. Për shembull, ekziston një shkallë e rëndësishme pabarazie në këto zona rurale midis familjeve të emigrantëve dhe atyre që nuk kanë emigrantë. Megjithëse pyetësi ynë nuk na lejon të analizojmë këtë fenomen më në detaje (pasi në të u përfshinë vetëm familjet me emigrantë), mundëm të arrijmë te ky përfundim falë vëzhgimeve të bëra në terren, si dhe intervistave me ato familje të cilat përfitojnë nga lloje emigracioni më pak fitimprurës. Komuniteti romë dhe egjiptianë vazhdojnë të jenë më të përjashtuarat, edhe pse ka edhe familje shqiptare që jetojnë në varfëri të thellë. Paratë sigurisht nuk janë gjithçka dhe kostoja njerëzore dhe emocionale e emigracionit ishte e dukshme gjatë bashkëbisedimeve tona me ata që kishin ngelur mbrapa. Ndarja e familjeve, sidomos kur emigrantët nuk mund të udhëtojnë për shkak të mungesës së dokumentave, është një sakrificë që konsiderohej prej tyre e nevojshme për të siguruar një të ardhme më të mirë. Megjithëse një pjesë e mirë e familjeve janë larguar përgjithmonë nga këto fshatra, këto zona rurale nuk janë të braktisura dhe kanë potencial për nisma zhvillimi në të ardhmen.

6.1 Efektet e marrjes së dërgesave në marrëdhëniet gjinore

Efektet e dërgesave në marrëdhëniet gjinore në këtë studim reflektojnë tiparet e një shoqërie disi më të barabartë në juglindje të Shqipërisë. Pritjet përta i përket roleve brenda familjes nuk kanë ndryshuar shumë në zonat rurale në Shqipërinë juglindore: burrat e kanë 'detyrë' të sigurojnë të ardhurat në shtëpi, ndërsa gratë të kujdesen për fëmijët, për shtëpinë dhe për të moshuarit, sidomos kur ata janë të sëmurë dhe të pafuqishëm. Në zonat rurale gratë punojnë gjithashtu në fushë bashkë me meshkujt e familjes, edhe pse këta kanë detyrimin kryesor për këtë lloj pune. Gratë që punojnë jashtë familjes nuk janë

diçka e re në Shqipëri. Edhe pse kemi diskutuar më lart për natyrën patriarkale të shoqërisë shqiptare, gjatë periudhës socialiste gratë në fshatra punonin në kooperativat bujqësore bashkë me burrat. Ajo që ka ndryshuar për arsye të emigracionit është se, ndërsa burrat punojnë jashtë vendit, grave u është dashur të përballojnë një ngarkesë pune më të rëndë në shtëpi duke u kujdesur për fëmijët vetëm dhe gjithashtu duke vazhduar të punojnë në fushë.

Në njësitë ekonomike familjare të drejtuara nga gratë, të cilat përbëjnë një përqindje e konsiderueshme në kërkimin tonë, emigrimi dhe dërgesat kanë patur efekte të përziera. Nga njëra anë ka më shumë mirëqënie dhe një rritje të kushteve të jetesës falë parave që burri sjell nga Greqia. Kjo gjë natyrisht e bën më të lehtë përkujdesjen për shtëpinë dhe familjarët, krijon një të ardhme më të mirë për fëmijët dhe një jetë familjare më të mirë për të gjithë pjesëtarët e saj. Nga ana tjetër, shumë nga gratë që intervistuaam ndjeheshin se kishte dhe anë negative në gjithë këtë histori, dhe kështu jo gjithmonë ishte rritur fuqizimi i tyre. Së pari, kostoja emocionale dhe njerëzore e ndarjes së familjes është një nga çështjet më të rëndësishme për familjet e emigrantëve. Çiftet takohen me njëri-tjetrin vetëm disa herë në vit dhe për pak ditë. Kjo është e vështirë për të dy bashkëshortët, por mbi të gjitha është e vështirë për fëmijët, të cilët rriten pa pasur figurën e babait në jetën e tyre të përditshme. Nëna ngelet e vetme që të merret me nevojat emocionale të fëmijëve. Së dyti, gratë ndihen të fuqizuara deri në një farë mase, pasi janë në gjendje të marrin vetë vendime të ndryshme, por në të njëjtën kohë ato ndiejnë peshën që shkaktohet nga fakti se duhet të kujdesen për ekonominë e gjithë shtëpisë dhe nuk mund ta ndajnë këtë përgjegjësi me burrat e tyre. Së treti, gratë jo gjithmonë marrin vendimet se si do të shpenzohen paratë e dërguara ose të sjella nga burrat e tyre, edhe pse ekziston një farë barazie. Së katërti, pak gra qëndrojnë në shtëpi vetëm për t'u përkujdesur për fëmijët; pjesa më e madhe e tyre kombinonë mëmësinë dhe rolin e shtëpiakes me punën në bujqësi. Kjo mund të jetë në kopshtin e perimeve afër shtëpisë, duke u marrë me bagëtinë apo duke punuar në baçat me mollë. Kur nuk ka pjestarë të tjerë të familjes si vjehrrit apo fëmijë të rritur që mund të ndihmojnë, ato krijojnë aleanca informale me farefisën e kushërinjtë duke ndihmuar njëri-tjetrin në periudhat me punë më intensive si për shembull gjatë mbjelljes dhe të korrave. Gratë që jetojnë në familje shumë të varfëra zakonisht nuk kanë tokë të tyre për ta punuar. Në të tilla raste, kur ka punë ato punojnë si punëtore krahu në bujqësi ose në fshatin e tyre, ose në fshatrat pranë. Disa gra punojnë në rrobaqepsitë që ndodhen në Korçë – zakonisht me pronësi greke – ndërsa një numër i konsiderueshëm i grave rrome dhe egjiptiane punojnë bashkë me bashkëshortët e tyre në zonat rurale greke si migrante sezonale. Ato që kanë ndonjë dyqan, floktore ose furra buke punojnë në këto aktivitete.

Dërgesat mund të luajnë një rol pozitiv edhe sepse ato rrisin mundësitë që vajzat e reja të ndjekin arsimin e lartë, duke rritur kështu mundësitë e tyre për të qenë më të pavarura dhe në lëvizje sesa vajzat e reja që janë me arsim të ulët. Një zhvillim i tillë i kapitalit njerëzor është shumë i rëndësishëm për familjet, edhe pse jo gjithmonë kjo gjë mund të përkthehet në zhvillim për zonat rurale. Për shembull një numër i madh të rejash që kanë diplomë universitare nuk mund të gjejnë punë, kështu që ato janë të detyruara të kalojnë kohën e tyre duke qëndruar në shtëpi. Me mbarimin e shkollës/universitetit ato kanë pak mundësi për të dalë dhe për të kaluar kohë me shoqërinë e tyre, sidomos pasi nuk ka mundësi argëtimi për vajzat e reja në zonat rurale, përveç bisedave informale apo një kafe në shtëpitë e njëra-tjetrës. Mentaliteti mbizotërues që barazon vajzat e gratë me 'nderin' e familjes duhet të ndryshohet në qoftë se këto do të jenë në gjendje të gëzojnë hapësira më të gjera emancipimi dhe lirie. Gratë më të mëdha në moshë – si nënat, gjyshet e vjerrat – kanë përgjegjësinë e tyre për krijimin e këtij mjedisi mbytës po aq sa edhe burrat.

Pavarësisht emigracionit, dhe ndoshta edhe për shkak të tipologjisë dominuese të migrimit nga kjo zonë – burrat në fillim, duke tërhequr gratë si bashkëshorte, ndërsa vajzat migrojnë si pjesëtare të familjes – janë të pakta ato gra (beqare ose të martuara) që emigrojnë për arsye ekonomike vetë, dhe kur kjo ndodh këto gra nuk shihen me sy të mirë. Nga ana tjetër, për gratë, burrat e të cilave kanë siguruar dokumenta të përhershme dhe që kanë një punë të qëndrueshme, perspektiva e bashkimit familjar

në Greqi është e dëshirueshme. Kjo është edhe më e theksuar për faktin se mundësitë e punësimit për gratë në kontekstin lokal janë shumë të kufizuara, dhe puna në bujqësi konsiderohet me status social shumë të ulët, por edhe që sjell shumë pak fitime ekonomike. Për më tepër, sidomos vajzat e reja të sapo martuara dëshirojnë të gëzojnë disa nga përfitimet sociale të emigracionit, si për shembull më shumë liri lëvizjeje dhe më shumë mundësi për tu argëtuar.

6.2 Dërgesat dhe sipërmarrja

Pjesa më e madhe e bizneseve në studimin tonë janë krijuar duke përdorur dërgesat, ose mbas kthimit të emigrantëve në vendlindjen e tyre. Megjithatë, shumica e tyre janë regjistruar në emrat e burrave të familjes. Për shembull, nga 28 biznese të regjistruara në Pojan vetëm 6 kryesohen nga gra, dhe në 29 biznese të regjistruara në Zvezdë vetëm 5 kryesohen nga gra. Një sërë aktorësh kyçë lokalë na njoftuan se edhe pse biznesi ishte në emër të burrit, dhe punësonte vetëm një person, zakonisht si burri edhe gruaja punojnë në të, dhe në 80 përqind të rasteve gratë kryejnë pjesën më të madhe të punës, si dhe merren me llogaritë dhe administrimin e biznesit etj. Duke qenë se burri është i vetmi person që figuron si i punësuar në biznesin e familjes, ai është i vetmi që përfiton nga sigurimet shoqërore si i vetë-punësuar; sipas ligjit, këto gra janë punonjëse që zhvillojnë aktivitetin e tyre në sektorin informal të ekonomisë. Në fakt disa nga intervistuesit tanë u shprehën me ironi që këto gra janë vetëm 'punonjëset' e burrave të tyre, sepse burri është ai që drejton, ndërsa ato pastrojnë dyqanin dhe shesin produktet aty gjatë gjithë ditës. Në këto raste u përdor fjala 'argat', e cila në gjuhën shqipe ka një kuptim negativ që lidhet me konceptin e punës së detyruar dhe të shfrytëzimit të trashëguar nga sistemi gjysëm-feudal osman. Në ditët e sotme kjo fjalë përdoret për të identifikuar ata individë që punojnë si krahë pune dhe që kanë punë me status të ulët.¹² Donika, 37 vjec, që jeton në fshat thotë:

Gruaja është me e shtypur në krahasim me burrin këtu në Shqipëri ... në fshat është pak më e vështirë ... Po dole deri atje kjo ka mbaruar thonë. Nuk ka lëvizur akoma mentaliteti këtu i qëmotshëm.

Edhe pse disa familje janë larguar përgjithmonë nga fshati, këto zona rurale nuk janë të braktisura dhe kanë potencial të konsiderueshme për nisma zhvillimi. Pjesëmarrësit e studimit tonë shikonin një potencial të rëndësishëm në bujqësi, sidomos në rritjen në shkallë të gjerë të disa llojeve frutash dhe perimesh. Këtu, mbjellja e baçave me mollë ka pësuar një rritje të madhe, dhe këto u lejojnë familjeve të fitojnë shuma të mira parash, disa herë të barabarta me shumën që vijnë nga Greqia. Duke qenë se kjo lloj bujqësie shihet si më e specializuar, është më e përfillur nga të rinjtë. Mentaliteti rreth bujqësisë gjithashtu po ndryshon: ka më shumë interes për bujqësinë kur individit e shikon veten si fermer – pronar tokash dhe në të njëjtën kohë punëdhënës. Këto janë shenja që disa fermerë të pasur janë duke ri-përqafuar statusin e pronarëve të tokave të para luftës. Megjithatë këto sipërmarrje kanë nevojë për kapital të konsiderueshëm në mënyrë që të arrijnë të ecin vetë.

Me rritjen e prodhimit lokal të frutave dhe perimeve, po ashtu rritet dhe potenciali për të investuar në agro-biznese që përdorin këto materiale. Kështu, na u dhanë shembuj si frigoriferë për mollët apo perimet që ishin duke u ndërtuar ose mund të ndërtoheshin për shitjen e mollëve brenda vendit por edhe për eksport; punishte për reçel e komposto frutash; punishte për turshi; zgjerimin e baxhove (punishte për përpunimin e produkteve të qumështit) ekzistuese apo krijimin e të rejave etj. Disa nisma kanë filluar në këtë drejtim. Megjithatë, të gjitha këto janë biznese që kanë nevojë për kapital financiar dhe njohuri, gjëra të cilat fshatarëve të varfër ju mungojnë. Ajo që këta shpresonin në rastin më të mirë ishte të përdornin dërgesat për të riparuar banesën e tyre ose për të ndërtuar një të re. Sigurisht jo të gjithë kanë

12. Ndërsa shumë nga fermerët që punësojnë këto punëtore përdorin këtë fjalë, disa prej tyre i shtuan një aspekt tjetër kontekstit duke e paraqitur veten e tyre si fermerë apo si bosa të pasur në rendin e ri social të këtyre fshatrave.

në plan të bëhen sipërmarrës apo punëdhënës. Një pjesë e mirë do të ishin të kënaqur thjesht të gjenin një punë aty rrotull me kontratë apo si punëtorë krahu. Në përfundim, është e rëndësishme të sigurohet kuadri – legjislativi, infrastruktura, mbështetje biznesi - në të cilin emigrantët afatgjatë (dhe investitorë të tjerë) të mund të fillojnë dhe zhvillojnë biznese si këto që u përmendën më lart me qëllim që të nxisin ekonominë lokale dhe zhvillimin njerëzor.

6.3 Lidhjet midis Migrimit dhe Zhvillimit

Gjatë kërkimit tonë nuk gjetëm asnjë lloj dëshmie të politikave apo programeve të bashkë-zhvillimit të organizuara midis Shqipërisë dhe Greqisë, jo vetëm në nivel lokal por edhe në atë qendror.¹³ Sikur shumë nisma në vend, edhe ato në fushën e zhvillimit kishin në qendër të vëmendjes çështjen e imigracionit shqiptar në Greqi, e jo aq shumë çështjen e zhvillimit të Shqipërisë. Edhe pse ekzistojnë një sërë projektesh që lidhin këto dy vende, aty ku përfshihet migrimi ato konsiderojnë të kenë si qëllim përbushjen e objektivave të zhvillimit dhe imigracionit të Greqisë. Për shembull, pjesa dërmuese e këtyre nismave kanë për qëllim uljen e emigracionit të padëshiruar ose 'ilegal' nga Shqipëria në Greqi duke trajnuar policinë kufitare, ri-integruar emigrantët e riatdhesuar 'vullnetarisht' në Shqipëri etj. Përveç kësaj organizatat e emigrantëve shqiptarë shpesh anashkalohen nga programe të tilla ose inkuadrohen si partnerë konsultativ 'simbolikë' me rol të kufizuar. Politikat efektive të bashkë-zhvillimit do të duhet të shikojnë zhvillimin lokal si një objektiv në vetvete e jo si një mjet për të ndalur apo reduktuar emigracionin e mëtejshëm, siç ka ndodhur deri tani. Zhvillimi i qëndrueshëm do të duhet të trajtojë të gjitha aspektet e zhvillimit njerëzor, domethënë kushtet në të cilat burrat dhe gratë të jenë në gjendje të ushtrojnë lirinë, barazinë dhe fuqizimin shoqëror të tyre, përfshi këtu edhe përmes emigracionit por jo vetëm. Politikat dhe nismat e bashkë-zhvillimit që konsiderojnë gratë dhe burrat migrantë si aktorë të zhvillimit duhet të bazohen në njohjen e rolit të tyre edhe si aktorë kyçë në shoqërinë pritëse. Kjo do të pasqyrohej në mundësinë e tyre për të përdorur të drejtat e tyre që lidhen me qytetarinë duke ua bërë të mundshëm legalizimin në vendin pritës – në këtë rast në Greqi – dhe përfshirjen e tyre në shoqëri si qytetarë me dinjitet, me të drejta dhe përgjegjësi.

6.4 Lidhjet me diasporën dhe shoqatat e migrantëve

Ndërsa shumë migrantë kishin në dijeni për ekzistencën e organizatave të migrantëve në Selanik, të tjerë dyshonin në aftësinë e krerëve të këtyre organizatave për të mbrojtur të drejtat e migrantëve në vend të interesave të tyre personale. Po ashtu, vetë shoqatat e migrantëve në Greqi mendojnë se ka një mungesë të theksuar bashkëpunimi me OJQ-të e zhvillimit në Shqipëri. Ato pak nisma që ekzistojnë fillojnë në Shqipëri dhe këto projekte konsiderohen sikur i shërbejnë interesave të po këtyre OJQ-ve shqiptare e jo në përbushje të nevojave për bashkëpunim reciprok në të dy anët e kufirit greko-shqiptar.

Në Shqipëri, anëtarësimi në organizata formale ishte gjithashtu i ulët, dhe aty ku kjo ekzistonte, ishte shpesh simbolike. Edhe pse një sërë prej pjesëmarrësve në studim ishin anëtarë të disa grupeve të interesit, shpeshherë këto ishin krijuar nga agjencitë e huaja donatore dhe ishin organizata vetëm në letër: në praktikë ato nuk funksiononin. Sidoqoftë fshatarë të tjerë kishin marrë disa nisma vetë psh. për të rregulluar dhe mirëmbajtur rrugën apo lagjen e tyre, duke mbledhur para me njëri-tjetrin dhe duke i kompletuar punimet vetë.

Zakonisht banorët në këto fshatra prisnin që qeveria lokale dhe qendrore të bënte gjithçka për ta – një mentalitet i trashëguar nga e kaluara socialiste dhe ajo më e hershme gjysëm-feudale. Megjithatë, mund

13. Bashkë-zhvillimi si një kombinim i politikave të migrimit nga vendi pritës për bashkëpunim ku prioritet i jepet zhvillimit të vendit të origjinës së migrantëve, i cili shoqërohet me politika integruese zhvilluese të tyre, sipas sugjerimit të Sami Nair në 1997, në Ramiréz et al. (2005: 31).

të vihen re disa aktivitete që sapo kanë filluar dhe shpresojmë se ato mund të kultivohen dhe të rriten në të ardhmën. Për shembull, në dy fshatrat fqinjë me ato ku ne kryem studimin, një grup djemsh të rinj migrantë që jetojnë në Greqi kishin mbledhur para mes tyre dhe ia kishin dhënë kryetarit të fshatit për të paguar faturën e rrymës elektrike dhe riparimeve të tjera për ndriçimin e rrugëve të fshatit. Po kështu, gjatë intervistës që bëmë me kryetarin e komunës ai përmendi se është rritur interesimi i migrantëve për të kontribuar në projekte të përbashkëta, sidomos për disa nisma që kishin marrë organizatat lokale.

Një nismë transnacionale për jetimët

Shoqata e Fëmijëve dhe të Rinjve Jetimë ka si qëllim ndërgjegjësimin për, dhe përmirësimin e, situatës së fëmijëve dhe të rinjve jetimë në fshatrat ku u krye studimi si dhe në ato përreth. Ndër aktivitetet e tjera kjo OJQ organizoi dhe festën e natës së Vitit të Ri me një grup fëmijësh jetimë në dhjetor të vitit 2007. Një çift me origjinë nga fshati, por me banim në Itali, organizoi mbledhjen e parave dhe dhuratave për fëmijët nëpërmjet rrjetit të tyre shoqëror e familjar në Itali, përfshi këtu edhe firmën ky çifti punon. Ata të dy erdhën vetë në fshat për të sjellë dhuratat dhe për të marrë pjesë në festë. Kjo nismë u çmua shumë në fshat dhe frymëzoi migrantë të tjerë të cilët filluan të pyesin sesi dhe ata mund të kontribuonin në raste të tilla.¹⁴ E njëjta OJQ mundësoi një udhëtim për pushime në Greqi për një grup fëmijësh jetimësh, me ndihmën e Unionit të Miqësisë Korçë-Selanik që është pjesë e Federatës së Shtëpisë Epirote. Megjithatë, me kalimin e kohës lidhjet kishin humbur dhe fatkeqësisht nuk kanë më kontakt mes tyre. Një prej aktiviteteve më inkurajuese ishte organizimi i një udhëtimi ditor për nënat (të vejat) që të kalonin kohë së bashku buzë liqenit në Pogradec, duke lënë pas sikur edhe për një ditë, problemet dhe hallet e jetës së përditshme dhe thjesht të pushonin në një ambient tjetër.

14. Nga intervista e thelluar me znj. Marjeta Jani, drejtoreshë e Shoqatës së Fëmijëve dhe të Rinjve Jetimë; 5 mars 2008.

7 AKTORËT KYÇË

Aktorët kyçë në fushën e zhvillimit në Shqipëri përbëhen nga komuniteti i donatorëve, qeveria e Shqipërisë dhe sektori i OJQ-ve.

Aktorët Kyçë	Përshkrimi
Komuniteti i donatorëve	<ul style="list-style-type: none"> Në Shqipëri veprojnë 45 donatorë. Sekretariati Teknik i Donatorëve (STD) shërben për koordinimin e aktiviteteve të donatorëve në nivel qendror. Ai udhëhiqet nga PNUD-i, Banka Botërore (BB), Komisioni Evropian (KE) dhe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). STD-ja punon me homologen e saj në qeveri, Departamentin e Koordinimit të Strategjive dhe të Donatorëve (DKSD). Projekti 'Një OKB' (përforcimi i aktiviteteve, aftësive, financimit dhe bashkëpunimit të agjencive të OKB-së në vend) është duke u provuar në Shqipëri dhe punon së bashku me DKSD-në e qeverisë shqiptare. Bashkëpunimi përfshin dhe angjenci të tjera jashtë OKB-së por aktiviteti i të cilave është i lidhur me këtë, si psh. BB-ja, Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM).
Qeveria e Lokale dhe Qendrore	<ul style="list-style-type: none"> Ndihmat nga jashtë administrohen nga DKSD-ja që vetë i jep llogari dy Komiteteve Ndër-Ministore: atij për Planifikimin Strategjik të kryesuar nga Kryeministri dhe atij për Modernizimin e Qeverisë të kryesuar nga Z/Kryeministri. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MEPÇSSHB) është autoriteti që ka përsipër koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Migracionin (SKM) dhe të Planit Kombëtar të Veprimit (PKV) për Dërgesat. MEPÇSSHB-ja koordinon edhe aktivitetet për çështjet gjinore. Aktivitetet që kanë të bëjnë me gjininë janë të koordinuara përmes Sektorit për Barazi Gjinore në Drejtorinë e Politikave për Shanse të Barabarta të kësaj ministrie. Drejtoria ka krijuar një rrjet të kontakteve të pikave qendrore për çështjet e gjinisë në nivel qendror dhe lokal. Përveç kësaj Drejtoria punon ngushtë edhe me agjencitë donatore dhe me komunitetin e OJQ-ve në Shqipëri. Ministri të tjera dhe departamente të qeverisë kanë përfituar nga një numër projektsh që kanë synuar të integrojnë gjininë në politikat dhe praktikat e tyre, nëpërmjet asistencës teknike dhe financiare të donatorëve ndërkombëtar.
OJQ-të	<ul style="list-style-type: none"> Deri në fund të vitit 2005 kishte më shumë se 600 OJQ aktive që punonin në aktivitete të ndryshme, prej dhënies së shërbimeve deri te përkrahja dhe mbështetja e grupeve në nevojë apo çështjeve si të drejtat e njeriut, si dhe grupime të ekspertëve (think-tank). Një numër i madh OJQ-sh kanë projekte në lidhje me gjininë dhe shumë prej tyre janë të përfshira në aspekte të ndryshme të zhvillimit, por shumë pak merren me çështjet e migracionit. Zhvillimi i këtij sektori ka ndjekur interesat e donatorëve prandaj edhe shumica e OJQ-ve janë mjaft të varura nga fondet e donatorëve, vuajnë nga mungesa e strategjive dhe vizioneve afatgjata dhe punojnë nga një projekt në tjetrin. Bashkëpunimi në formën e aleancave, forumeve dhe rrjeteve është sporadik dhe varet nga projektet/ iniciativat, shpeshherë sepse kjo është kërkesë e donatorëve dhe jo sepse është pjesë e strategjisë së organizatës.

8

POLITIKAT PUBLIKE

Në 18 vitet e fundit politikëbërja në Shqipëri nuk ka qenë çështje vetëm e Qeverisë Shqiptare (QeSh), por ka qenë influencuar tepër nga BE, organizatat ndërkombëtare të zhvillimit, ndryshe të njohura edhe si komuniteti i donatorëve, dhe në një shkallë më të ulët nga shoqëria civile apo OJQ-të.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZhl) e QeSh (2007-2013) është një udhërrëfyes që përcakton përparësitë e zhvillimit kombëtar të Shqipërisë dhe hyrjes në BE.¹⁵ Ajo bazohet në mbledhjen e 20 strategjive sektoriale dhe 11 strategjive ndërsektoriale, përfshi këtu zhvillimin rajonal, migrimin, barazinë gjinore etj. Hyrja në BE është bërë tepër e rëndësishme në formulimin e përparësive të Shqipërisë, përfshirë çështjet e migracionit, sidomos pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) me BE-në më 12 qershor 2006.

Politika migratore e qeverisë shqiptare gjatë periudhës së komunizmit ka qenë e bazuar në kontrollin e rreptë të lëvizjeve brenda vendit dhe në ndalimin e migracionit ndërkombëtar. Kjo gjendje ndryshoi menjëherë pas rrëzimit të regjimit. Programet politike që pasuan, e trajtuan migracionin gjithmonë e më shumë: filimisht si çështje të politikës së jashtme ku vëmendja kryesore i kushtohej mundësitë të punësimit jashtë vendit përmes marrëveshjeve të punësimit të përkohshëm (1991); si çështje të Diasporës që synonte më shumë mbrojtjen e të drejtave etnike dhe kulturore dhe më pak punësimin dhe mbrojtjen legale (1996); dhe si çështje e politikës së brendshme dhe e asaj të jashtme duke synuar mundësi punësimi në Shqipëri në frontin e brendshëm dhe duke bashkëpunuar me qeveritë greke dhe italiane për legalizimin e shqiptarëve në ato vende në frontin e jashtëm (1997). Në vitin 1998 qeveria morri një kahje drejt 'Qasje e Kompletuar ndaj Menaxhimit të Migracionit' ku u prekën shumë çështje si për shembull mbledhja e shifrave dhe dokumentimi i emigrantëve shqiptarë jashtë vendit, trajtimi i legalizimit të tyre, përmirësimi i shërbimeve konsullore jashtë vendit, rishikimi i legjislacionit mbi emigrimin, hyrja në konventat ndërkombëtare sikurse edhe parandalimi i migracionit të parregullt (ACPS 2002: 10). Në vitin 2001 qeveria filloi ta konsiderojë emigracionin si çështje të Diasporës dhe u dha përparësi shqetësimeve për legalizimin e emigrantëve dhe mbrojtjen e tyre nga diskriminimi në vendet pritëse; emigrimi gjithashtu u bë çështje e politikës së jashtme, duke i dhënë përparësi lehtësimi të regjimit të vizave si kyçe në lidhjet me qeveritë e vendeve pritëse (ACPS 2002).

Pas shumë vitesh përpjekjesh dhe 'bërje detyrash shtëpie', më në fund u nënshkrua MSA-ja në vitin 2006, por procesi i ratifikimit të kësaj marrëveshjeje nga parlamentet kombëtare të secilit vend të BE-së ishte një proces shumë i ngadalshëm. Shumica e shqiptarëve e shohin hyrjen në BE si fundin e vuajtjeve të tyre dhe pritjeve në rradhë të gjata para dyerve të ambasadave për një vizë të shtrenjtë dhe shumë të vështirë për ta marrë. Por çështja është edhe më e komplikuar se kaq. Rreth 18 vjet më parë shqiptarët fituan lirinë e lëvizjes jashtë vendit, por tashmë bota jashtë nuk i donte më si emigrantë:

15. Acquis communautaire është tërësia e rregullave dhe normave të BE-së që duhet të plotësohet nga vendet e interesuara në mënyrë që të mund të kualifikohen për anëtarësim të plotë në BE.

pas zgjedhjeve të para pluraliste të pas-komunizmit, ata nuk konsideroheshin më si refugjatë. Që rreth vitit 2000, qeveritë e njëpasnjëshme shqiptare kanë vendosur rregulla gjithmonë e më të ashpra për të frenuar emigracionin e parregullt drejt vendeve fqinje, duke arrestuar shqiptarët në kufi para se të kalojnë në anën tjetër. Këtë herë ky akt nuk konsiderohej më si shkelje e të drejtave të njeriut të shqiptarëve për t'u larguar nga vendi i tyre dhe nuk dënohet nga demokracitë në 'Perëndim', siç ishte rasti – dhe me të drejtë – gjatë rregjimit komunist. Këtë herë zbatimi bëhet me urdhër (marrëveshje) të këtyre vendeve perëndimore të cilat përdorin rojet kufitare shqiptare për të kontrolluar hyrjen e shqiptarëve në territorin e tyre.

Me fjalë të tjera, ndërsa rrugët legale për migrim vijnë duke u ngushtuar sidomos për personat me arsim të ulët, të cilët janë edhe më nevojtarët për përfitimet nga emigrimi, eliminimi i migracionit të parregullt është bërë prioritet për përafrimin e Shqipërisë me BE-në. Në këto vitet e fundit kjo ka sjellë si pasojë rritjen e shkallës së dëbimeve nga Greqia dhe rritjes e pagesave tek kontrabandistët – rreth €2000-€3000 për një hyrje dhe deri në €5000 për një vizë dyvjeçarëshe (BE) Shengen (Kanellopoulos dhe Gregou 2006: 27-28).

8.1 Strategjitë Kombëtare

Strategjia Kombëtare për Migracionin

Në vitin 2004 u bë një përpjekja e koordinuar për të trajtuar çështjen e migracionit në mënyrë të kompletuar nëpërmjet përgatitjes së Strategjisë Kombëtare të Migracionit (SKM) dhe Planit Kombëtar të Veprimit (PKV). SKM-ja u përgatit nga QeSh me mbështetjen teknike të IOM-it, dhe me bashkë-financim nga IOM-i dhe KE-ja brenda programit të Ndihmës Komunitare për Rindërtim, Zhvillim dhe Stabilizim (CARDS) 2001. SKM-ja u nënshkruar nga Këshilli i Ministrave të Shqipërisë më 19 nëntor 2004. Më 30 dhjetor të po atij viti u krijua një grup pune për të formuluar më tej detajet e strategjisë në një plan veprimi. Duke patur parasysh natyrën shumë-dimensionale dhe shumë-disiplinare të migracionit, grupi përbëhej prej përfaqësuesve të ministrive përkatëse që kishin lidhje me migracionin.

SKM-ja dhe PKV-ja për Migracionin mbulojnë një mori çështjesh të grumbulluara nën katër objektiva thelbësore: lëvizshmëria (zgjerimi i kanaleve të rregullta për emigracion, kthim); zhvillimi (trajtimi i shkaqeve thelbësore të migracionit, dërgesave dhe 'kthimit të trurit'); mbrojtja (e emigrantëve jashtë vendit përmes mbështetjes të së drejtave të tyre dhe veprimit kundër shfrytëzimit, përmirësimit të shërbimeve konsullore shqiptare për qytetarët e mërguar, mbështetjes së formimit dhe konsolidimit të organizatave të diasporës në vendet pritëse); dhe integrimi (duke zhvilluar më tej kornizën legjislative, politike dhe institucionale në lidhje me emigracionin, kthimin dhe riatdhesimin e shqiptarëve dhe shtetasve të vendeve të treta (ShVT) me qëllim përafrimin e Shqipërisë me BE-në) (Geiger 2007).

Sipas një studimi të bërë nga një grup ekspertësh në Tiranë, të cilët monitoruan zbatimin e PKV-së për migracionin (Onorato et al. 2007), niveli i zbatimit ka qenë shumë i ulët dhe ka patur probleme të tjera të mëdha në koordinimin dhe organizimin e aktiviteteve. Sipas këtij raporti deri në fillim të vitit 2007 prej 63 masave që përcaktoheshin në PKV, vetëm 17 prej tyre (27 përqind e totale) ishte përbushur, 12 prej tyre (19 përqind) ishin përbushur pjesërisht që do të thotë se më shumë se gjysma nuk ishin zbatuar siç parashikohej në PKV. Shkalla e moskryerjes së veprimeve të përcaktuara në dokument ishte edhe më e lartë, 77 përqind. Edhe më shqetësues ishte fakti që prej 15 ministrive që u konsultuan gjatë studimit, tetë prej tyre as që e kishin idenë për ekzistencën e SKM-së dhe të PKV-së, për të mos folur për përmbytjen e tyre. Disa shkuan deri aty sa t'i quanin këto dokumente si 'pa vlerë', pasi ato ishin produkt i një qeverie që tashmë nuk ishte më në pushtet.

Plani Kombëtar i Veprimit për Dërgesat

PKV-ja për Dërgesat ka qenë një prej veprimeve të përcaktuara në SKM. Ai u aprovua nga Këshilli i Ministrave më 7 nëntor të vitit 2007, vendimi nr. 745. PKV-ja përbëhet nga tetë masa që duhen marrë nga një sërë aktorësh kyçë të ndryshëm përfshi këtu dhe ministrinë përkatëse, Banka e Shqipërisë, INSTAT-i dhe Posta Shqiptare. Masat paraprake i referohen:

- i. përmirësimin të të dhënave dhe praktikave më të mira për dërgesat;
- ii. zgjerimit të shërbimeve bankare në Shqipëri dhe përmirësimin të bashkëpunimit mes bankave të Shqipërisë, Greqisë dhe Italisë përsa i përket shërbimeve të ofruara për dërgesat;
- iii. zgjerimit të kapaciteteve të institucioneve të tjera financiare si psh. Institucionet Mikro-Financiare (IMF) që veprojnë në Shqipëri, sikurse edhe Postës Shqiptare, për transferimin e dërgesave apo përmirësimin e shërbimit aty ku ekziston;
- iv. përmirësimin të statusit legal të migrantëve në Greqi dhe Itali në mënyrë që t'ua lehtësojë mundësinë për punësim legal dhe përdorim të sistemit bankar në këto vende;
- v. përmirësimin të informacionit dhënë migrantëve para emigrimit, gjatë qëndrimit në vendet pritëse dhe pas kthimit, në lidhje me shërbime të ndryshme financiare përsa i përket dërgesave, kursimeve dhe investimeve; dhe
- vi. rritjes së kapacitetit të qeverisë shqiptare dhe organizatave të migrantëve në vendet pritëse që të bashkëpunojnë në nisma bashkë-zhvillimi midis këtyre vendeve.

Edhe pse qeveritë shqiptare janë zotuar të arrijnë Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit, një prej të cilave është dhe arritja e një niveli më të lartë barazie gjinore dhe fuqizimi të grave, SKM-ja, PKV-ja për Migracionin dhe PKV-ja për Dërgesat nuk e marrin fare në konsideratë gjininë si kategori analitike (Nixon 2006).

9 | REKOMANDIME

Mobilizimi i dërgesave për arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm që përfshin edhe gratë

Rrethi i Korçës për shkak të pozitës gjeografike, kushteve klimaterike dhe gjeo-morfologjike për bujqësi, fuqisë punëtore relativisht të arsimuar, dhe për shkak të hyrjes së një kapitali të konsiderueshëm përmes dërgesave, është një zonë me potencial zhvillimor të rëndësishëm. Përveç kësaj, sektori i bujqësisë – sidomos kultivimi i perimeve në shkallë të gjerë, punimi i pemishteve me mollë dhe kultivimi i blegtorisë – është zhvilluar veçanërisht mirë në vitet e fundit. Kombinimi i këtyre faktorëve e bën këtë zonë relativisht të begatshme në krahasim me fshatra të tjera të thellë malore. Për shumicën e popullsisë nuk është më çështje e mbijetesës por e zhvillimit. Por ky zhvillim deri tani ka ndodhur thujtë tërësisht nëpërmjet nismave private të njësive ekonomike familjare me emigrantë dhe pa emigrantë, pasi ndikimi i politikave në zhvillimin rural të rajonit dhe në shkallë vendi, si dhe ato për migracionin dhe gjininë, ka qenë i kufizuar.

Shqipëria ka miratuar një sërë strategjish që mbulojnë migracionin, zhvillimin, dërgesat dhe çështjet gjinore. Kjo duhet vlerësuar, duke patur parasysh rëndësinë e politikave në nivel qendror për formëzimin e ndikimit që migracioni i brendshëm dhe ai ndërkombëtar mund të kenë për vendin. Megjithatë, një mori pengesash duket se bllokojnë arritjen e rezultateve pozitive. Së pari, strategjitë e ndryshme rrallë janë të lidhura njëra me tjetrën, dhe ato së bashku me institucionet që kanë përgjegjësi për t'i zbatuar, duket se punojnë paralelisht, në vend që të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën. Së dyti, monitorimi i zbatimit të këtyre strategjive mbetet i dobët. Në disa prej sektorëve ku ky është kryer nga organizata të pavarura, niveli i zbatimit mbetet shumë i ulët, sikurse pamë në rastin e SKM-së dhe PKV-së për Migracionin (Onorato et al. 2007). Së treti, rezultatet e politikave kanë qenë mjaft të influencuara nga karakteri konfliktual i politikëbërjes shqiptare, si dhe nga mungesa e vazhdimësisë dhe stabilitetit tek punonjësit e administratës publike në thujtë të gjitha nivelet (Tahiraj 2007). Së fundi dhe çka është më me rëndësi për qëllimet e hulumtimit tonë, shumica e politikave nuk e përdorin gjininë si një mjet të integruar konceptual dhe analitik.

9.1 Reformat në strukturë dhe infrastrukturë

Gjetjet tona, në ngjashmëri me hulumtimet e mëparshme, theksojnë rëndësinë e politikave dhe zbatimin me efikasitet e tyre për të siguruar infrastrukturën e nevojshme fizike, legislative dhe administrative në mënyrë që të nxitet një mjedis i qëndrueshëm dhe frytdhënës biznesi, si dhe një cilësi më e lartë zhvillimi njerëzor. Nëse qeveritë shqiptare – lokale dhe qendrore – duan seriozisht të angazhojnë dërgesat dhe të tërheqin investime të huaja për të nxitur zhvillimin lokal dhe kombëtar, atëherë çështja e infrastrukturës duhet të ketë përparësi. Emigrantët, banorët në fshatra, emigrantët e kthyer dhe aktorët kyç që marrin pjesë në studimin tonë theksojnë vazhdimisht se kërkesat themelore

për t'i arritur këto qëllime janë: furnizimi i duhur me ujë dhe rrymë elektrike, rrjete të përshtatshme transporti (veçanërisht në zonat rurale), forcimi i shtetit ligjor dhe shtetit të së drejtës, zgjidhja e çështjes së pronësisë së tokave dhe ulja e burokracisë për biznese. Nga ana tjetër, çdo nismë zhvillimi duhet të trajtojë përparësitë e grupeve të ndryshme të shoqërisë nga ana gjinore, etnike dhe moshës.

Jeta e banorëve të fshatrave që u përfshinë në këtë studim është përqendruar prej shekujsh tek blegtorja dhe bujqësia. Bujqësia vazhdon të jetë aktiviteti më i rëndësishëm për të siguruar të ardhurat për shumicën e popullsisë dhe është i vetmi aktivitet për disa familje shumë të varfra. Megjithatë, ky sektor vuan nga një sërë problemesh strukturore dhe lokale. Së pari, tregjet e siguracioneve të prodhimeve bujqësore mungojnë; po ashtu mungon informacioni mbi çmimet e tregut; ka mungesë të bujqësisë në shkallë të gjerë dhe asaj të mekanizuar; kontrolli në nivelet e larta për cilësinë e produkteve të importuara si psh. pesticidet dhe ilaçet e tjera për bimët e bujqësisë dhe pemët frutore nuk janë efikase për të mos thënë që nuk zbatohen fare; dhe ka shumë konkurrencë nga produktet më të lira që importohen. Pjesa më e vështirë për bujqit ka qenë gjetja e tregjeve për të shitur prodhimet e tyre, të cilat shpesh mbeten në stok dhe hidhen tej pasi janë kalbur. Si rezultat i marrëveshjeve të ndryshme pas hyrjes në Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT), tregu shqiptar shpesh përmytet nga importe më të lira nga vendet fqinjë si Greqia dhe Maqedonia, ku fermerët gëzojnë mundësinë e kultivimit në shkallë të gjërë, bujqësia ka një shkallë më të lartë mekanizimi, dhe ata pëfitojnë nga subvencione dhe mbështetje institucionale. Në të kundërtën, në Shqipëri tokat janë të ndara në parcela të vogla dhe pasiguria, për sa i përket pronësisë, vazhdon të ndikojë në planet e ardhshme për investime, si dhe ka një shkallë të ulët mekanizimi. Gjendja është duke u përmirësuar, dhe në fshatrat e studimit tonë u vu re një rritje e konsolidimit të tokave përmes tregut të blerjeve dhe të qirave. Po ashtu po konsolidohen edhe llojet e prodhimeve që kultivohen, pasi një numër në rritje bujqsh tani po përqendrohet në kultivimin në shkallë të gjerë të fasules, patateve dhe qepëve. Pas një gjysëm shekulli të ekonomisë së planifikuar, bujqit dalngadalë po mësohen me mekanizmat e ekonomisë së tregut. Për shkak të kolektivizimit me forcë gjatë kohës së komunizmit, shumica e bujqve nuk e shohin të mundshme bashkëpunimin me njëri-tjetrin në tipe kooperativash, gjë që i lë individët të pafuqishëm për t'u përballur me fuqinë e tregut. Bashkëpunimi më i madh bëhet në bazë familjesh dhe fisi zakonisht për të përballuar procese të veçanta që kërkojnë punë krahu intensive si psh. mbjelljet dhe korrjet, por kjo akoma nuk përfshin tregtimin kolektiv të prodhimeve.

Sektorë të tjera të ekonomisë si tregtia, ndërtimi, dhe shërbimet kanë qenë në rritje e sipër, por këto kërkojnë investime kapitali financiar që jo gjithmonë janë në dispozicion. Në këto vitet e fundit kreditë e mundësuar nga bankat kanë ardhur duke u rritur, sidomos për investimet në bujqësi dhe blegtori. Megjithë këtë potencial, papunësia vazhdon të jetë e lartë, sidomos tek popullsia rome dhe egjiptiane, të cilët zakonisht nuk kanë as tokë bujqësore pasi një pjesë e shitën për të mbijetuar, ndërsa të tjerë emigruan nga një fshat në tjetrin.

9.2 Normat dhe rregullat për migracionin në Greqi

Interesat e vendeve pritëse si Greqia pasqyrohen edhe në politikat e tyre migratore, duke ndikuar kështu potencialin për zhvillim të Shqipërisë. Rezultatet e këtij studimi sugjerojnë se përfitimet nga emigracioni kanë pasur një kosto të lartë njerëzore dhe emocionale të cilën e kanë paguar emigrantët dhe familjet e tyre. Emigrantët dhe familjet e tyre si dhe përfaqësuesit e organizatave të emigrantëve dhe disa aktorë kyçë raportuan të shkuarën e turpshme të qeverisë greke sikurse edhe të institucioneve, mediave dhe shumë pjesëve të shoqërisë greke në lidhje me diskriminimin, shfrytëzimin dhe përjashtimin e burrave, grave dhe fëmijëve emigrantë – sidomos atyre shqiptarë. Në vitet e fundit gjërat po ndryshojnë, pjesërisht për shkak të presionit nga institucionet e BE-së, por edhe të presionit nga ajo pjesë e shoqërisë greke që është e orientuar në mbrojtje të të drejtave njerëzore. Njohja e

emigrantëve shqiptarë si pjesë e shoqërisë greke, do të tregonte jo vetëm mirëkuptim ndaj gjendjes së tyre, por edhe do të reflektonte njohje të kontributit thelbësor dhe domethënës që emigrantët japin për këtë vend - Greqinë. Ky kontribut demografik, ekonomik, social dhe kulturor duhet të çmohet dhe të mos shpërdorohet duke i bërë emigrantët aktorë të zhvillimit të vendit.

Së pari, pas gjithë këtyre viteve qëndrimi dhe pune në Greqi, emigrantëve shqiptarë aty duhet t'u jepet e drejta dhe mundësia për qëndrim të përhershëm dhe për nënshtetësi. Sidomos për fëmijët që kanë lindur në Greqi apo shkuan aty që të vegjël fare, Greqia është faktikisht atdheu i tyre (Gogonas 2007). Dhënia e këtyre të drejtave për emigrantët jo vetëm që zbut pasojat negative të përmendura më lart, por tregon pjekuri demokratike të një qeverie e cila nuk i frikësohet qytetarësisë shumë-etnike. Duke patur parasysh se statusi ligjor i shumicës së emigranteve shqiptare në Greqi është i lidhur me atë të burrave të tyre – sipas hyrjes dhe qëndrimit për bashkim familjar me burrin – emigracioni e përforcon varësinë e gruas tek meshkujt e tyre të afërt, dhe nuk shërben si një mjet Mancipimi. Për pasojë, gratë emigrante nuk kanë mundësi të ndahen nga burrat në rastet kur këta të fundit i keqtrajtojnë ato dhe ushtrojnë dhunë mbi to. Politika e imigracionit në Greqi duhet ta trajtojë këtë situatë që gratë të mund të marrin lejen e qëndrimit vetë, pavarësisht nga burrat e tyre. Së treti, anëtarët e familjeve të emigrantëve, si psh. bashkëshortët apo prindërit, duhet të kenë mundësinë të jetojnë me ta dhe t'i vizitojnë emigrantët në Greqi, dhe procesi duhet të jetë me më pak shpenzime, me më pak burokraci, dhe i arritshëm. Nga ana tjetër, siguria e statusit të emigrantëve do të ndikonte pozitivisht edhe në zhvillimin e Shqipërisë, pasi në vend që të përpiqen pafundësisht për të përmbushur kërkesat për dokumentacion në Greqi, ata do të mund të përqendroheshin në përmirësimin e të ardhurave dhe aftësive të tyre. Në veçanti, disa emigrantë (gjysëm) të kualifikuar kanë potencial të rëndësishëm për të shërbyer si ura në mes të dy vendeve duke kështilluar dhe udhëzuar kompanitë greke që duan të investojnë në Shqipëri (për shembuj të ngjashëm shiko dhe Labrianidis et al.2004).

Në anën shqiptare, qeveria e Shqipërisë duhet të mbrojë me vendosmëri të drejtat e emigrantëve në vendet pritëse, sikurse duhet të bëjë marrëveshje me këto shtete për të siguruar kanale më të gjera për një migracion të rregullt të burrave dhe grave. Në kuadër të përpjekjeve për anëtarësim në BE, qeveria e Shqipërisë ka modifikuar qëndrimin e saj sipas presioneve të BE-së dhe ka vendosur interesat e këtyre vendeve mbi ato të qytetarëve të saj. Pra, marrëveshje të ndryshme bilaterale dhe multilaterale kanë pasur në qendër të vëmendjes sidomos frikën e Greqisë dhe të vendeve të tjera të BE-së nga migracioni i parregullt shqiptar (shiko si shembull negociatat e Marrëveshjes së Ripranimit me BE-në, IOM 2006; 2006b). Gjatë marrëveshjeve të tilla të ardhshme, është e rëndësishme që kotributi pozitiv i migrantëve t'u bëhet e ditur qeverive të vendeve pritëse si asaj greke. Kërkimet sistematike në këtë drejtim dhe mbështetja e këtyre politikave në kërkime të tilla është thelbësore. Siç shihet në këtë raport, shtigjet e ndërlikuara dhe të shumëfishta që marrin familjet e emigrantëve si pjesë e strategjisë së tyre për jetesë, nxjerrin në pah agjenci dhe rezistencë, të cilat sikur të mbështeteshin nga politikat pozitive, do të kishin qenë të dobishme për të dy vendet në nivel lokal por dhe qendror. Në të njëjtën kohë Shqipëria duhet të ndjekë politika të integruara ku zhvillimi nuk është i bazuar vetëm në eksportin e fuqisë punëtore dhe në dërgesat, por edhe në krijimin e mundësive të shëndosha dhe afatgjata socio-ekonomike në vend.

9.3 Zhvillimi

Çdo projekt i ardhshëm që përfshin gratë dhe zhvillimin lokal, duhet të konsiderojë dinamikat e fuqizimit gjinor ashtu si ato dalin në pah në hapësirat private dhe publike. Një qasje e tillë që i përgjigjet nevojave gjinore do të duhej së pari të trajtonte pjesmarrjen tejet të kufizuar të grave në hapësirat publike politike dhe të vendimarrjes. Së dyti, do të shmangte 'instrumentalizimin' e mundshëm të grave që mund të krijohej nëse ngarkesa e detyrave rritet, por nuk shoqërohej në të njëjtën kohë me

zgjerrimin e hapësirave për pjesëmarrje politike dhe ku zëri i tyre të dëgjohet. Së treti, do të shmangte rrezikun e përforcimit të stereotipeve gjinore. Për shembull, disa nga projektet e zhvillimit në zonën e studimit synonin aktivitete për gratë duke u nisur nga roli i tyre si shtëpiake, dmth përkujdesëse dhe pastruese, pa u munduar të inkurajojnë një imazh ndryshe të ndarjes gjinore të aktiviteteve në familje apo në fshat. Bazuar në kërkimin tonë dhe sidomos duke konsideruar reagimet dhe sygjerimet e banorëve në këto zona, përfshi këtu dhe emigrantët të kthyer, si dhe të aktorëve kyçë lokalë, për një zhvillim lokal që i përgjigjet nevojave gjinore, ne propozojmë një qasje të dyfishtë si vijon. Së pari, rritjen e aktiviteteve lokale që krijojnë të ardhura, nëpërmjet kanalizimit të investimeve private nga emigrantët (dhe të tjerë), në industrinë e agro-biznesit. Mekanizmat e vendosura duhet të jenë në gjendje të përfshijnë kapacitetet e tanishme dhe të ardhshme të bujqësisë dhe blegtorisë në zonë, duke rritur në maksimum shfrytëzimin e dërgesave që tashmë janë investuar në këto sektorë. Ky bashkëpunim duhet të synojë përfshirjen e shoqatave lokale si psh të atyre që përfaqësojnë interesat e fermerëve. Duhet të aktivizohen mekanizma të cilët do ta rrisnin pjesëmarrjen kuptimplotë (jo simbolike) të gruas në shoqata, në procese konsultative dhe komisione këshilluese.

Së dyti, të promovohen dërgesat kolektive nëpërmjet planifikimit strategjik lokal të projekteve për punë publike. Procesi me të vërtetë duhet të jetë pjesëmarrës, gjithpërfshirës dhe transparent, duke lënë një periudhë prej disa javësh ose muajsh për konsultime me grupet e komunitetit lokal dhe aktorëve të tjerë kyçë; duke krijuar dhe aktivizuar komisione këshilluese dhe borde administratorësh me pjesëmarrjen e banorëve lokalë, emigrantëve, akademikëve, këshilltarëve të pavarur, komunitetit të biznesit, OJQ-ve etj; duke praktikuar llogaridhënien para pjesëmarrësve dhe komunitetit në lidhje me shpenzimet financiare, vendimarrjet dhe rezultatet; duke inkurajuar pjesëmarrjen e grave nëpërmjet 'diskriminimit pozitiv' edhe duke vendosur kuota pjesëmarrje nëse është e nevojshme.

Me qëllim rritjen e aftësive dhe kapacitetit të grave për të marrë pjesë në mënyrë domethënëse në këto nisma, mundësitë e trajnimit duhet të kenë në qendër të vëmendjes gratë, e sidomos ato me arsim të ulët dhe nga komunitetet rome dhe egjiptiane. Këto programe mund të përfshinin trajnime në aftësi administrimi biznesi si administrim të financave, të burimeve njerëzore dhe projektsh; kontabilitet; aftësi kompjuterike; marketing; këshillime; kurse makinash; dhe duke mbështetur e inkurajuar shoqatat dhe grupimet e interesit informale të grave. Trajnimet duhet të përshtaten edhe për individë në mosha më të rritura, dhe të përdorën metodologji mësimdhënie që inkurajojnë pjesëmarrjen; të bëhet publicitet dhe të kryhen edhe në zonave rurale; dhe të ketë qartësi në procesin e seleksionimit. Përveç kësaj, fushatat e ndryshme ndërgjegjësimi të synojnë inkurajimin e një imazhi tjetër për burrat, një imazh ku ndarja gjinore e punëve dhe detyrave me burrat pjesëmarrës në punët e shtëpisë dhe përkujdesjen të trajtohet si diçka pozitive dhe e dëshiruar.

Së fundi, një vërejtje për të pasur kujdes. Zhvillimi lokal që i përgjigjet nevojave gjinore, nëpërmjet përfshirjes së dërgesave të migrantëve nuk duhet të konsiderohet si ilaçi çudibërës që do të rregullojë të gjitha problematikat e shoqërisë rurale. Burrat dhe gratë emigrante kanë vite që po mbajnë mbi shpatulla të vetmuar barrën e rëndë të financimit të mbijetesës dhe zhvillimit njerëzor të familjeve të tyre nëpërmjet dërgesave monetare. Ata kanë zëvendësuar për një pjesë të konsiderueshme shërbimet e mangëta të politikave të fragmentuara dhe të papërshtatshme sociale që ka vite që mbizotërojnë në zonat rurale, duke financuar shëndetin, edukimin, dhe pensionet e pleqërisë për anëtarët e familjeve të tyre; duke siguruar kapital për bujqësinë dhe për biznese të vogla familjare; dhe në përgjithësi duke siguruar mbijetesën e familjeve dhe komunitetit të tyre. Është përgjegjësi e qeverive për të siguruar kuadrin e përshtatshëm strukturor ku investimet e mëtejshme mund të çojnë në rritjen dhe përmirësimin e lirive dhe të mundësive. Për pasojë, nuk është e arsyeshme që emigrantët të ngarkohen më tej me përgjegjësi për zhvillimin e zonave nga ku vijnë. Kjo gjë duhet të konsiderohet vetëm nëqoftëse qeveritë janë me të vërtetë të gatshme të marrin përgjegjësitë që i takojnë atyre për një zhvillim ekonomik njerëzor në shkallë lokale and kombëtare.

REFERENCA

ACPS (2002) An Annotated Compendium Relating to the Albanian Legislation, State Structure, and Policy on Emigration Since 1990. Tirana: Albanian Centre for Parliamentary Studies.

Baldwin-Edwards, M. (2004) Statistical Data on Immigrants in Greece. An Analytic Study of Available Data and Recommendations for Conformity with European Union Standards. Athens: Mediterranean Migration Observatory.

Baldwin-Edwards, M. and Apostolatos, K. (2009) Greece, in Fassmann, H., Reeger, U. and Sievers, W. (eds) Statistics and Reality: Concepts and Measurements of Migration in Europe. Amsterdam: Amsterdam University Press.

Baldwin-Edwards, M. and Kolios, N. (2008) Immigrants in Greece: Characteristics and Issues of Regional Distribution. Athens: ISTAME.

Barjaba, K. and King, R. (2005) Introducing and theorising Albanian migration, in King, R., Mai, N. and Schwandner-Sievers, S. (eds) The New Albanian Migration. Brighton: Sussex Academic Press, 1–28.

Belba, A. (2005) Roli i pozitës gjeografike në zhvillimin ekonomik të rajonit të Korçës, Studime Gjeografike, 15: 86-94.

Bitzenis, A. and Nito, E. (2006) Lack of financial intermediaries as a decisive barrier to entrepreneurship in Albania, South Eastern Europe Journal of Economics, 4(1): 95-114.

Brunnbauer, U. (2000) From equality without democracy to democracy without equality? Women and transition in South-East Europe, South-East Europe Review, 3(3): 151-68.

Carletto, G., Davis, B., Stampini, M. and Zezza, A. (2004) Internal Mobility and International Migration in Albania. Rome: FAO, ESA Working Paper 04-13.

Cavounidis, J. (2004) Migration to Greece from the Balkans, South Eastern Europe Journal of Economics, 2(1): 35-59.

Chiodi, L. and Devole, R. (2005) Albanian migrants in Italy and the struggle for recognition in the transnational public sphere, in Chiodi, L. (ed.) The Borders of the Polity. Migration and Security Across the EU and the Balkans. Ravenna: Longo Editore, 169-208.

de Rapper, G. (2005) Better than Muslims, not as good as Greeks: emigration as experienced and imagined by the Albanian Christians of Lunxhëri, in King, R., Mai, N. and Schwandner-Sievers, S. (eds) The New Albanian Migration. Brighton: Sussex Academic Press, 173-94.

De Soto, H., Beddies, S. and Gedeshi, I. (2005) Roma and Egyptians in Albania. Washington: World Bank.

Fakiolas, R. (2003) Regularising the undocumented migrants in Greece: procedures and effects, Journal of Ethnic and Migration Studies, 29(3): 535-61.

Gammeltoft, P. (2002) Remittances and other financial flows to developing countries, International Migration, 40(5): 181-211.

Geiger, M. (2007) Migration management in Albania. Mapping and evaluating outside intervention, Migration Letters, 4(2): 119-33.

Ghosh, B. (2006) Migrants' Remittances and Development: Myths, Rhetoric and Realities. Geneva: IOM and the Hague Process on Refugees and Migration.

Gogonas, N. (2007) Ethnolinguistic Vitality and Language Maintenance in Second-Generation Migrants: A Study of Albanian and Egyptian Pupils in Athens. Brighton: University of Sussex, DPhil thesis in Linguistics.

Government of Albania (2005) National Strategy on Migration. Tirana: Government of Albania and IOM.

Gropas, R. and Triandafyllidou, A. (2005) Overview of Country Report prepared for the POLITIS project 'Building Europe with New Citizens? An Inquiry into the Civic Participation of Naturalised Citizens and Foreign Residents in 25 Countries'. Athens: ELIAMEP.

Hall, D. (1994) Albania and the Albanians. London: Pinter.

Hatziprokopiou, P. (2003) Albanian immigrants in Thessaloniki, Greece: processes of economic and social incorporation, Journal of Ethnic and Migration Studies, 29(6): 1033-57.

_____. (2004) Balkan immigrants in the Greek city of Thessaloniki: local processes of incorporation in an international perspective, European Urban and Regional Studies, 11(4): 321-38.

- _____. (2006) *Globalisation, Migration and Socio-Economic Change in Contemporary Greece: Processes of Social Incorporation of Balkan Immigrants in Thessaloniki*. Amsterdam: Amsterdam University Press.
- Hernández-Cross, R., de Luna Martinez, J., Amatuzio, A., Borowik, K. and Lagi, F. (2006) *The Italy-Albanian Remittance Corridor. Shifting from the Physical Transfer of Cash to a Formal Money Transfer System*. Washington: The World Bank and Convergence.
- Hugo, G. (2005) *Migrants in Society: Diversion and Cohesion*. Geneva: Global Commission on Migration.
- IOM (2006a) *Return and Readmission to Albania. The Experiences of Selected EU Member States*. Tirana: International Organisation for Migration.
- _____. (2006b) *Return and Readmission. The Case of Albania*. Tirana: International Organisation for Migration.
- Iosifides, T. and King, R. (1998) Socio-spatial dynamics and exclusion of three immigrant groups in the Athens conurbation, *South European Society and Politics*, 3(3): 205-29.
- Kanellopoulos, K. and Gregou, M. (2006) *Policy Report on Migration, Asylum and Return in Greece*. Athens: Centre of Planning and Economic Research (KEPE).
- Kapur, D. (2004) *Remittances: The New Development Mantra?* Geneva: United Nations Conference on Trade and Development and the Intergovernmental Group of Twenty-Four on International Monetary Affairs. G-24 Discussion Paper Series, 29.
- Kasimis, C., Papadopoulos, A.G. and Zacopoulou, E. (2003) Migrants in rural Greece, *Sociologia Ruralis*, 43(2): 167-84.
- King, R. (2000) Southern Europe in the changing global map of migration, in King, R., Lazaridis, G. and Tsardanidis, C. (eds) *Eldorado or Fortress? Migration in Southern Europe*. Basingstoke: Macmillan, 1-26.
- _____. (2005) Albania as a laboratory for the study of migration and development, *Journal of Southern Europe and the Balkans*, 7(2): 133-56.
- King, R., Dalipaj, M. and Mai, N. (2006) Gendering migration and remittances: evidence from London and Northern Albania, *Population, Space and Place*, 12(6): 409-34.
- King, R., Iosifides, T. and Myrivili, L. (1998) A migrant's story: from Albania to Athens, *Journal of Ethnic and Migration Studies*, 24(1): 159-75.
- King, R. and Mai, N. (2004) Albanian immigrants in Lecce and Modena: narratives of rejection, survival and integration, *Population, Space and Place*, 10(6): 455-77.
- _____. (2008) *Out of Albania: From Crisis Migration to Social Inclusion in Italy*. Oxford: Berghahn.
- King, R. and Vullnetari, J. (2003) *Migration and Development in Albania*. Brighton: University of Sussex, Development Research Centre on Migration, Globalisation and Poverty, Working Paper C5.
- _____. (2006) Orphan pensioners and migrating grandparents: the impact of mass migration on older people in rural Albania, *Ageing and Society*, 26(5): 783-816.
- _____. (2009) The intersections of gender and generation in Albanian migration, remittances and transnational care, *Geografiska Annaler: Series B, Human Geography*, 91(1): 19-38.
- King, R. and Zontini, E. (2000) The role of gender in the South European immigration model, *Papers, Revista de Sociologia*, 60: 35-52.
- Korça Regional Council (2005) *Regional Development Strategy, Millennium Development Goals*. Korça Region. Korça: Korça Regional Council.
- Korçë Municipality (2005) *Local Action Plan for the Environment*. Tirana: Regional Environmental Centre (REC) for Central and Eastern Europe.
- Kretsi, G. (2005) The uses of origin: migration, power-struggle and memory in southern Albania, in King, R., Mai, N. and Schwandner-Sievers, S. (eds) *The New Albanian Migration*. Brighton: Sussex Academic Press, 193-212.
- Kring, T. (2007) *Enhancing the Impact of Migrant Remittances in Albania: An IOM and ILO Working Paper*. Geneva: ILO/IOM.
- Labrianidis, L. and Hatziprokopiou, P. (2005) The Albanian migration cycle: migrants tend to return to their country of origin after all, in King, R., Mai, N. and Schwandner-Sievers, S. (eds) *The New Albanian Migration*. Brighton: Sussex Academic Press, 93-117.
- Labrianidis, L., Lyberaki, A., Tinios, P. and Hatziprokopiou, H. (2004) Inflow of migrants and outflow of investment: aspects of interdependence between Greece and the Balkans, *Journal of Ethnic and Migration Studies*, 30(6): 1183-208.

- Lazaridis, G. and Wickens, E. (1999) 'Us' and the 'Others': ethnic minorities in Greece, *Annals of Tourism Research*, 26(3): 632-55.
- Lerch, M. and Wanner, P. (2008) *Demographic Data in Albania: Results of An Assessment*. Geneva: Geneva University.
- Levitt, P. (1998) Social remittances: migration driven local-level forms of cultural diffusion, *International Migration Review*, 32(4): 926-48.
- Logoreci, A. (1977) *The Albanians. Europe's Forgotten Survivors*. London: Victor Gollancz.
- Lubonja, F. (2001) Privacy in a totalitarian regime, *Social Research*, 68(1): 236-53.
- Maroukis, T. (2005a) Albanian migrants in Athens and the emergence of a transborder public sphere, in Chiodi, L. (ed.) *The Borders of the Polity. Migration and Security Across the EU and the Balkans*. Ravenna: Longo Editore, 189-207.
- _____(2005b) Albanian migrants in Greece: transcending 'borders' in development, *Journal of Southern Europe and the Balkans*, 7(2): 211-33.
- Moreno-Fontes Chammartin, G. and Cantú-Bazaldúa, F. (2003) Identification of Potential for Increasing Employment and Productive Investment in Albania, Moldova and Ukraine Based on Remittances. *International Migration Papers 74*. Geneva: ILO.
- Murzaku, I.A. and Dervishi, Z. (2003) Albanians' first post-communist decade. Values in transition: traditional or liberal?, *East European Quarterly*, 37(2): 231-56.
- Nixon, N. (2006) The absence of gender: Albania's National Strategy on Migration, *Albanian Journal of Politics*, 2(1): 44-61.
- Nyberg Sørensen, N. (2005) *Migrant Remittances, Development and Gender*. Copenhagen: Danish Institut for International Studies.
- Onorato, M., Keta, M. and Totozani, I. (2007) *Raport mbi Zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Migracionit*. Tirana: Instituti Europian i Tiranës.
- Piper, N. (2005) *Gender and Migration*. Geneva: Global Commission on Migration, Paper 10.
- Piperno, F. (2005) Albanian migrants' remittances: a development opportunity?, in King, R., Mai, N. and Schwandner-Sievers, S. (eds) *The New Albanian Migration*. Brighton: University of Sussex Press, 118-38.
- Pratsinakis, E. (2005) Aspirations and strategies of Albanian immigrants in Thessaloniki, *Journal of Southern Europe and the Balkans*, 7(2): 195-212.
- Psimmenos, I. (2000) The making of periphractic spaces: The case of Albanian undocumented female migrants in the sex industry of Athens, in Anthias, F. and Lazaridis, G. (eds) *Gender and Migration in Southern Europe: Women on the Move*. Oxford: Berg, 81-101.
- Smith, E. (2009) 'Gap-fillers' or 'clan-destroyers'? Transnational female solidarity towards kin in the region of Fier, *Southeast European and Black Sea Studies*, 9(4): 555-73.
- Tahiraj, E. (2007) *Poverty and Anti-Poverty Programmes in Albania. The Role of Social Policy in Transition and Consolidation*. York: University of York, DPhil thesis in Social Policy and Social Work.
- UNDP-Albania (2008) *Partnering for Development: UNDP in Albania 2008*. Tirana:
- Uruçi, E. (2008) The role of remittances in the Albanian economy. Paper presented to the conference on 'Migration and Development in Albania and the Western Balkans: Remittances, Return and Diaspora', Durrës, Albania, 26-27 September 2008.
- Uruçi, E. and Gedeshi, I. (2003) *Remittances Management in Albania: CeSPI (Centro Studio Politica Internazionale)*. Working Papers 5/2003.
- Vullnetari, J. (2007) *Albanian Migration and Development. State-of-The-Art Review*. Amsterdam: IMISCOE Working Paper 18.
- Vullnetari, J. and King, R. (2008) 'Does your granny eat grass?' On mass migration, care drain and the fate of older people in rural Albania, *Global Networks*, 8(2): 139-71.
- World Bank (2006) *Albania: Labour Market Assessment*. Washington DC: World Bank. Report no.34597-AL.

